



SHOQATA E  
GAZETARËVE  
TË MAQEDONISË



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

# RAPORTIMI ETIK I MEDIEVE NË EVROPË DHE MAQEDONI

## ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

1. Овај кодекс на однесување е составен дел од Кодексот на новинарите на Македонија и е составен дел од Кодексот на новинарите на Македонија.

Скопје 04.12.2010  
Новинари во Македонија







**RAPORTIMI  
ETIK  
I MEDIEVE  
NË EVROPË  
DHE MAQEDONI**

DHJETOR 2016, SHKUP

# Impresum

**Titull:**

Raportimi etik i medieve në Evropë dhe Maqedoni

**Botues:**

Naser Selmani, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
Johannes D. Rey, Fondacioni Konrad Adenauer

**Autorë:**

Dr. Marina Tuneva  
Mr. Filjana Koka

**Koordinim:**

Dragan Sekulovski, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
Davor Pasoski, Fondacioni Konrad Adenauer

**Disenjator:**

Marjan Delevski

**Korrektor:**

Naxhi Osmani

**Përktheu në gjuhën shqipe:**

Benjamin Arifi

**Tirazhi:**

200 kopje

**Shënim:**

*Ky publikim është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe Fondacioni "Konrad Adenauer" në Shkup. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë këndvështrim personal i autorëve.*

# Përmbajtja

## Pjesa 1

<b>1. Etika mediatike në nivel global: faktorët e ndikimit dhe perspektivat</b>	<b>9</b>
1.1 Domosdoshmëria për etikë globale mediatike	9
1.2 Konceptet dhe vlerat në diskutimin për etikë në nivel global	11
1.3 Faktorët e ndikimit ndaj etikës mediatike	13
1.4 Sfidat në arritjen e etikës globale mediatike	15
<b>2. Arritja e përgjegjësisë në gazetari: analiza e praktikave dhe instrumenteve në Evropë</b>	<b>17</b>
2.1 Koncepti i përgjegjësisë në gazetari dhe rëndësia e tij	17
2.2 Sistemet mediatike dhe llojet e përgjegjësisë në gazetari	19
2.3 Instrumentet për përgjegjësi mediatike dhe transparencë – shembuj në Suedi dhe Holandë	24
<b>3. Etika: praktika, parimet dhe sfidat për punë etike dhe të përgjegjshme të radiodifuzerëve publikë në BE</b>	<b>29</b>
3.1 Rëndësia e radiodifuzerëve publikë dhe vlerat e tyre themelore	29
3.2 Parimet dhe rekomandimet ndërkombëtare për punën e serviseve radiodifuzive publike	31
3.3 Kornizat etike në serviset radiodifuzive publike – vështrim krahasues	34
<b>4. Sfidat në raportimin për tema sensitive</b>	<b>38</b>
4.1 Raportimi i përgjegjshëm dhe etik për vetëvrasjet	38
4.2 Raportimi i përgjegjshëm dhe etik për fëmijët adoleshentë	41
4.3 Raportimi i përgjegjshëm dhe etik për konflikte	43
4.4 Rekomandime për raportimin për grupe dhe individë të marginalizuar	45

## **Pjesa 2**

<b>1. Etika mediatike dhe vetërregullimi në Maqedoni</b>	<b>49</b>
1.1 Vetërregullimi – pikëreferimi konstitutiv i sistemit medial demokratik	49
1.2 Vetërregullimi në kushte të Maqedonisë dhe roli i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë në promovimin dhe zbatimin e saj (1946-2016)	50
1.3 Roli i SHGM-së në vetërregullimin në medie pas pavarësimit të Maqedonisë	51
1.4 Përpjekjet e SHMG-së për formimin e KEMM	53
1.5 Themelimi i Këshillit të parë për etikë në medie	58
<b>2. Arritja e përgjegjësisë në mediet në Republikën e Maqedonisë, praktika</b>	<b>63</b>
2.1 Analiza e punës së Këshillit të Nderit të SHGM-së	64
2.2 Si ndikon klima politike në cilësinë e përmbajtjeve mediatike	65
2.3 Mosrespektimi i prezumimit të pafajësisë	66
2.4 Shkeljet e shpeshtuara të Kodit etik	69
2.5 Gjuha e urrejtjes në mediet e Maqedonisë	71
2.6 Stereotipet në raportimin mediatik për romët	73
2.7 Rënia drastike e cilësisë së raportimit mediatik	75
2.8 Trendi i publikimit të informatave të pakonfirmuara	77
2.9 Përmbledhje e shkurtër e punës së KEMM-së	79
<b>3. Etika në servisin radiodifuziv publik në RM</b>	<b>81</b>
3.1 Vetërregullimi në servisin publik në RSFJ	81
3.2 Vetërregullimi në servisin radiodifuziv publik pas pavarësimit	83
3.3 RTVM dhe Kodi etik i gazetarëve	90
<b>4. Raportimi për tema sensitive nga praktika e Këshillit të Nderit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe Këshillit për Etikë në Mediet e Maqedonisë</b>	<b>92</b>
4.1 Raportimi për vetëvrasje dhe procese gjyqësore	93
4.2 Raportimi për adoleshentë dhe për fatkeqësi	94
<b>5. Literatura</b>	<b>97</b>



**RAPORTIMI  
ETIK  
I MEDIEVE  
NË EVROPË  
DHE MAQEDONI**





# 1. ETIKA MEDIATIKE NË NIVEL GLOBAL: FAKTORËT E NDIKIMIT DHE PERSPEKTIVAT

## 1.1 DOMOSDOSHMERIA PËR ETIKË GLOBALE MEDIATIKE

Në kohën e sotme, gazetaria nuk mund të kuptohet plotësisht nëse vështrohet ndaras nga globalizimi. Vetë koncepti i globalizimit mediatik tregon se nuk mund të jemi plotësisht të sigurt nëse mediet kanë sjellë globalizimin apo ato vetë janë rezultat i këtij procesi. Sidoqoftë, "sigurimi i hapësirës së privilegjuar për mediet në formësimin e ardhmërisë së globalizuar solli pritshmëri të larta për gazetarinë ndërkombëtare, televizionin satelitor dhe mediet e tjera për sigurimin e sferës globale publike të punës, që i bën shënjestër të lehtë nëse nuk e arrijnë atë gjë"<sup>1</sup>.

Edhe përkundër faktit se nuk theksohen në mënyrë eksplicite, shumë analistë të medieve bëjnë përpjekje për sigurimin e standardeve të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e gazetarisë. Në shtetet e Bashkimit Evropian gjithnjë e më tepër po diskutohet edhe për hulumtime të përbashkëta në sferën e etikës mediatike jashtë kufijve kombëtarë, me çka do të siguroheshin informacione të dobishme për vlerësimin e përvojave në këto shtete.

Në kohën e sotme është gjithnjë e më i pranishëm debati për atë se si duhet të jenë gazetarët dhe çfarë duhet të punojnë, ndërsa këto pyetje thuajse gjithmonë parashtrohen duke marrë parasysh kontekstin në të cilin funksionon gazetaria.

---

1 Reese, S D. (2010) Journalism and Globalization. *Sociology Compass* 4/6: 344–353

Nga ana tjetër, diskutimi për etikën në gazetari zakonisht nuk është i bindshëm për shkak të vlerave dhe interpretimeve të ndryshme që kanë njerëzit. "Zakonisht ekziston konflikt në mes mënyrës së komunikimit për të cilin individit vlerëson se është i suksesshëm dhe vlerësimit se nuk duhet të përdoret, sepse, në kuptimin etik të fjalës, kjo mënyrë është e dyshimtë"<sup>2</sup>.

Pa asnjë dyshim se nevoja për standarde etike dhe profesionale në kohën e sotme bëhet gjithnjë e më e madhe. Liria më e madhe në medie nënkupton gazetari më aktive dhe vetëdije më të madhe për nevojën për standarde, me qëllim që të sigurohet cilësi dhe të shmanget keqpërdorimi. Pasojat nga puna joetike në erën e ekonomisë globale dhe komunikimit të shpejtë janë shumë më serioze se sa në kohërat kur dëmi i punës joetike ka qenë i izoluar dhe i pavërejtshëm. Etika në medie rrjedh nga ata që i shkruajnë dhe redaktojnë lajmet, nga botuesit dhe pronarët e medie, ndërsa përgatitja e standardeve etike është përgjegjësi pjesërisht personale, ndërsa pjesërisht kolektive, prandaj del se përgatitja efektive dhe zbatimi i standardeve etike asnjëherë nuk mund të nënkuptojnë burime të jashtme të ndikimit.

Ideja për etikë mediatike në nivel global, para se gjithash, rrjedh nga angazhimet për ndryshime, reforma dhe përmirësime të sistemit global mediatik me qëllim që të mënjanohen problemet dhe pabarazia që dalin nga kontrolli dhe pabarazia. Në erën e medie globale, tema e etikës mediatike në nivel global imponohet gjithnjë e më tepër për shkak të nevojës për zhvillimin e kornizës së parimeve dhe standardeve për praktikën në fushën e gazetarisë. Jo rrallëherë, këto përpjekje hasin në probleme, për shkak se ristrukturimi i sistemeve mediatike cilësohet si çështje kundërthënëse, e cila shpeshherë nxit komente për motivet ose agjendën e cila qëndron pas idesë për kontrollimin e medie ose për kufizimin e lirisë së shprehjes. Ky debat vazhdon edhe në kohën e sotme.

Kritikat rreth etikës globale mediatike zakonisht përqendrohen në faktin se lokalizimi e sjell në pikëpyetje ekzistimin e vlerave universale në etikë dhe gazetari. Nga ana tjetër, thuhet se universaliteti është term abstrakt dhe paraqet qasje të kufizuar ndaj etikës dhe nuk është i

---

2 Johannessen, R.L., Valde, K.S., Whedbee, K.E. (2008) Ethics in Human Communication, Waveland Press

ndjeshëm ndaj veçorive lokale. Në nivel praktik, njerëzit dyshojnë se mediet do t'i realizojnë vlerat e etikës globale mediatike në punën e tyre. Për këtë shkak, jo rrallëherë, iniciativa për etikë globale mediatike vlerësohet si joreale.

## 1.2 KONCEPTET DHE VLERAT NË DISKUTIMIN PËR ETIKË NË NIVEL GLOBAL

Në tentativat për adresimin e çështjes rreth ridefinimit të etikës në nivel global, një pjesë e ekspertëve<sup>3</sup> propozojnë tri vlera themelore në praktikën mediatike në erën digjitale: saktësi, sinqeritet dhe kujdes. Në studimin krahasues për vlerat profesionale në gazetari<sup>4</sup>, Tomas Hanish (Thomas Hanitzsch), Patrik Li Plajsans (Patrick Lee Plaisance) dhe Elizabet Skivis (Elizabeth A. Skewes) bëjnë thirrje për një ekuilibër më të qëndrueshëm në hulumtimin e etikës së medieeve. Në periudhën mes viteve 2007 dhe 2009, me konzorcium të hulumtuesve nga 20 shtete, janë intervistuar 2.000 gazetarë dhe ka dalë se thelbi i kuptimit të tyre të përbashkët të etikës profesionale qëndron në objektivitetin, saktësinë dhe të vërtetën.

Një pjesë e madhe e hulumtimeve për etikën mediatike janë fokusuar në këtë që vijon:

- 1. puna e medieeve dhe çështjet etike, siç është privatësia, objektiviteti, paanshmëria, ndershmëria dhe vërtetësia e raportimit të gazetarit. Në të njëjtën kohë analizohet dilema se a e kanë bërë punonjësit në medie atë që kanë vlerësuar se është morale dhe korrekte dhe atë që ua imponon profesioni;**
- 2. përmbajtja dhe forma e vetërregullimit (kodet etike, këshillat për etikë, avokati i popullit, etj.);**
- 3. etika si pjesë e filozofisë morale dhe teoritë që tentojnë të ndërtojnë sistem etik;**

---

3 Couldry, Nick (2013) Why media ethics still matters. In: Ward, Stephen J. A., (ed.) Global Media Ethics: Problems and Perspectives. Wiley-Blackwell, Chichester, pp. 13-28

4 Ward, S.J.A (eds) (2013) Global Media Ethics: Problems and Perspectives. Chichester, UK: Wiley-Blackwell

Në thelb, debati në nivel global rreth etikës mediatike konsiston në një çështje kryesore, e kjo është: çfarë është ajo që e bën gazetarinë të tillë siç është? Cilat janë ndikimet të cilat kontribuojnë për qëndrimet dhe veprimet e gazetarëve në lidhje me etikën? Pa u kuptuar këto ndikime, është e pamundur të përgatiten rekomandime për ndryshime të rëndësishme.

Shpeshherë, dilemat më të mëdha të gazetarëve sillen rreth obligimeve dhe përgjegjësive të tyre personale, por edhe ndaj individëve dhe grupeve të shoqërisë. Në veprën "Etika mediatike: Raste dhe rezonim moral"<sup>5</sup> përmbliken pesë kategoritë vijuese:

- 4. obligimi ndaj vetvetes: ndjekja e instiktit dhe ndërgjegjes personale ndoshta në fund do të jetë alternativa më e mirë në numrin më të madh të situatave;**
- 5. obligimi ndaj publikut;**
- 6. obligimi ndaj medias, që nënkupton se obligimi ndaj punëdhënësit ose udhëheqësisë shpeshherë ka përparësi para obligimit ndaj individit ose grupit;**
- 7. obligimi ndaj kolegëve dhe standardeve për raportim të mirë;**
- 8. obligimi ndaj shoqërisë, përkatësisht respektimi i të drejtës së publikut që të dijë, dhe përgjegjësia publike e shndërruar në angazhim gazetaresk që ndonjëherë e pengon lojalitetin ndaj cilitdo grup apo individ tjetër.**

---

5 Christians, C.G. et al (1995) Media Ethics: Cases and Moral Reasoning(2<sup>nd</sup>ed.). New York:Longman.

## 1.3 FAKTORËT E NDIKIMIT NDAJ ETIKËS MEDIATIKE

Kur bëhet fjalë për etikën, ndikojnë më tepër faktorë ndaj punonjësve mediatikë, ndërsa sipas asaj edhe në produktin përfundimtar. Disa teoricienë të fushës vlerësojnë se në vendimet lidhur me atë se çfarë do të publikohet më së shumti ndikon publikuesi ose krijimtari individual i prodhimit mediatik. Teoricienë të tjerë, edhe përkundër asaj se pajtohen me këtë qasje, vlerësojnë se ndikim më të madh ndaj medieve kanë faktorët ekonomikë, politikë dhe shoqërorë.

Në veprën "Kundërthëniet në etikën mediatike"<sup>6</sup> thuhet se, edhe përkundër faktit se faktorët e jashtëm ndikojnë në jetën etike të individëve, megjithatë, gjithçka konsiston në vlerat individuale morale. Rrjedhimisht, edhe produkti përfundimtar varet nga vendimet e tyre etike. Në veprën e njëjtë, Dejvid Gordon (2011) pohon se, edhe përkundër faktit se etika individuale luan rol në produktin mediatik, faktorët ekonomikë, politikë dhe shoqërorë ndikojnë te punonjësit e medieve në nivel shumë më të fuqishëm.

Sipas Gordon, ky rast haset sidomos kur bëhet fjalë për korporata ose konglomerate më të mëdha mediatike. „Kolumnisti në "Nju Jork Tajms" ka shumë më pak liri të shkruajë për atë që do, se sa ndonjë gazetar në gazetë të vogël lokale. Ekonomia në shitjen e gazetave dominon në raport me vendimet etike"<sup>7</sup>.

Numri më i madh i teoricienëve vlerësojnë se etika është nën ndikimin e individit dhe ekonomisë, por edhe se individët në të njëjtën kohë mund të jenë të ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshme. Kompania mediatike ka mënyrën e saj të realizimit të gjërave, që etikisht mund të jetë e ndryshme nga biznesi në rrethinë të vogël, lokale. Prandaj, vendimet etike mund të jenë nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, por në fund të konsistojnë në vendimet e individit dhe në atë që ai mendon se është e përshtatshme.

6 Gordon, A.D., Kittross, J.M., et al (2011) *Controversies in Media Ethics*(3<sup>rd</sup> ed.), Routledge.

7 *ibid*, 22

Në veprën "Etika në gazetari"<sup>8</sup> thuhet se, kur diskutohet për etikën në nivel global, parësore janë tri ndikime kryesore: individuale, kulturore dhe institucionale. Për një numër të madh të analistëve të sotëm, fokusi duhet të jetë mbi individualen dhe përforcimin e karakteristikave të tyre, ose sigurimin e aftësive dhe mjeteve të përshtatshme për të kuptuar se çfarë është e mirë e çfarë e keqe, me çka do të krijoheshin të ashtuquajturat bashkësi morale.

Nga ana tjetër, vendosja e madhe e theksit në autonominë individuale shkakton probleme etike. Në një rreth, ku liria vlerësohet si përparësi, parimet siç janë "besueshmëri" dhe "përgjegjësi" marrin rëndësi dytësore. Duhet patjetër të merret parasysh se "individët nuk janë ishuj të izoluar dhe niveli deri ku mund të veprojnë të pavarur nga faktorët e tjerë mund të jetë i mbitheksuar... Ndikimet institucionale, veçanërisht ata në industrinë gazetareske, mund të jenë jashtëzakonisht të fuqishme... ose, thjesht, institucioni mund ta ndryshojë individin, për të mirë ose për të keq"<sup>9</sup>.

Nga ana tjetër, ekziston edhe diçka që quhet "ndikim jashtëmediatik". Këtu mendohet për ndikimet që vijnë nga jashtë në strukturat e medias. Sipas kësaj perspektive, fuqia në formësimin e përmbajtjeve nuk është përgjegjësi e vetë medias, por rrjedh edhe nga institucione të tjera në shoqëri, duke përfshirë pushtetin, agjencitë e marketingut, grupet e ndryshme të interesit, por edhe mediet tjera. Nga perspektiva kritike, "ndikimi jashtëmediatik" e drejton vëmendjen drejt analizës së mënyrave përmes së cilave mediet u nënshtrohen interesave të elitave në kontekstin më të gjerë shoqëror. Edhe pse gazetarët me vetëdije mund të shmangin konfliktin e interesit i cili do të ndikonte në raportimin e tyre, me mbajtjen e distancës profesionale ndaj temës, megjithatë, punëdhënësit e tyre mund të kenë lidhje të ngushtë me interesa më të mëdha korporative ose me ndonjë lloj tjetër të lidhjes elitare. "Në kuptimin konceptual të fjalës, në këtë nivel ndodh spektër i gjerë i ndikimeve ndaj medieeve, por veçanërisht shqetësojnë rrethanat në të

---

8 Wayatt, W. N (ed) (2014) *The Ethics of Journalism – Individual, Institutional and Cultural Influences*. I.B.Tauris & Co. LTD in association with the Reuters Institute for the Study of Journalism, University of Oxford.

9 *ibid*, 15

cilat këto ndikime janë sistematike, sipas matricës së paramenduar paraprakisht të veprimit dhe janë të vazhdueshme<sup>10</sup>.

Përveç ndikimeve individuale dhe institucionale, është me rëndësi edhe ndikimi i vetë kulturës. Kjo ka të bëjë me faktin që gazetarët janë pjesë dhe i përkasin kulturës në të cilën jetojnë dhe veprojnë dhe që, pa dyshim, i përfaqësojnë pikëpamjet, qëndrimet dhe vlerat e tyre. Ajo që është e pranueshme etikisht në një shtet, mund të trajtohet ndryshe në një shtet tjetër. Në këtë drejtim, vërehet dallim i madh mes gazetarëve nga vende demokratike dhe gazetarëve nga vende autokratike. Në disa sisteme mediatike, procesi i prodhimit të lajmeve ndonjëherë është nën ndikimin e anshmërisë kulturore të punonjësve mediatikë. "Kjo ndodh kur punonjësit mediatikë, me apo pa vetëdije, sillen sipas normave të pranuar në shoqëri dhe bëjnë zgjedhje që janë më të ndryshme se zgjedhjet e kolegëve në vende të tjera, për shkak të perspektivave të tyre të ndryshme kulturore"<sup>11</sup>.

## 1.4 SFIDAT NË ARRITJEN E ETIKËS GLOBALE MEDIATIKE

Në diskutimin për etikën globale mediatike paraqitet mospajtueshmëri rreth asaj se a duhet të precizohen vlera universale mes gjithë gazetarëve. Në të vërtetë, parashtrohet pyetja nëse ekzistojnë fare vlera universale. Nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë eticienë përpiqen të konstatojnë vlera të përbashkëta, të cilat do të përfaqësoheshin në dokumente, korniza dhe deklarata të ndryshme në nivel global.

Sipas një këndvështrimi, nuk ka nevojë as për vlera universale, as për pajtueshmëri universale, e as për kod të besueshëm global. Në këtë drejtim, theksohet se etika nuk varet nga gjetja ose përkufizimi i vlerave universale të cilat do t'i pranonin të gjithë njerëzit racionalë. Në fakt, vlerësohet se qasja e drejtë është përkufizimi nëse të gjitha palët e

---

10 Reese, S. D (2001) Understanding the Global Journalist: a hierarchy-of-influences approach. *Journalism Studies*, Volume 2, Number 2, pp. 173–187

11 Nasser, M. K. (1983) News values versus ideology: A third world perspective. In J. Martinand, & A. Chaudhary, *Comparative Media System* (pp. 32-48). Broadway, New York: Longman.

interesuara, ose pjesa më e madhe e tyre, kanë mundësi të konstruojnë ose të pajtohen rreth një përmbledhjeje parimesh, përmes një procesi të ndershëm të shqyrtimit.

Nga ana tjetër, duket se ekzistojnë elemente të etikës globale. Kur zbatohen kodet etike gjithandej botës vërehet pajtueshmëri rreth parimeve bazë, siç është raportimi për të vërtetën, shmangia e anshmërisë, dallimi mes lajmeve dhe opinioneve, si dhe shërbimi ndaj interesit publik. Ekzistojnë një numër i madh deklaratash ndërkombëtare për parimet në punën e medieeve, ndërsa me rëndësi të veçantë është edhe zhvillimi i qasjes ndërkombëtare në studimin e komunikimit përmes medieeve dhe gazetarisë.

Shkurt, debati rreth etikës në fushën e gazetarisë në nivel global thirret në disa argumente. "Së pari, mediet bëhen gjithnjë e më shumë globale. Faktet janë të njohura. Korporatat mediatike janë kompani globale. Teknologjia u mundëson medieeve menjëherë të grumbullojnë informacione nga lokacione të largëta"<sup>12</sup>. Për shembull, mbulimi i Al Xhezeirës dhe Si-En-En është shumë më i madh se i botës arabe dhe Amerikës, që nënkupton se etika duhet ta marrë parasysh globalizimin e medieeve. Etika në fushën e gazetarisë nuk do të ketë kredibilitet nëse nuk i përshtatet këtij kompleksiteti të ri.

Më tej, ndikimi global nënkupton edhe përgjegjësi globale. "Raportet, pa marrë parasysh a transmetohen përmes satelitit apo internetit, arrijnë te shumë njerëz gjithandej botës dhe ndikojnë në veprimet e qeverive, ushtrive dhe agjencive humanitare"<sup>13</sup>. Për shembull, publikimi i karikaturave të profetit Muhamed në një shtet, në Danimarkë, shkaktoi dhunë në të gjithë botën. Nëse nuk raportohet në mënyrë përkatëse, qytetarët e Amerikës Veriore nuk do ta kuptojnë dhunën në Lindjen e Afërt. Raportimet e njëanshme mund të shkaktojnë përplasje mes grupeve të ndryshme etnike. Të gjithë këta shembuj shpiejnë te nevoja e shqyrtimit të ndikimit të gazetarisë jashtë kufijve nacionalë.

12 Ward, S. J. A. (2008) Global Journalism Ethics: Widening the Conceptual Base. Global Media Journal - Canadian Edition, Volume 1, Issue 1, pp. 137-149

13 McPhail, T. L. (2006) Global communication: Theories, stakeholders, and trends. Malden, MA: Blackwell Publishing



Çështjet globale dhe fuqia e medieve globale kërkojnë etikë mediatike që është globale sipas parimeve të saj dhe kuptimit të medieve. Krijimi i etikës globale është me rëndësi, sepse në botën globale në të cilën jetojmë imponohen sfida të reja dhe të vështira, me të cilat nuk mund të ballafaqohet sistemi i vjetër dhe i izoluar i funksionimit. Etika e cila nuk është globale sipas natyrës së saj nuk mund t'i përmbushë si duhet nevojat me të cilat ballafaqohemi në këtë kohë moderne të medieve globale. "Por, me shtrirjen globale vijnë edhe përgjegjësitë globale"<sup>14</sup>.

Sidoqoftë, kjo përgjegjësi globale nuk është reflektuar në pjesën më të madhe të kodeve të gazetarisë.

## **2. ARRITJA E PËRGJEGJËSISË NË GAZETARI: ANALIZA E PRAKTIKAVE DHE INSTRUMENTEVE NË EVROPË**

### **2.1 KONCEPTI I PËRGJEGJËSISË NË GAZETARI DHE RËNDËSIA E TIJ**

Problemet me të cilat ballafaqohet gazetaria në kohët e sotme, duke filluar nga presionet politike deri te pritjet e opinionit, kërkojnë përgjegjësi shumë më të madhe nga ana e medieve. "Përgjegjësia është koncept i gjerë, i cili nuk kufizohet vetëm me rregullimin formal, por i përfshin edhe obligimet më të gjera të medieve dhe mënyrat në të cilat ata përgjigjen për punën e tyre në interaksion dinamik me palët e përfshira"<sup>15</sup>.

Instrumentet e përgjegjësive mediatike, sipas Klod-Zhan Bertrand (2000) janë "të gjitha mjetet joqeveritare për nxitjen e përgjegjësive së medieve ndaj publikut"<sup>16</sup>.

14 Ward, S.J.A (2005) Philosophical foundations of global journalism ethics. Journal of Mass Media Ethics (20-1), 3-21

15 McQuail, D. (1997). Accountability of media to society: Principles and means. European Journal of Communications 12 (4), 511-529

16 Bertrand, C.J (2000) Media Ethics and Accountability Systems, Transaction Publishers

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë ndryshoi rrjedhën e informacioneve jo vetëm në shoqëritë demokratike të Perëndimit, por shumë më shumë se atë, përkatësisht edhe në vendet në tranzicion. Në të njëjtën kohë, duke marrë parasysh se shprehitë e publikut ndryshojnë, shemben modelet tradicionale të biznesit në gazetari dhe tregu i medieve ndryshon në mënyrë të konsiderueshme.

Kështu, gjithnjë e më shumë shtrohet edhe pyetja: Cilat instrumente të vendosura tashmë të përgjegjësisë mediatike tregohen më efikase edhe në këtë kontekst? A inkurajon secili sistem mediatik përdorimin e instrumenteve të ndryshme për përgjegjësi mediatike nga ana e profesionistëve në medie dhe publikut të medieve?

Qëllimi i përgjegjësisë mediatike është "përmirësimi i shërbimeve të medieve ndaj vetë publikut, kthimi i besimit të publikut në medie, mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medieve, por edhe sigurimi i autonomisë së domosdoshme të gazetarisë për zgjerimin e demokracisë"<sup>17</sup>.

Në shoqëritë demokratike, ku liria e medieve dhe liria e shprehjes janë elemente thelbësore të funksionimit, gazetaria rregullohet vetëm me pak ligje, ndërsa shteti nuk duhet të marrë pjesë në kontrollin ose monitorimin e medieve në demokraci. Sipas kësaj, pjesa më e madhe e konflikteve potenciale në sferën e gazetarisë, siç janë raportimi sensacional, diskriminues ose i njëanshëm, nuk përfshihen në ligje të institucioneve formale, por në norma profesionale dhe kode etike të gazetarisë. Në këtë drejtim, "kodet vlerësohen si institucione joformale dhe shërbejnë për koordinimin e aktiviteteve individuale"<sup>18</sup>. Shikuar nga këndvështrimi ekonomik, institucionet joformale, siç janë normat e gazetarisë dhe kodet etike, janë të degëzuara mirë, kështu që "sa më shumë aktorë të përfshihen, atëherë më i fuqishëm dhe më me vlerë bëhet ai institucion"<sup>19</sup>. Përmbajtja në norma, siç janë institucionet joformale, nuk mund të imponohet nga gjykata, por mund të realizohet vetëm në bazë vullnetare.

---

17 ibid, 22

18 Coyne, C.J., Leeson, P.T. (2009) Media, Development and Institutional Change, Edward Elgar

19 Eberwein, T., Fengler, S., et al (eds) (2011) Mapping Media Accountability – in Europe and Beyond, Köln, Herbert von Halem Verlag

Nga ana tjetër, institucionet dhe organizatat të cilat janë kompetente për përcjelljen e përgjegjësisë mediatike hasin në sfida të ndryshme në punën e tyre, ndërsa një ndër problemet më të mëdha është mungesa e shikueshmërisë së tyre. Jo rrallëherë hasin në sjellje injoruese nga profesionistët mediatikë, të cilët dinë t'i quajnë "luanë pa dhëmbë", me çka, në fakt, pengojnë promovimin e mëtutjeshëm të këtyre organizatave dhe institucioneve në afirmimin e konceptit të përgjegjësisë në gazetari. Nga ana tjetër, siç thekson profesori Stefan Ras – Moll (Stepher Russ – Mohl)<sup>20</sup>, institucionet për përgjegjësi në gazetari nuk duhet shikuar në mënyrë të izoluar, por duhet të perceptohen si sistem ose rrjet i infrastrukturave të cilat shërbejnë për përmirësimin e përpjekjeve për rritjen e cilësisë së gazetarisë.

Është me rëndësi të kuptohet se përgjegjësia mediatike është shumë më shumë se sa gjobitja e sjelljes së gazetarëve. Ky koncept nuk ka të bëjë vetëm me kritikën, mbikëqyrjen dhe kontrollin, por bëhet fjalë për qasje aktive edhe gjatë procesit të prodhimit të lajmeve, me çka krijohet transparencë në të gjitha nivelet. "Kur dikush do të parashtrojë pyetje deri te medie që të shpjegojë ose arsyetojë ndonjë vendim të saj, tashmë është aktivizuar procesi i përgjegjësisë mediatike"<sup>21</sup>.

## 2.2 SISTEMET MEDIATIKE DHE LLOJET E PËRGJEGJËSISË NË GAZETARI

Para se të hyjmë në analizë konkrete dhe shqyrtim të metodave dhe instrumenteve të përgjegjësisë mediatike, të kthehemi shkurtimisht te karakteristikat e sistemeve mediatike.

---

20 Intervistë me profesorin Stefan Ras – Moll (Stephen Russ-Mohl), profesor i gazetarisë dhe menaxhim me media në Universitetin Svicera Italiana (Svizzeraitaliana) dhe drejtor i European Journalism Observatory në lidhje me gjendjen rreth përgjegjësisë mediatike dhe perspektivat për të ardhmen, e gjetur në <https://www.infona.pl/resource/bwmeta1.element.desklight-479a0122-55ec-4430-9d75-5f63495aa882/content/partContents/bd3ede8a-9211-3832-b046-08f8b70a97ab>, në disponim më 1 dhjetor 2016

21 Bon Krogh, T. (ed.) (2007) Media Accountability Today... and Tomorrow Updating the Concept in Theory and Practice, Nordicom, University of Gothenburg

Hallin dhe Mançini (Hallin, Mancini, 2004) kanë përkufizuar tri modele të sistemeve mediatike<sup>22</sup> në Evropë dhe Amerikën Veriore: modeli liberal në Amerikën Veriore dhe Britani të Madhe, me medie fillimisht komerciale dhe tregtare, modeli demokratiko-korporativ në shtetet e Evropës Veriore, me ndikim aktiv, por të kufizuar të pushtetit dhe kombinim të medieve të orientuara drejt tregut dhe atyre jokomerciale, si dhe modeli i polarizuar pluralistik, karakteristik për vendet e Evropës së Mesdheut, me shkallë të lartë të intervenimit të pushtetit, me medie më pak të zhvilluara komercialisht dhe me lidhje mes medieve dhe partive politike.

Modeli liberalo-tregtar nënkupton shkallë të lartë të profesionalizmit mes redaktorëve dhe gazetarëve, të cilët, nga ana tjetër, nuk janë të organizuar në masë të madhe, përkatësisht nuk ekziston strukturë e centralizuar nacionale për përgjegjësi mediatike. Qeveria garanton liri të medieve, por, nga ana tjetër, nuk përzihet në punën e tyre. Vetërregullimi profesional, siç shënojnë Hallin dhe Mançini (2004), në masë të madhe është joformal dhe realizohet në medie të ndryshme, por edhe në përgjithësi është pjesë e vetë kulturës gazetareske.

Modeli demokratiko-korporativ, i cili zakonisht është karakteristik për vendet e Evropës veriore dhe qendrore, nënkupton se shteti ka rol relativisht aktiv, por të kufizuar, në sferën e medieve. Hallin dhe Mançini përshkruajnë se mediet komerciale bashkë-ekzistojnë me partitë e organizuara politike, ndërsa gazetarët janë të organizuar në organizata profesionale dhe të paktën parimisht do të mund t'i largonin anëtarët të cilët i shkelin normat etike. Shtetet ku funksionon ky model kanë tendenca për mbajtjen e sistemeve relativisht të forta dhe formale të vetërregullimit të medieve.

Modeli i polarizuar-pluralistik, i cili është karakteristik në vendet mesdhetare dhe ato evropiano-jugore, nënkupton se roli i shtetit është i fuqishëm, ndërsa praktika e gazetarisë në thelb nuk është e profesionalizuar në mënyrë adekuate. Gazetarët në raste të rralla janë të organizuar dhe ekziston pajtueshmëri e vogël rreth standardeve profesionale. Për shembull, në Itali, arsimimi formal në gazetari është vendosur në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar. Qeveria në këto shtete luan rol kryesor dhe kompleks në

---

22 Hallin, D.C., Mancini. P. (2004) Comparing Media Systems – Three Models of Media and Politics, Cambridge University Press

sektorin mediell, ndërsa ekziston kombinim i aktivizmit autoritar, ndikime demokratike dhe aleanca të ngjashme mes medieeve dhe partive.

Në analizën "Përgjegjësia dhe llogaridhënia mediatike: konceptualizimi i ri dhe praktikat"<sup>23</sup>, Bardoel dhe Henens (Bardoel, Haenens, 2004) dallojnë 4 lloje të përgjegjësisë, me atë që secili ka qasje të ndryshme, por jo edhe përjashtim, respektivisht:

- 1. përgjegjësi politike;**
- 2. të tregut;**
- 3. profesionale dhe;**
- 4. publike.**

Përgjegjësia politike lidhet me ligjin dhe rregullativat dhe është ekzekutive. Përgjegjësia e tregut nënkupton që mediet konsiderohen si të përgjegjshme dhe vlerësohen përmes interesit të konsumatorit. Përgjegjësia publike dhe profesionale janë të vetërregullueshme, që nënkupton se qasja është vullnetare. Përgjegjësia publike shpeshherë lidhet me presionet indirekte dhe qëllimi kryesor i saj është që mediet të veprojnë në emër të shoqërisë dhe vullnetarisht të zgjedhin rolin e pjesëmarrësit aktiv në shoqëri. Përgjegjësia profesionale i drejtohet profesionistit mediatik.

Koncept tjetër, i cili është me rëndësi në këtë kontekst, është edhe jehona e nevojave dhe shqetësimit në opinion. Dallimi mes përgjegjësisë ndaj publikut dhe jehonës ndaj nevojave të opinionit është se jehona ka të bëjë me pranimin e shqetësimit të publikut përmes përfshirjes, pjesëmarrjes dhe përmes shfaqjes së angazhimit, ndërsa përgjegjësia nënkupton se opinioni e konsideron medien të përgjegjshme për punën e saj.


Në kategorizimin e instrumenteve të përgjegjësisë mediatike, gjithashtu, është e dobishme nëse bëhet dallim mes niveleve të institucionalizimit. Në analizën "Vënia në hartë e përgjegjësisë mediatike në Evropë dhe më gjerë"<sup>24</sup> sugjerohet dallimi mes niveleve të larta përkundër niveleve të ulta të institucionalizimit, si dhe mes instrumenteve në kornizat e vetë profesionit dhe jashtë tij.

---

23 Bardoel, J., d'Haenens, L. (2004). Media responsibility and accountability: New conceptualizations and practices. *Communications*, 29(1), 5–25.

24 Eberwein, T., Fengler, S., et al (eds) (2011) *Mapping Media Accountability – in Europe and Beyond*, Köln: Herbert von Halem Verlag

Fotografia 1 më poshtë e pasqyron tipologjinë e tillë.



Fotografia 1. Tipologjia e instrumenteve për përgjegjësi mediatike

Sipas Rus-Moll (2003) dhe Fengler (2008), instrumentet e përgjegjesisë mediatike në erën e re, digjitale, përgjithësisht mund të klasifikohen si:

- 1. Sisteme të themeluara të përgjegjesisë mediatike: këshilla për etikë, ombudsmanë, kritikë e medieve në vetë mediet, letra drejtuar redaktorit, publikimi i korrigjimeve;**
- 2. Instrumente inovative për përgjegjësi mediatike online, siç janë ueb-blogjet redaktuese, ueb-faqet me të cilat mbikëqyren përmbajtjet gazetareske (për shembull British Mail Watch [www.mailwatch.co.uk](http://www.mailwatch.co.uk)), ueb-kastingjet për debate të brendshme për kritika ose mbledhje të ekipit (siç praktikohet, për shembull, në redaksinë e gazetës ditore amerikane TheSpokesmanReview [www.spokesman.com](http://www.spokesman.com)), ombudsmanët online (siç është "Bronski" gjerman nga gazeta ditore Frankfurter Rundschau [www.frblog.de](http://www.frblog.de)), kritikë mediatike në Facebook dhe Twitter, etj;**

Shembujt e mekanizmave vetërregullues të përgjegjësisë janë këshillat për etikë në medie dhe avokati i popullit. Në shumë shtete të botës gjithnjë e më tepër janë të pranishëm këshillat për etikë në medie, si një lloj mekanizmi për sigurimin e përgjegjësisë ndaj opinionit. Këshillat e tillë ndryshojnë sipas përbërjes së anëtarëve, modeleve të financimit, vëllimit të kompetencave dhe procedurave të punës, por, në thelb, qëllimi i tyre është që t'i shqyrtojnë ankesat e qytetarëve, ndërsa ndonjëherë edhe të bëjnë vlerësime të përgjithshme rreth çështjeve etike në medie dhe punës së tyre profesionale. Përveç që këshillat e etikës janë dëshmi për përgjegjësinë mediatike, ata janë të dobishëm edhe për mbrojtjen e lirisë redaktuese, për uljen e ndikimit të shtetit ndaj medie, për promovimin e punës së gazetarëve, si dhe për të ndihmuar publikun që të kenë qasje te mediet.

Ombudsmani në medie është lloj tjetër i instrumentit për përgjegjësi të vetërregulluar. Në të vërtetë, bëhet fjalë për dikë që zakonisht është i punësuar në medie të shtypur ose radiodifuzive, me qëllim që të merret me ankesat e publikut, dhe në bazë të kësaj, të shërbejë si ndërmjetësues mes medie dhe opinionit (Ettema&Glasser, 1987; Nemeth&Sanders, 1999; VanDalen&Deuze, 2006). Sidoqoftë, në disa shtete ombudsmani në medie nuk funksionon, ose është nën presion për shkak të mungesës së mjeteve financiare (Evers, Groenhart&Groesen, 2009).

Mekanizmat e përgjegjësisë profesionale dhe përgjegjësisë ndaj publikut konsiderohen si masa "të buta", dhe më së shpeshti preferohen nga ana e institucioneve mediatike dhe profesionistëve mediatikë, duke marrë parasysh se janë adekuate me parimin e lirisë së medie. Mekvejl (McQuial 1997) konsideron se masat "më të ashpra" për përgjegjësi kanë "efekt tmerrues ndaj medie, të cilat kanë frikë nga dënimet ekonomike dhe politike"<sup>25</sup>. Mbështetja në bashkëpunim vullnetar me shumë mundësi ka efekt pozitiv ndaj profesionistëve mediatikë. Sikurse edhe në korporata të tjera, nevoja për dialog me opinionin është metodë më e dëshirueshme se sa gjobat ose realizimi i kufizimeve të ashpra.

---

25 McQuial, D. (1997) Audience Analysis, Sage Publications

## 2.3 INSTRUMENTET PËR PËRGJEGJËSI MEDIATIKE DHE TRANSPRENCË – SHEMBUJ NË SUEDI DHE HOLANDË

Më poshtë sjellim shembuj nga analiza e sistemeve të përgjegjësisë në mediet në Suedi dhe Holandë. Në Suedi janë funksionale sisteme të ndryshme të përgjegjësisë<sup>26</sup>, ndërsa në këtë kontekst sjellim disa prej tyre.

1. **Sistem i brendshëm i kontrollit në stilin “avokat i djallit”, në kushte kur fillon e ashtuquajtura “gjueti shtrigash”. Një nga kritikantët më të shpeshta të medieve në Suedi është se ato përkohësisht bien në “mentalitet të pakeluar” dhe përfshihen në të ashtuquajturën “gjueti shtrigash”. Si mënyrë për pengimin e tendencave të teprimit në këtë drejtim, individit në pozitë më të lartë në redaksi, pasi t’i ketë shqyrtuar trendet e tilla, e merr rolin e “avokatisë së djallit”, duke rishqyrtuar “të vërtetat” dominuese dhe duke theksuar nevojën e skenarëve dhe shpjegimeve alternative;**
2. **“Hetimet” të brendshme pas storjeve kontroverze. Ky është sistem me potencial për ndryshime nga ana e atyre që e bëjnë hetimin, duke marrë parasysh se janë të njoftuar me punën e redaksisë dhe gëzojnë besim të madh, por në asnjë rast nuk janë përgjegjës dhe as nuk janë të përfshirë në storjen për të cilën bëhet fjalë. Një shembull i tillë i popullarizuar është metoda e hetimit që është ndërmarrë nga ana e “Nju Jork Tajms” pas aferës Xhejson Bler<sup>27</sup>;**

26 Von Krogh, T. (2008) “Constructive criticism” vs public scrutiny: attitudes to media accountability in and outside Swedish news media. Media accountability today... and tomorrow : updating the concept in theory and practice, Nordicom, Göteborgsuniversitet

27 Bëhet fjalë për situatë në të cilën një i punësuar në New York Times disa herë ka bërë mashtrime gazetareske derisa ka raportuar për ngjarje të rëndësishme, ndërsa këtë e ka zbuluar hetimi në vetë gazetën. Fabrikimi dhe plagjiatura e zbuluar janë konsideruar si tradhti e madhe e besimit dhe goditje e fuqishme ndaj kredibilitetit të gazetës me histori të gjatë. Gazetari Xhejson Bler i ka hutuar lexuesit me komente të fabrikuar, skena të imagjinuara, material të vjedhur nga gazetaret e tjera dhe agjenci lajmesh, me përzgjedhje të detajeve nga fotografitë që të krijojnë përshtypje se ka qenë diku ose ka parë dikë, edhe pse kjo nuk ka ndodhur.



- 3. Panel për lexues, sistem të cilin një numër i madh i gazetave e konsiderojnë si të kënaqshëm. Këndvështrimet e anëtarëve të atij paneli vendosen në ueb-faqen e gazetës dhe ato shërbejnë për diskutim publik;**
- 4. Verifikim i civateve nga intervistat me vetë burimin. Kjo metodë është praktikë e zakonshme në shumë redaksi. Në një pjesë prej tyre bëhet dallim mes subjekteve që kanë qenë të intervistuar, respektivisht ata që kanë pak ose aspak përvojë me mediet (të cilëve gazetari ua lexon citatet me vetiniciativë), pastaj ekspertët dhe administratorët e nivelit të mesëm (gazetari ofron t'i lexojë citatet) dhe politikanët më të lartë dhe kreatorët e politikave publike (gazetari nuk e ofron, por me kërkesë të të intervistuarit do ta kontrollojë citatin);**
- 5. Vërejtje publike për anshmëri të mundshme gjatë zgjedhjes së burimeve të informatave. Përmes hapjes së procesit të redaktimit të lajmeve, redaktorët i ndihmojnë lexuesit të bëhet konsumues më kritik i lajmeve;**
- 6. Trajnim të brendshëm përmes seminarëve që i organizon asociacioni i gazetarëve hulumtues, ku diskutohet për metodat, problemet dhe aspektet e tjera të gazetarisë hulumtuese;**
- 7. Mundësi që lexuesit të komentojnë përmbajtjet e publikuara në ueb-faqe;**
- 8. Journalisten – javore e Lidhjes së Gazetarëve Suedezë, e cila përmban kombinim të lajmeve nga mediet dhe nga Lidhja e Gazetarëve, si dhe përmban diskutim për çështje të etikës dhe praktikës profesionale;**
- 9. “Background” materiale ose materiale në prapavijë në ueb-faqe. Kur bëhet fjalë për storje të mëdha dhe kontroverse, disa medie publikojnë në ueb-faqet e tyre materiale të cilat sigurojnë kontekstin dhe fotografinë më të gjerë (si për shembull materiale të transkriptuara, të dhëna statistikore, intervista, etj.). Qëllimi është që të rritet transparenca sa i përket thelbit të raportimit dhe mënyrës në të cilën është përzgjedhur materiali;**
- 10. Hulumtime akademike gazetareske;**

- 11. Sondazhe të pavarura për besimin e publikut në mediet. Instituti Shoqëri-mendim-medis i Universitetit në Geteborg vite me radhë analizon besimin e publikut në medie, ndërsa informatat e siguruara krijojnë përmbledhje origjinale të të dhënave krahasuese;**
- 12. “Balanc i gjendjes nga redaksia”, i cili e përmbledh punën dhe arritjen e redaksive, ndërsa instrumenti është përgatitur nga Universiteti i Geteborgut me qëllim që të mbledhen të dhëna relevante statistikore dhe intervista të strukturuar;**
- 13. Pjesëmarrje e qytetarëve në raportim. Kjo më së shpeshti ndodh me gazetatat tabloide, me ç’rast angazhohen njerëz të rinj, yje dhe dëshmitarë të ngjarjeve të caktuara spektakulare;**
- 14. Qëndrime të organizatave në kuadër të profesionit. Në Suedi ka një numër të madh organizatash me specializim në kuadër të gazetarisë (mjedis jetësor, shkencë, mjekësi, etj.). Mes tjerash, ata e mbikëqyrin punën e medieve dhe diskutojnë rreth saj, ndërsa gjithashtu edhe shkëmbejnë përvoja mes redaksive të tyre;**
- 15. Debatet e Publicistklubben, organizatë e redaktorëve dhe gazetarëve e formuar që në vitin 1874, e cila ka mëse 5.000 anëtarë. Në fokusin qendror të saj janë standardet etike, me ç’rast organizon debate për çështje aktuale një herë në muaj në Stokholm, si dhe në qytete të tjera të Suedisë. Organizata publikon edhe raport vjetor, i cili distribuohet te të gjithë anëtarët, ndërsa në të shqyrtohen aktivitetet e organizatës, por ka edhe pjesë tematike për disa aspekte të gazetarisë.**

## **Holanda**

Në kuadër të kësaj përmbledhjeje i shqyrtojmë edhe shembujt me servisin radiodifuziv komercial RTL Nieuws dhe gazetën De Volkskrant.

Përgjegjësia ndaj opinionit, kryesisht, organizohet në mënyrë joformale. “Shikuesit kanë mundësi të ankohen dhe ekziston rregull i pashkruar se duhet t’u përgjigjet patjetër këtyre ankesave, duke marrë parasysh

se patjetër duhet t'i shërbehet publikut<sup>28</sup>. Gazetarët në punën e tyre duhet të marrin parasysh ankesat e publikut.

Përveç që u përgjigjet ankesave të publikut, kjo medie në mënyrë aktive e thekson përgjegjësinë e saj përmes transparencës rreth mënyrës së përzgjedhjes së lajmeve dhe përpunimit të tyre. Një nga strategjitë që përdor në këtë drejtim është ajo se në ueb-faqe vendoset materiali i plotë rreth një kronike të caktuar, me ç'rast shikuesit mund ta konfirmojnë lehtë vërtetësinë e storjes përmes analizës së informacioneve nga burimet e theksuara. Përveç kësaj, ekzistojnë termine të caktuara në kuadër të të cilave gazetarët bisedojnë, planifikojnë dhe i vlerësojnë programet mediatike. Edhe redaktorët e stimulojnë diskutimin përmes mbajtjes së kulturës së feedback-ut joformal dhe të hapur. Ata besojnë se në këtë mënyrë u përgjigjen gabimeve në mënyrë adekuate dhe bëjnë korrigjime atëherë kur është e domosdoshme. Instrumentet e reja online, siç janë ueb-blogjet, Twitter dhe rrjeti social, sigurojnë mundësi që gazetarët të bashkëpunojnë drejtpërdrejt me qytetarët.

Në vitin 2005 është vendosur i ashtuquajtimi Nieuwsmonitor, me qëllim që të sigurohen të dhëna të pavarura empirike për përkrahjen e debatit cilësor për çështje të gazetarisë. Gjithashtu, analizohet raportimi i gazetarëve përmes analizës sasiore të përmbajtjeve rreth incidenteve të caktuara. Përveç kësaj, redaktorët e rubrikave, redaktorët e programit dhe gazetarët organizojnë takime koordinative për vlerësimin e raportimit gjatë ditës paraprake, me ç'rast theksi kryesor vihet mbi atë se a ka qenë raportimi mjaft i kuptueshëm për publikun. Takime të tilla organizojnë edhe redaktorët nga rubrikat e jashtme dhe koordinatorët në internet. Që nga viti 2009, televizioni bashkëpunon me rrjetin social Hyves, me ç'rast medie, në bashkëpunim me këtë rrjet, për çdo ditë vendos pyetje për sondazh për numrin e radhës të gazetës.

Gazeta De Volkskrant një kohë të gjatë, përkatësisht që nga viti 1948, shfrytëzon letrat drejtuar redaktorit, si mekanizëm për përgjegjësi ndaj lexuesve. Nga 400 letra që i merr në bazë javore, përzgjidhen dhe publikohen vetëm disa, si në ueb-faqe ashtu edhe në gazetë.

---

28 JoBardoel, Y.D.H (2012) Accountability in the newsroom: Reaching out to the public or a form of window dressing? Studies in Communication Sciences 12 (2012) 17-21

Edhe përkundër faktit se nuk parashikohen sanksione në raste kur gazetarët nuk u përgjigjen ankesave të qytetarëve, redaktori inkurajon që t'u përgjigjen lexuesve. Që nga viti 2009, redaktori përgjegjës u dërgon redaktorëve të tjerë përmbledhjen javore të ankesave të qytetarëve, i informon ata për shqetësimet më të mëdha të publikut dhe i nxit që t'i kuptojnë seriozisht ankesat dhe t'u përgjigjen atyre. Në vitin 1997 është caktuar ombudsman, detyrat e të cilit kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së punës të gazetarëve. Ai një herë në javë shkruan kolumna në numrin e së shtunës të gazetës rreth temës që është ngritur nga lexuesit ose me iniciativë të veten. "Qëllimi i kolumnave nuk është që të qortohen gazetarët, por që të ngrihet vetëdija në plan të brendshëm dhe të sigurohen transparencë dhe shpjegim në plan të jashtëm"<sup>29</sup>. Në vitin 2004 është krijuar hapësirë e veçantë për korrigjime, për të cilën vetë ombudsmani është përgjegjës, ndërsa në të vendosen informata për gabimet e bëra, të vërejtura nga lexuesit, por edhe nga vetë gazetarët.

Gazeta, gjithashtu, bashkëpunon edhe me organizatën për debate mediatike, Mediadebat, e cila është formuar në bashkëpunim me Lidhjen e Gazetarëve të Holandës, Asociacionin e Botuesve të Gazetave dhe servisin radiodifuziv publik NOS. Para disa vitesh është sjellë edhe pjesë e veçantë në kuadër të artikujve (korniza për transparencë), e cila i shpjegon lexuesit se artikulli bazohet në informata objektive, pa çfarëdo qoftë ndikimi komercial apo ndonjë ndikim tjetër. Në vitin 2005 gazeta sjell të ashtuquajturën "agjendë sociale" interaktive, e cila përqendrohet në çështje aktuale me interes, ndërsa prioriteti i tyre përcaktohet në bashkëpunim me lexuesit. Gazeta organizon dhjetëra debate tematike në vit, ndërsa përmes mundësive interaktive në internet është inicuar projekti "Lexues, na thoni", qëllimi i të cilit është që t'u paraprihet çështjeve me interes ose shqetësimeve të publikut. Në mënyrë aktive përdoret edhe rrjeti social që të identifikohet interesi i publikut.

---

29 De Haan, Y. M. (2012) *Between professional autonomy and public responsibility: accountability and responsiveness in Dutch media and journalism*, University of Amsterdam

# 3. ETIKA: PRAKSA, PARIMET DHE SFIDAT

## PËR PUNË ETIKE DHE TË PËRGJEGJSHME TË RADIODIFUZERËVE PUBLIKË NË BE

### 3.1 RËNDËSIA E RADIODIFUZERËVE PUBLIKË DHE VLERAT E TYRE THEMELORE

Mediet e pavarura dhe profesionale janë burim themelor i informimit të qytetarëve për çështje që janë të rëndësishme për një shoqëri. Si shembull për profesionalizëm, servisi radiodifuziv publik duhet të jetë para të gjitha medieve të tjera në një shoqëri, duke marrë parasysh faktin se financohet nga qytetarët dhe, në bazë të kësaj, duhet të raportojë për tema të cilat janë vetëm në interes të publikut.

Përveç rolit që ta informojë opinionin, serviset publike, si edhe të gjitha mediet e tjera, paraqesin një lloj të instrumentit qytetar për kontroll të pushtetit dhe platformë për debat publik në shoqëri, i cili siguron hapësirë për shkëmbim të temave dhe këndvështrimeve të ndryshme që janë në interes të qytetarëve.

Unioni i Radiodifuzerëve Evropian (EBU)<sup>30</sup>, ku bëjnë pjesë 73 servise publike nga 56 vende, në bashkëpunim me anëtarët e saj, i vendos vlerat themelore të këtyre medieve. Këto vlera janë universaliteti, pavarësia, cilësia, shumëllojshmëria, përgjegjësia dhe inovacioni.

- **Universaliteti.** Serviset radiodifuzive publike duhet të aspirojnë drejt një shtrirje sa më të gjërë që është e mundur të emitimit të tyre, si gjeografikisht, ashtu edhe drejt të gjithë qytetarëve, në pajtueshmëri me publikun që e ka si target të parashikuar. Përmbajtjet e programit duhet të jenë të përshtatshme për të gjitha kategoritë e moshave të publikut, por edhe të orientuara drejt të gjitha grupeve të qytetarëve, pa dallim përkatësisë fetare, gjinore, etnike e kështu me radhë, por edhe të kenë program në dispozicion në më tepër gjuhë. Një pjesë e programit duhet të jetë e ndarë edhe për njerëzit me nevoja të veçanta.

30 Në dispozicion në <https://www.ebu.ch/about/members>

Me qëllim që të arrijnë qasje më të madhe, serviset radiodifuzive publike duhet të përcjellin edhe sfidat teknologjike, ndërsa përmbajtjet duhet të jenë të disponueshme në sa më shumë platforma që është e mundur, edhe atë në televizion, radio, online, kabllorik, aparate celulare dhe mënyra të tjera;

- **Pavarësia.** Varet nga më shumë faktorë, por dy faktorët kryesorë janë pavarësia dhe qëndrueshmëria e mënyrës së financimit të tyre, si dhe struktura menaxhuese, e cila duhet të udhëheqë lirshëm me këto medie, në mënyrën e paraparë me ligj. Ka më tepër modele të financimit të sistemeve radiodifuzive publike në vendet evropiane dhe të gjitha duhet të sigurojnë financim të pavarur dhe të qëndrueshëm të këtyre medieve, pa krijimin e varshmërisë nga pushteti ekzekutiv ose nga qendra të tjera të vendosjes. Serviset radiodifuzive publike të pavarura kanë liri në politikën redaktuese të përmbajtjeve, sidomos në programin informativ, ndërsa kështu e fitojnë edhe besimin e publikut. Shkalla e pavarësisë së televizioneve publike në shtet flet edhe për shkallën e demokracisë në të, respektivisht aty ku këto televizione punojnë lirshëm, pa presione nga qendrat e pushtetit, përmbushin rolin e tyre, ndërsa në shembuj të kundërt shërbejnë si instrument për propagandë në favor të ndonjë grupi të caktuar politik apo biznesor;
- **Cilësia.** Përmbajtja programore të cilën e prodhon servisi radiodifuziv publik, pa dallim a bëhet fjalë për program informativ, filmik, dokumentar apo zbavitës, duhet t'i plotësojë standardet më të larta profesionale gazetareske dhe mediatike, me qëllim që ta kënaqë shijen e publikut, por edhe të jetë shembull për mediet komerciale;
- **Shumëllojshmëria.** Në krahasim me mediat komerciale, radiodifuzerët publikë kanë obligim t'i shërbejnë interesit të të gjithë qytetarëve, ndërsa kjo nënkupton prodhimin e programeve në më tepër gjuhë, të destinuar për qytetarë me nevoja të ndryshme. Servisi publik duhet t'i ketë të rinjtë si target grup të veçantë, përmes përmbajtjeve atraktive të prodhuara për ta, në pajtueshmëri me standardet profesionale, por edhe ligjet dhe praktikat që kanë të bëjnë me publikun adoleshent;
- **Përgjegjësia.** Udhëheqja duhet të punojë në mënyrë transparente, përmes publikimit të të gjitha akteve interne, por edhe me qasje inkluzive në krijimin e strategjive të tyre dhe përmbajtjeve të programit, në konsultim me palët e tanguara, siç janë shoqata të ndryshme qytetare

të cilat përfaqësojnë grupe dhe interesa të ndryshme të targetuara. Serviset radiodifuzive publike duhet t'i publikojnë rregullisht raportet e tyre për punën materiale-financiare dhe të mundësojnë debat në opinion për punën e tyre, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së punës;

- **Inovacioni.** Në kohën e zhvillimit të shpejtë teknologjik në industrinë e mediave, servisi publik ka nevojë, por edhe obligim që t'i ndjekë trendet e reja, me qëllim që të jetë kompetitiv në rrethinën e vet medietike, ndërsa kështu edhe t'i plotësojë kërkesat e publikut. Inovacioni duhet të përqendrohet në përmbajtjen e programit, pajisjen teknike, si dhe në zhvillimin e partneritetit me veprimtarë të tjerë të industrisë.

## 3.2 PARIMET DHE REKOMANDIMET NDËRKOMBËTARE PËR PUNËN E SERVICEVE RADIODIFUZIVE PUBLIKE

Nuk ekziston model universal i servisit radiodifuziv publik i cili është i përbashkët për të gjitha shtetet në botë, por ekzistojnë rekomandime dhe parime të përgjithshme nga ana e Këshillit të Evropës dhe UNESCO-s, si dhe direktiva të përkufizuara nga ana e Komisionit Evropian, të cilat i përshkruajnë mënyrat në të cilat duhet të funksionojë servisi publik me qëllim që t'i shërbejë interesit të opinionit. Secili vend anëtar ka për obligim t'i zbatojë të gjitha këto rekomandime dhe parime përmes legjislacionit konkret, me të cilin për së afërmi do të përcaktohet modeli i servisit publik, mënyra përmes së cilës do të financohet, udhëheqja e tij dhe parakushtet e tjera teknike të cilat janë të domosdoshme për funksionim të rregullt të tij.

Rekomandimi (96) 10 i Këshillit të Evropës<sup>31</sup> për pavarësinë e serviseve radiodifuzive publike e thekson rolin e tyre vital si faktor thelbësor për pluralizmin e mediave që janë në dispozicion në nivel nacional dhe rajonal dhe që sigurojnë program gjithëpërfshirës i cili përmban informacion, edukim, kulturë dhe zbavitje të qytetarëve.

---

31 Council of Europe (1996) Recommendation No R (96) 10, në dispozicion në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168050c770>, qasur më 11 nëntor 2016

**Rekomandimi (2012) 1 i Këshillit të Evropës**<sup>32</sup> për menaxhimin e serviseve radiodifuzive publike, përmes sigurimit të përmbajtjes së shumëllojshme dhe të cilësisë së lartë, e thekson rolin e tyre specifik në respektimin e lirisë së informimit. Roli primar i servisit publik është që ta promovojë interesin e përgjithshëm, siç është përparimi social, vetëdija publike për proceset demokratike, mirëkuptimi ndërkulturor dhe integrimi social. Servisi publik nuk mund të jetë burim i rëndësishëm i informatave të sakta, plurale dhe në kohë, nëse nuk është i pavarur nga ndikime të ndryshme politike dhe ekonomike.

**Direktiva e tashme për shërbime audiovizuale mediale**<sup>33</sup> e Komisionit Evropian parashikon një numër të madh masash për vendet anëtare të Bashkimit Evropian me të cilat rregullohen legjislacionet kombëtare në BE, të cilat kanë të bëjnë me radiodifuzerët publikë dhe privatë. Kjo Direktivë përmban më tepër aspekte teknike për mënyrën e funksionimit të medieeve. Përveç kësaj, Direktiva i obligon vendet anëtare të Bashkimit Evropian të kujdesen që përmbajtjet audiovizuale të mos përmbajnë ndonjë lloj nxitje të urrejtjes në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit. Kohëve të fundit po zhvillohet debat publik për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Direktive, me ç'rast vendet anëtare të Bashkimit Evropian diskutojnë për ndryshime në drejtim të përcaktimit plotësues të aspekteve lidhur me video me kërkesë (video on demand) dhe televizionet në internet. Propozim i ri ligjor për ndryshimin e Direktivës ishte miratuar nga ana e Komisionit Evropian më 25 maj të vitit 2016.

**Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkura (UNESCO)**, gjithashtu, synon përforcimin e serviseve radiodifuzive publike, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut në sferën e arsimit, kulturës si dhe rëndësisë së shoqërisë civile. Në këtë drejtim, UNESCO, me qëllim që të vlerësojë nëse serviset radiodifuzive

---

32 Council of Europe (2012) Recommendation CM/Rec(2012)1 në dispozicion në: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805cb4b4](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cb4b4), qasur më 21 nëntor 2016

33 European Commission (2010), Audiovisual Media Services Directive, në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/audiovisual-media-services-directive-avmsd>, qasur më 1 dhjetor 2016



publike e plotësojnë misionin dhe vizionin e tyre në një shtet, ka përgatitur indikatorë specifikë të cilët janë në kornizat e Indikatorëve për zhvillimin e medie<sup>34</sup>. Indikatorët kryesorë për punën e serviseve radiodifuzive publike, sipas UNESCO-s, janë:

- 1. Qëllimet e serviseve radiodifuzive publike janë të përkufizuara dhe garantuara me ligj;**
- 2. Puna e serviseve radiodifuzive publike nuk nënkupton diskriminim në asnjë sferë;**
- 3. Mënyra e menaxhimit është e pavarur dhe transparente dhe;**
- 4. Serviset radiodifuzive publike përfshijnë opinionin dhe organizatat qytetare në punën e tyre, por edhe organet për menaxhim.**

Autonomia institucionale dhe pavarësia redaktuese e serviseve radiodifuzive publike duhet të garantohen me ligj në secilin shtet veç e veç, i cili, para se gjithash, siguron burim të qëndrueshëm të financimit, si dhe proces transparent dhe të paanshëm të zgjedhjes së organeve drejtuese, por edhe kompetencë adekuate dhe liri në punën e tyre. Këto parime, rekomandime dhe direktiva shërbejnë si drejtime të cilat duhet t'u ndihmojnë shteteve që ta krijojnë kornizën e tyre ligjore, me ç'rast duhet ta kenë parasysh kontekstin specifik i cili është karakteristik për secilin shtet veçmas. Përveç kësaj, gjatë krijimit të legjislacionit duhet të merren parasysh udhëzimet e organizatave profesionale qytetare të cilat janë pjesë e bashkësisë gazetareske dhe mediatike.

---

<sup>34</sup> UNESCO (2010) Media Development Indicators: A Framework for Assessing Media Development, në dispozicion në <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001631/163102e.pdf>, qasur më 8 nëntor 2016

### 3.3 KORNIZAT ETIKE NË SERVISSET RADIODIFUZIVE PUBLIKE – VËSHTRIM KRAHASUES

Serviset radiodifuzive publike, përmes punës së tyre, përmes respektimit të parimeve etike, duhet t'i promovojnë standardet më të larta profesionale të bashkësisë gazetareske. Pikërisht për këtë shkak, disa prej tyre kanë sistem të zhvilluar të vetërregullimit, ose janë anëtarë të këshillave për vetërregullim mediatik, me qëllim që ta përmirësojnë cilësinë e tyre të punës. Modelet dallojnë, ndërsa si forma më të shpeshta janë ombudsmanët e brendshëm, komisionet e brendshme për etikë dhe ankesa ose modele sipas të cilave servisi publik merr pjesë në punën e një trupi të pavarur vetërregullues që vepron në mënyrë të pavarur, që gjendet jashtë strukturës së servisit radiodifuziv publik, ose që është kombinim i të gjithave bashkë.

Varësisht nga konteksti lokal në secilën shoqëri, modelet e ndryshme kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Kështu, me ombudsman të brendshëm, serviset radiodifuzive publike tregojnë gatishmëri për të qenë të hapura dhe përgjegjëse, ndërsa në të njëjtën kohë ulet nevoja për kontroll të jashtëm, duke marrë parasysh faktin se radiodifuzeri obligohet që të thirret në përgjegjësi nga ana e kontrollorit të tij të pavarur. Pavarësisht se cili model praktikohet, në rast të shkeljes së standardeve profesionale, ajo që është me rëndësi është se ombudsmani ose komisioni do të kenë vendime të besueshme dhe relevante të cilat do të publikohen nga ana e medias. Dokument themelor në procesin e vetërregullimit efikas është kodi për etikë, ose, sipas praktikës, secili servis radiodifuziv publik ka dokument të tillë të veçantë. Përveç kodeve, një pjesë e radiodifuzerëve publikë kanë edhe parime të veçanta për raportim në periudhë zgjedhesh dhe fushatash parazgjedhore, parime të veçanta për reklama dhe promovime e të ngjashme.

Në kontekst të kësaj përmbledhjeje i shqyrtojmë kornizat etike në vendet e rajonit, përkatësisht të Kroacisë dhe Sllovenisë.

**Radio-televizioni kroat (HRT) në vitin 2013 miratoi kod të ri etik për gazetarët dhe ekipin kreativ në HRT<sup>35</sup>.** Me këtë Kod rregullohen

35 Hrvatska radiotelevizija (2013) Eticki kodeks za novinare i kreativno osoblje në dispozicion në [http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Eticki\\_kodeks\\_za\\_novinare\\_i\\_kreativno\\_osoblje\\_HRT\\_a.pdf](http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Eticki_kodeks_za_novinare_i_kreativno_osoblje_HRT_a.pdf), qasur më 11 nëntor 2016

standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarëve dhe ekipit kreativ në krijimin e përmbajtjeve të radios dhe përmbajtjeve audiovizuale mediatike, si dhe prodhimet e tjera mediatike të përpunuara nga vetë HRT ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë.

Në dispozitat e përgjithshme të këtij kodi theksohet se censura është e ndaluar në secilën fazë të krijimit dhe emitimit të përmbajtjes mediatike. Neni 2 shton se HRT është servis publik i cili siguron shërbime me interes publik, me qëllim që ta përmirësojë mirëqenien publike dhe kohezionin social të qytetarëve, si dhe të promovohen pluralizmi dhe shumëllojshmëria kulturore përmes programit të destinuar për të gjithë qytetarët.

Kapitulli 2 u kushtohet standardeve profesionale dhe parimeve etike dhe ato janë për gazetarët dhe kuadrin kreativ në jetën e tyre publike, përfshirë edhe komunikimin e tyre në rrjetin social. Kujdes i veçantë i kushtohet:

- **Sjelljes ndaj shtetit, pushtetit, partive politike.**- Në punën e tyre gazetarët nuk guxojnë të theksojnë asnjë lloj përkatësie apo anshmërie, por duhet të jenë objektivë dhe të pavarur;
- **Kronika e zezë, procedura gjyqësore dhe ngjarje të jashtëzakonshme.**- Raportimi për aktivitete kriminale, aksidente në komunikacion dhe ngjarje të tjera të jashtëzakonshme nuk duhet të paraqiten me sensacionalizëm në programet informative, me qëllim që të pengohet përhapja e panikut mes shikuesve dhe dëgjuesve;
- **Fëmijë dhe grupe të tjera sociale.**- Adoleshentët nuk guxojnë të jenë pjesë e programit pa marrë leje nga tutori, ndërsa ndalohej edhe kompensimi i tutorëve me qëllim që të merret leja e tyre. Kjo pjesë trajtohet hollësisht dhe potencohet që gjatë marrjes së deklaratave nga fëmijët, pyetjet nuk duhet të jenë qëllimkëqija, sugjестive ose ironike.

Kapitulli i tretë ka të bëjë me standardet dhe parimet e tjera profesionale dhe këtu në fokus të veçantë janë: fushata parazgjedhore, reklama dhe situata në të cilat gazetarët kanë konflikt interesi në mënyrën e tyre të raportimit.

Kapitulli i veçantë i kushtohet raportit mes gazetarëve dhe redaktorëve. Shembull interesant është se redaktori ka të drejtë të ndërhyjë në

kronikën e një gazetari vetëm nëse vlerëson se shkelet Kodi ose ligjet, me ç'rast e informon gazetarin ose udhëheqësin, ndërsa nëse i kërkohet nga gazetari, redaktori e ka për obligim që ta arsyetojë edhe me shkrim arsyen e ndryshimit.

Kapitulli 6 e arsyeton punën e **Komisionit etik**, i cili ka të drejtë dhe obligim të sjellë mendime dhe vendime rreth shkeljeve të Kodit. Për dorëzimin e parashtrës ekziston procedurë e veçantë e cila shpjegohet në Kod, ndërsa të drejtë ankese ka secili. Komisioni është i përbërë nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga kryeredaktori (3 anëtarë), drejtori i produksionit (2 anëtarë), redaktori i programit informativ (2 anëtarë), gazetarët, përkatësisht Shoqata e Gazetarëve të Kroacisë (2 anëtarë).

Përveç Kodit, HRT, në të njëjtën kohë, ka miratuar edhe **Rregulla të përgjithshme për punën dhe sjelljen e të punësuarve**, akt ky i veçantë<sup>36</sup> me të cilin definohen standardet profesionale dhe etike në sjelljen e të gjithë të punësuarve në HRT. Rregullat e përgjithshme vlejné për të gjithë të punësuarit në HRT, përfshirë këtu edhe drejtorin e përgjithshëm të HRT-së.

Si akt i veçantë i brendshëm në HRT i cili është në drejtim të promovimit të standardeve etike, është edhe **Plani për barazi gjinore**<sup>37</sup>, i cili është miratuar në nëntor të vitit 2010. Plani vendos zero tolerancë ndaj diskriminimit në bazë të përkatësisë gjinore, implementim të parimeve për barazi të gjinive, si dhe mekanizëm për mbrojtje në rast të diskriminimit në lidhje me gjininë.

**Radio Televizioni Sllovenia (RTV) – Standardet dhe parimet profesionale të etikës gazetareske**<sup>38</sup> në programet e RTV Sllovenia,

36 Hrvatska radiotelevizija (2013) Opcapravila o raduiponasanju, në dispozicion në: [http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Opca\\_pravila\\_o\\_radu\\_i\\_ponasanju\\_zaposlenika.pdf](http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Opca_pravila_o_radu_i_ponasanju_zaposlenika.pdf), qasur më 9 nëntor 2016

37 European Institute for Gender Equality (2010), Gender Mainstreaming – A Strategy to Achieve Equality Between Women and Men, në dispozicion në: <http://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-and-tools/croatia/croatian-radiotelevision-self-regulation-tools-action-plan-gender-equality-and-ethical-codex>, qasur më 2 dhjetor 2016

38 RTV Slovenia (2000) Professional Standards, në dispozicion në: <http://www.rtv slo.si/strani/professional-standards/17>, qasur më 2 nëntor 2016

të cilat janë miratuar nga ana e Këshillit të RTV Sllovenia më 18 maj të vitit 2000. Kodi i RTV Sllovenia shfrytëzohet si udhërrëfyes në punën e gazetarëve dhe ekipit kreativ dhe është përpunuar në bazë të shembujve të kodeve të serviseve radiodifuzive publike të Britanisë së Madhe, Kanadasë dhe Gjermanisë.

Ky kod është më detal, me dallim nga shembulli i Kroacisë, dhe është i ndarë në gjithsej 22 kapituj, të cilat kanë të bëjnë me: standardet e përgjithshme profesionale, standardet e shumëllojshmërisë dhe balancimit në raportim, raportimin në periudhën e zgjedhjeve dhe fushatës zgjedhore, raportimin për partitë politike, politikanët dhe Parlamentin, standardet për sondazhe të opinionit publik, rregullimin e raportit mes RTV Sllovenia dhe organeve shtetërore dhe qeveritare, standardet për gazetari hulumtuese dhe përpunim të informatave, standardet për respektimin e vlerave të shikuesve dhe dëgjuesve (raportimi për tema lidhur me shëndetësinë, dhunën e të ngjashme), raportimin për tema të interesit të veçantë (tema për grupe të ndryshme religjioze, pakica etnike dhe të ngjashme), raportimin për tema që kanë të bëjnë me pjesë të veçanta të shoqërisë (tema lidhur me çështjet gjinore, të njerëzve me nevoja të veçanta e të ngjashme), standardet etike lidhur me tema për fëmijë dhe adoleshentë në programet e RTV Sllovenia, të drejtën për korrigjim dhe përgënjeshttrim.

Në kapitullin 18 parashikohet edhe obligimi që RTV Sllovenia të sigurojë ndihmë ligjore për gazetarët dhe redaktorët kur janë të paditur, madje edhe në situata kur ata kanë shkelë parimet etike.

Gjithashtu, në kapitullin 19 pjesë përbërëse e Kodit janë edhe parimet etike për reklamimin, promovimin dhe sponsorimet në programin e RTV Sllovenia, të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e reklamave që emitohen dhe potencohet se duhet të jenë në pajtueshmëri me **Kodin slloven për reklamim**<sup>39</sup>.

Dy kapitujt e fundit të Kodit etik kanë të bëjnë me konfliktet e interesit dhe të drejtat dhe obligimet, si dhe Kodin e veshjes për gazetarët dhe prezantuesit radio-televizivë, në pajtueshmëri me konceptin e programit të medias.

---

39 Slovenska Oglasevalska Zbornica (2009) Slovenski oglasevalski kodeks, në dispozicion në: [http://www.soz.si/sites/default/files/soz\\_sok\\_slo.pdf](http://www.soz.si/sites/default/files/soz_sok_slo.pdf), qasur më 13 nëntor 2016

Kodi përmban udhëzime për mënyrat e raportimit të gazetarëve për tema që kanë të bëjnë me pjesë të veçanta të shoqërisë në Slloveni. Vëmendje të veçantë në Kod u kushtohet temave që kanë lidhje me gratë, fëmijët, bashkësitë religjioze, njerëzit me nevoja të veçanta, pakicat seksuale, njerëzit e moshuar, si dhe temave që lidhen me dhembjen dhe vuajtjen emocionale e të ngjashme.

Në situata kur shkelet Kodi, sipas kapitullit 16, Ombudsmeni i RTV Sllovenisë është organi përgjegjës i cili vendos për parashtresat dhe publikon vendime. Sipas Kodit, qytetarët, pikë së pari, dorëzojnë parashtresa, propozime ose sugjerime te kryeredaktorët e RTV Sllovenia, dhe në rast kur nuk janë të kënaqur me përgjigjen, i drejtohen Ombudsmanit, i cili, nga ana tjetër, për punën e tij përgjigjet përpara Këshillit të Programit të RTV Sllovenia.

Në vitin 2008, Servisi radiodifuziv publik i Sllovenisë e emëroi Misha Mollk, prezantues televiziv në RTV Sllovenia, për ombudsman të saj të parë. Gazetari Mollk paraqitet rregullisht në emisione televizive, ku u përgjigjet pyetjeve dhe komenteve publike lidhur me punën dhe përmbajtjen e programit të RTV-së. Ai, gjithashtu, e informon opinionin në blogun: <http://www.rtv slo.si/blog/misamolck>.

## 4. SFIDAT NË RAPORTIMIN PËR TEMA SENSITIVE

### 4.1 RAPORTIMI I PËRGJEGJSHËM DHE ETIK PËR VETËVRASJET

Vetëvrasjet janë problem i madh në shoqëri, me pasoja të thella shoqërore, emocionale dhe ekonomike. Sipas evidencës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, "në nivel global vetëvriten pothuajse një milion njerëz në vit, ndërsa vlerësohet se nga këto ngjarje mesatarisht preken të paktën gjashtë njerëz"<sup>40</sup>. Mediet kanë rol të madh në qëllimin që të

40 World Health Organization (2008) Preventing Suicide – A Resource for Media Professionals, në dispozicion në: [http://www.who.int/mental\\_health/prevention/suicide/resource\\_media.pdf](http://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_media.pdf), qasur më 11 nëntor 2016

kuptohen faktorët që kontribuojnë për këtë problem, si dhe të edukohet opinioni për këtë lloj të problemit shoqëror, në veçanti të udhëzohen ata të cilët përballen me rrezik të sjelljes së tillë që të kërkojnë ndihmë adekuate.

Nga ana tjetër, grupet e ndjeshme të qytetarëve mund të jenë nën ndikim të fuqishëm të raportimeve mediatike për vetëvrasje dhe si pasojë të synojnë të marrin jetën e vet, duke përsëritur veprën e njëjtë, sidomos nëse bëhet fjalë për përshkrim të hollësishëm, sensacional dhe eksplicit të vetëvrasjes.

Vard (Ward, 2009), nga ana tjetër, vlerëson se "është gabim që raportimi për tragjeditë e tilla të shikohet si eksploatim i pashmangshëm i temës. A është eksploatim, varet nga mënyra në të cilën informohet për ngjarjen"<sup>41</sup>. Sipas Vard, vetëvrasjet ndonjëherë me të vërtetë janë ngjarje e vlefshme për publikim, sidomos kur vetëvrasje kanë kryer persona publikë ose të tillë që janë pjesë e ndonjë problemi më të gjerë. Ai këshillon që gazetarët të mbajnë evidencë për ngjarjet, me ç'rast disa nga këto probleme të mos mbeten pas dyerve të mbyllura, duke lënë hapësirë për diskutim në opinion që bazohet në thashetheme dhe spekulime.

Në një numër të madh shtetesh, mediet kanë ndërmarrë iniciativa përmes përgatitjes së kodeve për etikë që adresojnë çështjen e vetëvrasjeve. Për shembull, në Danimarkë, Estoni, Gjermani, Norvegji, Lituani dhe Suedi kodet për raportim etik përmbajnë udhëzime për gazetarët kur raportojnë për këtë problem. Në Britani të Madhe, ku nuk ekzistojnë kufizime të veçanta ligjore lidhur me raportimin për vetëvrasje, nga ana e organizatave si Press Wise Trust dhe Samaritans, janë përgatitur resurse për të ndihmuar mediet kur raportojnë rreth kësaj çështjeje.

Në kuadër të iniciativës botërore për pengimin e vetëvrasjeve (SUPRE), Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 2000 publikoi "Resurs për profesionistët mediatik"<sup>42</sup>.

---

41 Ward, S.J.A (2009) Covering Tragedy: Do Journalists Exploit Suicide, Center for Journalism Ethics

42 ibid

Ekzistojnë shumë kuptime dhe perceptime të gabuara rreth problemit të vetëvrasjeve, ndërsa mediet mund të luajnë rol të rëndësishëm në shkatërrimin e miteve të tilla. Faktorët që çojnë te vetëvrasjet zakonisht janë më shumë dhe më kompleksë dhe, sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për to nuk duhet të raportohet në mënyrë të thjeshtë. Përkundrazi, mediet duhet t'i shqyrtojnë faktorët e ndryshëm, mes të cilëve edhe faktorët kulturorë, gjenetikë dhe socio-kulturorë.

Më tej, është e nevojshme që të shmanget fjalori me të cilin vetëvrasja sensacionalizohet ose paraqitet si zgjidhje për problemet. Vendosja qendrore e këtyre temave në medie me më shumë mundësi do të sjellë te sjellja repetitive, kështu që, duke u nisur nga kjo, rekomandohet që temat e tilla të gjenden në faqet e brendshme të gazetës, në vend që të jenë në ballinë, ose të emitohen më vonë gjatë lajmeve në radio dhe televizion. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar sidomos kur metoda e vetëvrasjes është e pazakonshme, sidomos për shkak se mund të nxisë edhe njerëz të tjerë që ta bëjnë të njëjtën gjë. Rekomandimi i njëjtë për raportim të vëmendshëm vlen edhe në rastet kur bëhet fjalë për zbulimin e lokacionit të vetëvrasjes. "Duhet pasur kujdes të veçantë që të mos promovohen lokacionet si vend për vetëvrasje, për shembull, përmes shfrytëzimit të fjalorit sensacionalist për të përshkruar këto vende, ose me tejtheksimin e numrit të incidenteve që kanë ndodhur aty"<sup>43</sup>. Nuk guxojnë të përdoren as fotografi ose video incizime nga skena dhe as incizime të personit i cili është vetëvrasës. Nëse vlerësohet se është e nevojshme që të përdoren materiale të tilla, është e domosdoshme të sigurohet pajtueshmëri eksplicite nga anëtarët e familjes.

Vetëvrasjet e personave të njohur janë ngjarje që ia vlen të publikohen, sepse konsiderohet se është interes publik, por edhe këtu është e domosdoshme vëmendje e veçantë, duke marrë parasysh mundësinë e përsëritjes së aktit të tillë nga kategoritë e ndjeshme të qytetarëve. Mediet, gjithashtu, duhet të sigurojnë informata për vendet ku mund të kërkohet ndihmë, gjë që është në dobi të veçantë për individët të cilët përballen me depresionin.

---

43 ibid, 9



## 4.2 RAPORTIMI I PËRGJEGJSHËM DHE ETIK PËR FËMIJËT ADOLESHENTË

Fëmijët dhe të rinjtë i kanë të gjitha të drejtat sikurse edhe të rriturit, ndërsa përveç asaj kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga çfarëdo lloj dëmi. Parimet bazë të UNICEF-it<sup>44</sup>, kur bëhet fjalë për raportim për fëmijë dhe të rinj janë si vijojnë:

- 1. Dinjiteti dhe të drejtat e secilit fëmijë duhet të respektohen në të gjitha rrethanat;**
- 2. Gjatë intervistimit dhe raportimit për fëmijët është e nevojshme që t'i kushtohet vëmendje të drejtës së privacisë dhe diskrecionit, të dëgjohen mendimet e tyre, të marrin pjesë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me ta dhe të mbrohen nga çdo e keqe ose hakmarrje;**
- 3. Interesat më të mira për çdo fëmijë duhet të jenë të mbrojtura mbi të gjitha interesat e tjera, duke përfshirë edhe përfaqësimin për problemet e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre;**
- 4. Gjatë tentativës që të konstatohen interesat më të mira të fëmijëve, është e nevojshme që t'i kushtohet rëndësi adekuate të drejtës së fëmijës që t'i shprehë pikëpamjet e tij, në pajtueshmëri me moshën dhe pjekurinë e tij;**
- 5. Është e nevojshme të konsultohen ata të cilët e njohin për së afërmi situatën e fëmijës dhe që kanë qasje më të lehtë deri te ajo, për pasojat e mundshme shoqërore dhe kulturore për çfarëdo lloj raportimi;**
- 6. Të mos publikohen storje ose fotografi që mund t'i sjellë në situatë rreziku fëmijët, vëllezërit ose motrat e tyre, apo bashkëmoshatarët e tyre, madje as kur ndërrohet identiteti i tyre, kur mjegullohen fytyrat, ose kur aspak nuk përdoret identiteti i tyre.**

Nga ana tjetër, Mediawise, UNICEF dhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve kanë ndërmarrë iniciativë ndërkombëtare për të promovuar

44 UNICEF, Principles and Guidelines for Ethical Reporting – Children and Young People Under 18 years old, në dispozicion në [https://www.unicef.org/uganda/Guidelines\\_for\\_Reporting\\_on\\_Children1.pdf](https://www.unicef.org/uganda/Guidelines_for_Reporting_on_Children1.pdf), qasur më 14 dhjetor 2016

mirënjohjen se gazetarët luajnë rol pozitiv në zhvillimin e qasjeve të reja në përfaqësimin mediatik të fëmijëve, promovimin e të drejtave të tyre dhe për kontributin drejt përpjekjeve për ngritjen e vetëdijes profesionale rreth nevojës për çrënjosjen e të gjitha formave të eksploatimit të fëmijëve.

Në një numër të madh kodesh etike, mediet paralajmërohen rreth raportimit diskriminues ose për rreziqet nga inkurajimi i diskriminimit në bazë të përkatësisë gjinore, orientimit seksual, religjionit, gjuhës, e të tjera. Njëkohësisht, disa prej tyre në këtë listë e shtojnë edhe "moshën", që u jep bazë gazetarëve që të thirren në këtë pjesë, kur bëhet fjalë për raportimin rreth temave që kanë të bëjnë me fëmijët. Megjithatë, kjo pjesë më shumë ka të bëjë me njerëzit e moshuar se sa me fëmijët.

Në Kodin për Etikë të Gazetarëve të **Slovenisë**<sup>45</sup> kërkohet që gazetarët të kenë "sidomos taktikë dhe të jenë më të vëmendshëm kur raportojnë për incidente, ngjarje tragjike në familje, sëmundje, fëmijë dhe adoleshentë". Në Kartën për përgjegjësitë e gazetarëve në Itali<sup>46</sup> ka një pjesë të veçantë e cila ka të bëjë me fëmijët ose njerëzit e kategorive të prekshme, me ç'rast potencohet se "gazetari i respekton të gjitha parimet që janë të konfirmuara në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve të vitit 1989, për mbrojtjen e fëmijëve, për mbrojtjen e karakterit dhe personalitetit të tyre". Në Kodin Etik për profesionalistët në medie të **Lituanisë**<sup>47</sup> këmbëngulet që gazetari "të tregojë respekt adekuat ndaj të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve me pengesa fizike ose mentale". Neni 11 në Kodin e medie në **Gjermani**<sup>48</sup> thotë se "dhuna dhe brutaliteti nuk guxojnë të sensacionalizohen. Raportimi duhet të marrë parasysh nevojën e mbrojtjes së të rinjve". Në Kodin

45 EthicNet, Code of Ethics of Slovene Journalists, në dispozicion në: [http://ethicnet.uta.fi/slovenia/code\\_of\\_ethics\\_of\\_slovene\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/slovenia/code_of_ethics_of_slovene_journalists), qasur më 1 nëntor 2016

46 EthicNet, Charter of Duties of Journalists in Italy, në dispozicion në: [http://ethicnet.uta.fi/italy/charter\\_of\\_duties\\_of\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/italy/charter_of_duties_of_journalists), qasur më 9 nëntor 2016

47 EthicNet, Code of Ethics of Lithuanian Journalists and Publishers, në dispozicion në: [http://ethicnet.uta.fi/lithuania/code\\_of\\_ethics\\_of\\_lithuanian\\_journalists\\_and\\_publishers](http://ethicnet.uta.fi/lithuania/code_of_ethics_of_lithuanian_journalists_and_publishers), qasur më 8 nëntor 2016

48 Presserat, German Press Code, në dispozicion në: [https://www.presserat.de/fileadmin/user\\_upload/Downloads\\_Dateien/Pressekodex13english\\_web.pdf](https://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex13english_web.pdf), qasur më 28 tetor 2016

për Etikë të **Kroacisë**<sup>49</sup> thuhet se “kujdesi dhe përgjegjësia e veçantë është e domosdoshme kur raportohet për incidente, tragjedi familjare, sëmundje, për fëmijë dhe adoleshentë...”.

Sipas asaj që është nënvizuar në Qëllimet e zhvillimit mijëvjeçar<sup>50</sup>, profesionistët mediatikë duhet të synojnë që të përqendrojnë vëmendjen në temat që i tangojnë fëmijët në shoqëri, si janë, për shembull, kushtet sociale, çrrënjësia e urisë dhe çështje të tjera si arsimi, qëndrueshmëria dhe të tjera.

Në Udhëzimet e UNICEF-it, mes tjerash, theksohet fuqishëm nevoja që të mos stigmatizohen fëmijët, të sigurohet konteksti i vërtetë për temat që kanë të bëjnë me fëmijët, të mbrohet identiteti i tyre, si dhe të konfirmohet vërtetësia e asaj që e thotë vetë fëmija, pa dallim nëse kjo do të bëhej me fëmijë të tjerë apo me njerëz të rritur.

### 4.3 RAPORTIMI I PËRGJEGJSHËM DHE ETIK PËR KONFLIKTE

Mediet shpeshherë janë mes elementeve të para në shoqëri të cilat keqpërdoren gjatë kohës së konflikteve. Madje edhe para se të ndodhë vetë konflikti, palë të ndryshme këmbëngulin që të vendosin kontroll ndaj medieve, me qëllim që të ndikojnë ndaj informatave dhe qëndrimeve në drejtim të interesave të tyre. “Ata të cilët nuk i shijojnë drejtpërdrejt dhe personalisht konfliktet, bëhen pjesë e tyre pikërisht për shkak të medieve”<sup>51</sup>. Përkundër shfrytëzimit aktiv të medieve nga ana e palëve të ndryshme në konflikt, ata mund të kontribuojnë edhe vetë, pa vetëdije, drejt përplasjes. Provokimi i tillë pasiv i dhunës më së shpeshti ndodh kur gazetarët kanë aftësi të dobëta profesionale, kur kultura mediatike nuk është e zhvilluar mjaftueshëm, ose kur nuk ka pasur mjaftueshëm ose nuk ka ekzistuar fare histori e pavarësisë në punën e medieve. “Në kushte të tilla, gazetarët

49 EthicNet, Honour Codex of Croatian Journalists, достапен на: [http://ethicnet.uta.fi/croatia/honour\\_codex\\_of\\_croatian\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/croatia/honour_codex_of_croatian_journalists), пристапено на 17 ноември 2016

50 Millenium Project (2006) Millenium Development Goals, në dispozicion në: <http://www.unmillenniumproject.org/goals/>, qasur më 12 nëntor 2016

51 Balanova, E. (2007) Media, Wars and Politics – Comparing the Incomparable in Western and Eastern Europe, Ashgate Publishing Company

mund të përforcojnë mllefin dhe të promovojnë stereotipe, edhe përkundër asaj që qëllimet e tyre nuk janë në atë drejtim, ose nuk janë të manipuluar nga ndonjë trup i jashtëm. Skenari i tillë është më i rrallë sesa situatat kur mediet janë të manipuluar në mënyrë aktive, por gjithsesi, nuk është skenar më pak i rrezikshëm<sup>52</sup>.

Disa teoricienë konsiderojnë se si propagandë në medie vlerësohet edhe përqendrimi mbi deklaratat e liderëve. Kjo përfshin përsëritjen e qëndrimeve qeveritare, pa bërjen e komenteve, me çka "gazetarëve u mundësohet të pohojnë se janë neutralë për shkak se, thjesht, kanë përcjellë informatat"<sup>53</sup>.

Mungesa e informatave në cilëndo fazë të konfliktit mundëson manipulimin e njerëzve, rritjen e mosbesimit dhe frikës. Aftësia që të merren vendime mbi bazën e informimit të mirë e përforcon shoqërinë, strukturat demokratike dhe perspektivat për zhvillim pozitiv në të ardhmen. Pikërisht për këtë shkak, Deklarata Mijëvjeçare e Kombeve të Bashkuara e thekson nevojën "për sigurimin e lirisë që mediet të mund të realizojnë rolin e tyre thelbësor dhe të drejtën e opinionit që të ketë qasje te informatat"<sup>54</sup>.

Ross Howard përshkruan se çfarë mund të bëjë gazetaria profesionale për zgjidhjen e konflikteve. Ai thotë se mediet mund të bëjnë si vijon:

- 1. Ta kanalizojnë komunikimin;**
- 2. Të bëjnë edukimin;**
- 3. Të krijojnë besim;**
- 4. Të korrigjojnë paraqitjet e gabuara;**
- 5. Të humanizojnë duke vendosur njerëzit e vërtetë në storje;**
- 6. T'i përcaktojnë interesat e përbashkëta;**
- 7. Të mundësojnë shprehje emocionale;**
- 8. Të bëjnë kornizë të konfliktit;**

52 FrohardtM., Temin J. (2003) Use and Abuse of Media in Vulnerable Societies, Washington DC, United States Institute of Peace

53 Shah, A. (2005) War, Propaganda and the Media Global Issues.(online) në dispozicion në <http://www.globalissues.org/article/157/war-propaganda-and-the-media>, qasur më 1 nëntor 2016.

54 United Nations (2000) United Nations Millenium Declaration, në dispozicion në <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.htm>, qasur më 29 nëntor 2016

- 9. Të mundësojnë që të arrihet zgjidhje;**
- 10. Të inkurajojnë ekuilibrin e fuqisë<sup>55</sup>.**

Në Planin aksionar të UNESCO-s për kulturën e paqes, mes tjerash, rekomandohet:

- **Përkrahje e rolit të rëndësishëm të medieve në promovimin e kulturës së paqes;**
- **Sigurimi i lirisë së medieve dhe lirisë së informimit dhe komunikimit;**
- **Shfrytëzimi efikas i medieve për përfaqësimin dhe distribuimin e informatave për kulturën e paqes.**

## **4.4 REKOMANDIME PËR RAPORTIMIN PËR GRUPE DHE INDIVIDË TË MARGJINALIZUAR**

Në kontekst të kësaj analize, me termin të margjinalizuar nënkuptojmë individë dhe grupe të cilët janë pa ndikim dhe të izoluar dhe të cilët kanë qasje të shkurtuar ose të kufizuar të drejtat sociale, ekonomike, politike dhe kulturore, të cilat i gëzojnë të tjerët. Këtu mund t'i numërojmë njerëzit me nevoja të veçanta, me sëmundje të rënda, të varfërit, refugjatët, të pastrehët, të papunësuarit, etj.

Kur flitet për të ashtuquajturat grupe të margjinalizuara, mediet shpeshherë i margjinalizojnë edhe më tej, edhe atë të paktën në dy mënyra. E para, grupet e margjinalizuara ofendohen dhe, e dyta, mënyra e paraqitjes së tyre është mënyrë stereotipe dhe sensacionale.

Këshilli i Evropës solli Rekomandimin (2006) <sup>56</sup> me të cilin promovohen të drejtat dhe pjesëmarrja e plotë e njerëzve me nevoja të veçanta në shoqëri. Në këto Rekomandime ka një numër të madh përcaktimesh që kanë të bëjnë me radiodifuzionin. Nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës kërkohet që të nxisin sektorin radiodifuziv dhe industrinë përkatëse kreative që të mundësojnë kushte për qasje te programet

---

<sup>55</sup> Howard R., (2003). Conflict Sensitive Journalism, *IMPACS*, 8-9, Denmark.

<sup>56</sup> Council of Europe (2006), Recommendation Rec(2006)5 në dispozicion në: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805af657](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805af657), qasur më 3 dhjetor 2016

për njerëz me nevoja të veçanta, si dhe të publikojnë plane për rritjen e punësimit në medie të njerëzve me nevoja të veçanta.

Në Konventën e OKB-së për të drejtat e njerëzve me nevoja të veçanta<sup>57</sup>, mediet inkurajohen që t'i paraqesin këta persona në mënyrë që është në pajtueshmëri me qëllimin e Konventës. Në nenin 21 të Konventës, mediet inkurajohen që t'u mundësojnë këtyre personave qasje të shërbimet e tyre.

Mediet duhet të pranojnë përgjegjësinë e tyre në përfaqësimin e njerëzve me nevoja të veçanta në mënyrë të vërtetë dhe të ndershme, të liruar nga stereotipet dhe anshmëria. "Përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me njerëzit me nevoja të veçanta, gazetari do të njihet më mirë me problemet me të cilat ballafaqohen ata, si dhe me pritjet e tyre. Ata më së miri mund t'i përcjellin se si ndihen edhe lidhur me stereotipet e opinionit që drejtpërdrejt ndikojnë në jetën e tyre të përditshme"<sup>58</sup>.

Për gazetarin duhet të paraqesë sfidë profesionale zbulimi i rrënjëve të problemeve që ndodhin në shoqëri dhe mënyrat e mundshme për zgjidhjen e tyre. Më së miri për gazetarët është të konsultojnë informata relevante dhe të besueshme, ndërsa nëse njerëzit me nevoja të veçanta nuk dëshirojnë të flasin, atëherë është më mirë që biseda të bëhet me njerëz nga rrethi i tyre. Mediet luajnë rol të rëndësishëm në ndryshimin e mënyrës së shprehjes ndaj këtyre njerëzve. "Me rëndësi të veçantë është edhe vëmendja për kontekstin kur raportohet për këta persona, që të mos krijohen perceptime të gabuara tek opinioni"<sup>59</sup>.

---

57 United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities and Optional Protocol, në dispozicion në: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>, qasur më 14 nëntor 2016

58 Tuneva, M., Kamenjarova – Petreska, E. (2010) Mediat, qytetarët dhe komunikimet interkulturore, Shkolla e lartë për gazetari dhe marrëdhënie me publikun

59 Tuneva, M. (2010) Diversity Reporting Handbook, School of Journalism and Public Relations, në dispozicion në: [http://www.cestim.it/argomenti/08media/2011-Diversity-Reporting-Handbook\\_EN.pdf](http://www.cestim.it/argomenti/08media/2011-Diversity-Reporting-Handbook_EN.pdf), qasur më 12 nëntor 2016







## 1. ETIKA MEDIATIKE DHE VETËRREGULLIMI NË MAQEDONI

### 1.1 VETËRREGULLIMI – PIKËREFERIMI KONSTITUTIV I SISTEMIT MEDIAL DEMOKRATIK

Vetërregullimi në medie konsiderohet si një nga veçoritë specifike konstitutive të karakterit demokratik të një sistemi mediatik. Me themelimin e Komisionit të Haçinsit për lirinë e shtypit (Commission on Freedom of the Press) pranë Këshillit të parë informativ nacional (NationalNewsCouncil) i formuar në SHBA pas Luftës së Dytë Botërore, etablohet teoria për “përgjegjësi shoqërore” e medieeve dhe për standardet profesionale në medie<sup>60</sup>. Që atëherë paraqiten dy distinkcione të rëndësishme teorike në lidhje me raportin e shtetit ndaj lirisë së shtypit. Njëra, që “përgjegjësia shoqërore” e medieeve nuk duhet të arrihet përmes intervenimit të shtetit në sferën e medieeve, por përmes vetërregullimit. Nga ana tjetër, është obligim i medieeve që të mbajnë llogari për saktësinë, vërtetësinë, objektivitetin dhe relevancën e përmbajtjeve për të cilat informojnë.

Vetërregullimi mediatik është me rëndësi për mediet, sepse e pamundëson rregullimin ligjor të standardeve profesionale, u ndihmon medieeve të jenë të pavarura, ndërsa për gabimet e tyre, gazetarët përgjigjen vetëm përpara gjyqit moral të kolegëve. Vetërregullimi e zvogëlon numrin e proceseve gjyqësore kundër gazetarëve: “Shpenzimet në procedurën për dorëzimin e ankesës kundër ndonjë medie, janë shumë më të vogla në krahasim me angazhimin e avokatëve, procedurat përfundojnë më shpejtë, procesi është më pak konfrontues se sa ballafaqimi në gjykatë”. (Adamçevski, Çausidis, Petkovska, Tërpevska dhe Trajkovska, 2010).

---

60 Fred S. Zibert, Teodor Peterson dhe Villbur Shram të formuluar në “Katër teoritë për shtypin”, të publikuara nga mesi i viteve të pesëdhjeta. Titulli i origjinalit: „Four Theories of the Press”, Siebert, Fred S., Peterson, Theodore, and Schramm, Wilbur, University of Illinois Press, 1956

Për opinionin, vetërregullimi do të thotë garanci për vërtetësinë e informatës, procedurë falas për ankesë, pranim publik i gabimeve të medieve dhe ngritje e kulturës mediatike në mënyrë të pavarur nga ndikimet politike.

Nga shqyrtimi i zhvillimit historik dëshmohet se parandalimi i përzjerjes së shtetit në lirinë e informimit dhe pavarësia e medieve shpeshherë ka qenë arsye vendimtare e cila i ka nxitur mediet të vendosin vetërregullim.

## **1.2 VETËRREGULLIMI NË KUSHTE TË MAQEDONISË DHE ROLI I SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË NË PROMOVIMIN DHE ZBATIMIN E TIJ (1946-2016)**

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë është formuar më 17 shkurt të vitit 1946 si Shoqatë e Gazetarëve Profesionistë të Republikës Popullore të Maqedonisë në kuadër të Lidhjes së Gazetarëve të Maqedonisë.<sup>61</sup> Mes organeve të zgjedhura nga Kuvendi është edhe Gjyqi i Nderit. Roli i këtij organi nuk ka qenë në funksion të promovimit të gazetarisë profesionale, duke marrë parasysh se: "Në regjimin mediatik komunist, mediet nuk ekzistojnë jashtë shtetit totalitar dhe funksionojnë si pjesë të mekanizmit të madh, ndërsa termi liri e medieve nuk ekziston, por mediet janë vetëm instrument për bindjen e popullit që ta pranojë dhe përcjellë ideologjinë zyrtare", (Bertrand, 2007). Nuk mund të thuhet se Gjyqi i Nderit ka kryer funksionin e vetërregulluesit, përveç "kujdesit deklarativ" për përparimin dhe mbrojtjen e etikës dhe të vlerave shoqërore-politike të profesionit gazetar, si dhe për zbatimin e Kodit të Gazetarëve të Jugosllavisë të miratuar në vitin 1965.<sup>62</sup> Në vitet e tetëdhjeta, në Statutin e vitit 1986 të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (neni 67), ky organ riemërohet në Këshill Miqësor, me detyrë që të kujdeset për zbatimin adekuat dhe ndryshimin eventual të Kodit të Gazetarëve të Jugosllavisë.<sup>63</sup> Në pajtim me dispozitat statutare, Këshilli ka mundur të hapë procedura për shqyrtimin e

---

61 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, në dispozicion në [http://znm.org.mk/?page\\_id=742](http://znm.org.mk/?page_id=742), qasur më 9 dhjetor 2016

62 Arkivi i Udruzenje novinara Srbije, Dokumenti SNJ.

63 Arkivi i Shoqatës së Gazetarëve, Statuti i SHGM-së 1986

përgjegjësisë shoqërore-politike dhe profesionale të anëtarëve të Shoqatës, në rast të shkeljes së normave profesionale-etike dhe shoqërore-politike të gazetarisë. Mundësia për shqyrtimin e përgjegjësisë politike të gazetarit është tregues për karakterin ideologjik dhe misionin e këtij organi, në vend që të jetë gjyq moral për joprofesionalizmin e gazetarëve.

### **1.3 ROLI I SHGM-SË PËR VETËRREGULLIM NË MEDIE PAS PAVARËSIMIT TË MAQEDONISË**

Në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, shpërbërja e shtetit federativ të Jugosllavisë dhe paraqitja e nacionalizmit ekstrem në rajon, kontribuan për deformimin e sistemeve mediatike në shtetet të cilat dolën nga Jugosllavia e shpërbërë, respektivisht për deformimin e raporteve në trekëndëshin e fuqishëm mes politikës, gazetarisë dhe biznesit (Ordanovski, Ismail, Stankovski, Ajdini, Janevska-Deleva, 2012). Kjo u reflektua edhe në Republikën e Maqedonisë, kështu që roli shumë i dobët i "atij lloji të organit vetërregullues" në kuadër të SHGM-së vazhdoi edhe në dekadën e parë pas pavarësisë të vendit nga shteti i përbashkët RSFJ, respektivisht edhe pas ndarjes së SHGM-së nga Lidhja e Gazetarëve të Jugosllavisë.

Miratimi i Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë më 14 nëntor të vitit 2001 konsiderohet si hapi i parë drejt vendosjes së vetërregullimit të mirëfilltë mediatik në Republikën e Maqedonisë.<sup>64</sup> Miratimi i Kodit nënkuptonte udhëzimin e gazetarëve që të punojnë në pajtueshmëri me standardet e dakorduara etike të sjelljes, të bazuara në saktësi, drejtësi, pavarësi dhe përgjegjësi. Kjo siguroi hipoteza për gazetari cilësore, e cila, edhe pse mund të anojë deri në një shkallë, e ka patjetër që t'i përkufizojë faktet, komentet dhe opinionet, për dallim nga "gazetaria propagandistike", "gazetaria misionare" ose nga shtypi tabloid të cilat shërbejnë për qëllime dhe interesa specifike.<sup>65</sup>

---

64 Shoqata e Gazetarëve, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/440>, qasur më 10 dhjetor 2016

65 Bajdar, Yavuz. (2008). The media Self-Regulation Guidebook-all questions and answers: Setting up a journalistic code of ethics-the core of media self-regulation. Vienna: Office of the representative on freedom of the media: Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), faqet 21-31

Në Statutin e SHGM-së të miratuar më 14 nëntor të vitit 2001, Këshilli i Nderit merr kompetenca tashmë të një organi relevant vetërregullues. Këshilli është i obliguar të kujdeset dhe t'i promovojë parimet etike, të përfshira në Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë. Në pajtim me nenin 46 të Statutit të SHGM-së, roli i këtij organi nuk është vendosja e censurës ose imponimi i autocensurës, por roli i tij para së gjithash është vendosja dhe mbrojtja e parimeve bazë të gazetarisë etike, të balancuar dhe objektive, e cila e respekton demokracinë, të drejtat e njeriut, lirinë e politikës redaktuese në medie.<sup>66</sup> Me respektimin dhe promovimin e plotë të Kodit, përmirësohet kredibiliteti i medie në opinion dhe ato përjetohen jo vetëm si të lira, por edhe si të përgjegjshme. Në të njëjtën kohë, gazetarit i jep të drejtë të mos pranojë diçka që nuk është në pajtim me standardet profesionale, ndërsa njëkohësisht e largon nga gjyqi i të tjerëve duke e lënë në gjyqin e kolegëve.

Sipas Statutit të vitit 2001, **Këshilli i ka zgjidhur** parashtresat nga qytetarët për shkeljen eventuale të parimeve të gazetarisë profesionale dhe etike. Në këtë periudhë, Këshilli ka mundur të procedojë edhe parashtresa kundër gazetarëve të cilët nuk janë anëtarë të SHGM-së. Me Statutin e miratuar në vitin 2010, Këshillit të Nderit i merret kompetenca që të reagojë me vetiniciativë edhe për gazetarët të cilët nuk janë anëtarë të SHGM-së.<sup>67</sup> Për këtë shkak, është ulur ndjeshëm numri i parashtresave të dorëzuara në Këshill. Kjo kontribuoi për pasivizim të konsiderueshëm të këtij organi dhe kufizim të rolit primar të Këshillit të Nderit.

Me Statutin e SHGM-së të vitit 2015, Këshillit të Nderit i kthehet kompetenca të vendosë për parashtresat e dorëzuara kundër gazetarëve që nuk janë anëtarë të SHGM-së.<sup>68</sup> Me atë dallim që për anëtarët e SHGM-së, Këshilli merr vendim, ndërsa për ata që nuk janë anëtarë, jep mendim. Me këto ndryshime, numri i anëtarëve të Këshillit të Nderit ulet nga shtatë në pesë. Përveç që e mbikëqyr realizimin e parimeve dhe

---

66 Arkivi i SHGM-së, Statuti i SHGM-së nga viti 2001.

67 Архива на ЗНМ, Статут на ЗНМ од 2010 год.

68 Здружение на новинари на РМ, Статут на ЗНМ од 2015, достапно на [http://znm.org.mk/?page\\_id=1349](http://znm.org.mk/?page_id=1349), пристапено на 10.12.2016

dispozitave të Kodit të Gazetarëve, Këshilli mund të inicojë diskutim në Këshillin Drejtues të SHGM-së për ndryshimin e dispozitave ligjore ose të akteve nënligjore të cilat i pamundësojnë ose i shkelin parimet e Kodit. Këshilli i Nderit reagon ndaj shkeljes së Kodit nga ana e gazetarëve, ndërsa Komisioni i Ankesave i Këshillit për Etikë në Medie vendos për shkeljen e standardeve profesionale nga mediet.

## 1.4 PËRPPJEKJET E SHMG-SË PËR FORMIMIN E KEMM

Në 15 vitet e para nga pavarësimi i Maqedonisë, mediet punonin sipas Ligjit jugosllav për informim publik të vitit 1974. Mjedisi i tillë kontriboi që në vend të medieve profesionale dhe të lira, të kemi medie të varura ekonomikisht dhe të kontrolluara. "Edhe pas më shumë se një dekade nga pavarësimi, mediet mbetën në një pozitë të përhershme të klientalizmit, në kërkim të përhershëm të pronarit "të vërtetë", kështu që edhe kur pronari "i vërtetë" do të ndërrohej, kërkoheshin pronar i ri i mirë". (Jakimovski, 2012). Gjendja u përkeqësua sidomos pas vitit 2010, pas mbylljes së Televizionit A1, kur pushteti arriti t'i instrumentalizojë mediet, kështu që, në vend që të punojnë për interesin publik të qytetarëve, ato u shndërruan në makineri propagandiste në duart e pushtetit.

Në vitin 2011 nuk kishte më ambient që mundësonte kushte për zhvillim të medieve profesionale, të cilat do të ishin korrigjues të pushtetit. Nuk respektoheshin ligjet, ose zbatoheshin në mënyrë selektive, ose shmangeshin, ekzistonte pasiguri sociale te gazetarët, treg i deformuar, mosrespektim i trupave rregullatorë, servis i dobët publik, qasja deri te informatat me karakter publik ishte e vështirë.<sup>69</sup> "Jo rastësisht Maqedonia trajtohet si vend me liri të pjesshme mediatike nga organizatat relevante ndërkombëtare..."(Selmani, 2011).

Raportet e organizatave vendëse dhe ndërkombëtare të cilat merren me lirinë e shprehjes bëheshin gjithnjë e më kritike për lirinë e medieve. Amnesty International akuzoi se "kryeministri Gruevski dhe Qeveria e

69 Selmani, Naser, „Liria e shprehjes është përjashtim“, Dnevnik, 24.09.2011, Shkup

tij e shfrytëzojnë mandatin si arsyetim që të vazhdojnë të izolojnë, marginalizojnë dhe heshtin mediet të cilat janë të orientuara në mënyrë kritike<sup>.70</sup> Në vitin 2012 Freedom House e radhiti vendin madje në vendin e 115-të në listën e lirive të medieeve në botë, plot 17 vende më poshtë nga radhitja e vitit 2011.<sup>71</sup> Vlerësime negative kishin edhe Komiteti Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Gazetarëve (Committee to Protect Journalists)<sup>72</sup> dhe Organizata Mediatike për Evropën Juglindore (South East Europe Media Organization – SEEMO.)<sup>73</sup> Federata Ndërkombëtare dhe Federata Evropiane e Gazetarëve konstatonin: "Gazetarët në Maqedoni janë nën presion të fuqishëm nga politikanët dhe pronarët e medieeve, kështu që është e padurueshme të punohet si gazetar".<sup>74</sup> Shqetësim të madh tregoi edhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Stejt Departamenti Amerikan në raportet e rregullta vjetore për gjendjen rreth respektimit të lirive të njeriut në Maqedoni konstatoi presionet ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit në vend.<sup>75</sup> Edhe raportet e rregullta të Bashkimit Evropian vite me radhë përmbajnë kritika për gjendjen e medieeve në Republikën e Maqedonisë.<sup>76</sup>

Në vitin 2011, gjendja e përkeqësuar rreth lirisë së shprehjes, e cila, në vend që të jetë rregull, u bë përjashtim në shoqëri, mobilizoi shoqatën e esnafit. SHGM-ja hapi dy fronte paralele për përmirësimin e gjendjes. Njëri për përmirësimin e kornizës ligjore, tjetri për rritjen e përgjegjësisë

70 Amnesty International, 2011, "Macedonian government must stop silencing critical media", 5 July 2011.

71 FreedomHouse, në dispozicion në <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2012/macedonia>, qasur më 06.12.2016

72 Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve 2011, Committee to Protect Journalists, "Press freedom issues may keep Macedonia from EU", 17 October 2011.

73 South East Europe Media Organization – SEEMO, Report on the SEEMO press freedom mission to the Republic of Macedonia, 4-6 October 2011

74 Federata Ndërkombëtare dhe Federata Evropiane e Gazetarëve (IFJ dhe EFJ), 2011, Support Campaign for Independent Journalism and Pluralism in Republic of Macedonia, 7 July 2011

75 SHGM, Dokumente, 2012, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, qasur më 10.12.2016

76 Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2012, ctp.14 e disponueshme në [http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Registar-na-dokumenti/PR2012\\_MK3\(2\).pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Registar-na-dokumenti/PR2012_MK3(2).pdf) qasur më 10.12.2016

së medieeve. Me iniciativën për formimin e Këshillit për Etikë në Medie, SHGM synonte ta ndajë përgjegjësinë e gazetarëve dhe pronarëve të medieeve në zbatimin e standardeve profesionale. Nga ana tjetër, u parapriu tentativave të pushtetit për të miratuar legjislacion më rigoroz, me të cilin tentonte ta rregullonte me ligj etikën në fushën e gazetarisë.

Më 14 shtator të vitit 2011, SHGM dhe Qeveria vendosën dialog institucional për përmirësimin e lirisë së medieeve. Për këtë qëllim, ishte firmosur edhe memorandum i bashkëpunimit, me të cilin harmonizuan qëndrimet për temat për dialog, si përmirësimi i kornizës normative, fushatat qeveritare, forcimi i servisit publik – RTVM-së, dekriminalizimi i shpifjes dhe themelimi i Këshillit për Etikë në Medie.

Pak pas kësaj, në nëntor të vitit 2011, në Mavrovë, në mbledhjen e bashkësisë mediatike, vendosja e një trupi për vetërregullim në medie ishte një nga prioritetet kryesore të parashikuara në Planin e miratuar Aksionar. Më 18 mars të vitit 2011, në kuadër të SHGM-së u formua një grup pune, përgjegjës për iniciimin e themelimit të trupit vetërregullativ në medie. Anëtarët e këtij grupi të punës morën përvojat nga Norvegjia, Bosna dhe Hercegovina dhe nga Kosova në fushën e vetërregullimit, ndërsa disa prej tyre edhe përvoja nga trupat e tjerë rajonale të vetërregullimit dhe nga rrjetet rajonale. Grupi i punës i përbërë nga gazetarë, redaktorë, pronarë të medieeve dhe ekspertë organizoi disa takime me qendrat rajonale të SHGM-së, ku anëtarësisë së SHGM-së iu prezantua koncepti për vetërregullim. Pas konsultimeve disamujore, SHGM i përfshiu kryeredaktorët dhe pronarët e medieeve. Ideja u pranua gjerësisht nga të gjithë përbërësit e sistemit mediatik. Më 29 qershor të vitit 2011, shumica e medieeve e firmosën Deklaratën për përkrahjen e procesit të vetërregullimit në medie.<sup>77</sup>

Ndërkohë, më 13 qershor të vitit 2012, SHGM-ja dakordoi me Qeverinë zgjidhjen ligjore për dekriminalizimin e shpifjes dhe ofendimit. Qëndrimi i Kryetarit të Shoqatës, Naser Selmani, ishte se është krijuar sistem i cili i jep mundësi gazetarit ta dëshmojnë vërtetësinë e asaj që ka shkruar, e, nëse nuk arrin ta bëjë, ai mund të kërkojë falje ose ta

---

77 SHGM, 2011, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, qasur më 12.12.2016

përgënjeshtrojë. "Sipas Ligjit, masa përfundimtare do të jetë caktimi i masës së kompensimit për dëmin jomaterial".<sup>78</sup>

Nga ana tjetër, vazhduan përpjekjet e SHGM-së për vendosjen e vetërregullimit. Ishte zhvilluar sondazh në nëntor të vitit 2012 mes gazetarëve, redaktorëve dhe pronarëve të medie, të cilët me shumicë të madhe e përkrahën procesin e vetërregullimit.<sup>79</sup> Sipas Raportit të SHGM-së për punën e Këshillit Drejtues në vitin 2012, janë realizuar 6 ngjarje lokale në tremujorin e dytë të vitit 2012 nëpër 6 qendrat rajonale të SHGM-së, me përfshirjen e 120 gazetarëve, pastaj 6 ngjarje lokale në tremujorin e katërt të vitit 2012 nëpër 6 njësi rajonale të SHGM-së me përfshirjen e 140 gazetarëve. Ishin organizuar 23 mbledhje në Shkup me pronarët e medie dhe përfaqësuesit e menaxhmentit të qendrave rajonale me përfshirjen e 135 personave (mbledhje nuk janë mbajtur vetëm me përfaqësues të një televizioni nacional dhe të një gazete ditore).<sup>80</sup>

Janë përpunuar 8 draft-procedura për punën e Këshillit të Etikës dhe është reviduar draft-statuti. Është kryer mbikëqyrje dymujore e shkeljes së standardeve profesionale nga mediet dhe është hartuar raport. Janë realizuar trajnime dhe bashkëpunime me përfaqësues të Këshillit kosovar për shtyp. Është përpunuar, botuar dhe distribuar material promovues për vetërregullimin në medie. Nga fundi i prillit të vitit 2013 është mbajtur edhe konferenca përfundimtare.<sup>81</sup>

Derisa SHGM animonte bashkësinë gazetareske për themelimin e trupit vetërregullativ, pushteti, edhe pse e përkrahte deklarativisht këtë proces, megjithatë, e demaskoi qëllimin e tij të vërtetë duke punuar për miratimin e Ligjit për Medie, duke tentuar që me ligj ta rregullojnë etikën gazetareske. Më 8 prill 2013, ministria përkatëse e publikoi në opinion këtë draft ligj. Si përgjigje, në maj, SHGM ia dorëzoi Ministrisë

---

78 Kanal 77 , 2012, „SHGM dhe Qeveria u morën vesh – shpifja dekriminalizohet“ 14. 06. 2012, Shkup

79 Arkivi i SHGM-së, Anketë për themelimin e trupit vetërregullativ, 29.11.2012

80 SHGM, Raport për punën e SHGM-së 2013 KD (faqja 3), në dispozicion në [http://znm.org.mk/?page\\_id=1362](http://znm.org.mk/?page_id=1362), qasur më 10.12.2016

81 SHGM, Raporti për punën e SHGM-së 2013 KD (faqja 4), në dispozicion në [http://znm.org.mk/?page\\_id=1362](http://znm.org.mk/?page_id=1362), qasur më 10.12.2016



për Shoqëri Informatike dhe Administratë.<sup>82</sup>vërejtjet e saj të cilat dolën nga debati i gjerë mes gazetarëve, redaktorëve dhe ekspertëve. Edhe në procedurën e cila vijoi, SHGM dorëzoi disa amendamente ligjore, të cilat kishin të bënin me nenin 24 dhe nenet 9, 14, 117, 135 dhe 140. Shoqata ka reaguar ndaj nenit 24 duke kërkuar prolongimin e zbatimit të Ligjit deri në aderimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian, për shkak të vlerësimit se miratimi i tij jo vetëm që nuk do të kontribuojë për liri më të madhe të shprehjes dhe liri të medieeve, por edhe do të sjellë obligime dhe kufizime të reja për gazetarët dhe mediet, të cilat ka shumë rrezik që të keqpërdoren nga pushteti.<sup>83</sup> SHGM theksoi se definimi i profesionit gazetar me ligj është i panevojshëm dhe se në mënyrë indirekte çon drejt licencimit të gazetarisë, që është në kundërshtim me përvojat në vendet demokratike, ku blogerët me ndikim thirren në konferenca për shtyp të institucioneve shtetërore, si Huffington Post, për shembull. Shoqata e Gazetarëve shpjegoi se nuk ka nevojë që shteti të mbrojë të drejtat e gazetarëve me ligj të veçantë. Liria e shprehjes në Maqedoni është e garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Kështu që, për të mbrojtur lirinë e shprehjes, mjafton që organet shtetërore të respektojnë Kushtetutën dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

SHGM nënvizoi se nuk mund të arrihet përmirësimi i gjendjes me rritjen e obligimeve ndaj botuesve dhe gazetarëve, por me zvogëlimin e ndikimit të pushtetit në punën e medieeve. Në botën demokratike dhe në Evropë është pranuar gjerësisht standardi se, sa më pak rregullim do të thotë liri më të madhe të shprehjes dhe të medieeve, ndërsa rregullimi i tepërt mund të ketë efekt në zvogëlimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medieeve, si dhe të nxisë edhe më tepër autocensurë edhe ashtu shumë të pranishme në mediet e Maqedonisë.

---

82 SHGM, Analiza e draft ligjit për mediat, SHGM maj 2013, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, qasur më 09.12.2016

83 SHGM, Sqarimi i amendamentit për Ligjin për Media, 19.08.2013, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, qasur më 09.12.2016

Rregullimi i medieve të shkruara dhe atyre të internetit nuk është kërkesë e Bashkimit Evropian.<sup>84</sup> Ajo është kërkesë vetëm e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Atë që kërkon Komisioni Evropian, theksoi SHGM në amendamentet e saj, është rregullimi i mënyrës se si Qeveria i harxhon paratë publike në medie. Qëndrimi i esnafit është i përbashkët se arsye kryesore për mungesën e pluralizmit mediatik dhe mosrespektimi i standardeve profesionale është korrupsioni i medieve i nxitur nga Qeveria.

## **1.5 THEMELIMI I KËSHILLIT TË PARË PËR ETIKË NË MEDIE**

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, më 19 dhjetor të vitit 2013, u parapriu tentativave të Qeverisë për të rregulluar me ligj normat etike. Kjo në mënyrë që e themeloi Këshillin për Etikë në Medie më 25 dhjetor të vitit 2013, një javë para se të miratohet Ligji për shërbimet audio dhe audiovizuale.

Në Kuvendin themelues morën pjesë përfaqësues të SHGM-së, përfaqësues së Institutit Maqedonas për Medie dhe pronarët e medieve. Gazetarët përfaqësoheshin nga SHGM-ja, ndërsa pronarët e medieve i përfaqësonin të deleguarit e posaçëm që i kishin caktuar pasi që nuk kishin një shoqatë të vetën.

Praktikisht, të pranishëm ishin botuesit më të mëdhej të gazetave ditore dhe pronarët e medieve kombëtare (MPM, Nova Makedonija, Koha, Lajm, RTVM, Kanal 5, Telma, 24 Vesti...). Nëpërmjet shoqatës së radiodifuzerëve lokalë në Republikën e Maqedonisë u prezantuan 60 radio lokale dhe rajonale. Kishte edhe përfaqësues të medieve të internetit.

Në Kuvend u bë përzgjedhja e anëtarve të Bordit Drejtues dhe të Bordit Mbikëqyrës. Bordi Drejtues numëron shtatë anëtarë dhe shtatë zëvendës të këtyre anëtarëve. Katër janë përfaqësues të pronarëve të medieve të ndryshme, kurse tre janë anëtarë të propozuar nga SHGM-ja. Në Bordin Drejtues si përfaqësues të medieve u përzgjodhën Marina Domazetova që

---

84 SHGM, Shpjegim i amendamentit të Ligjit për Media, 19.08.2013, në dispozicion në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, qasur më 10.12.2016

vjen nga MPM në rolin edhe të përfaqësueses së medieeve të shkruara. Biljana Trendafillova u zgjodh si përfaqësuese e RTVM-së. Ivana Kostovska nga Telegrafi njëkohësisht u zgjodh si përfaqësuese e medieeve të internetit, ndërsa Sasho Mitanovski u zgjodh përfaqësues i Shoqatës së Medieeve Private të Maqedonisë dhe përfaqësues i medieeve rajonale.

Me propozim të SHGM-së, Kuvendi zgjodhi edhe tre anëtarë të Bordit Drejtues. Isuf Kadriu u zgjodh si përfaqësues i Alsat-m, Katerina Sinadinovska nga Kapital dhe Dragan Antonovski nga internet portali Lokalno.mk. Ky kuvend bëri zgjedhjen edhe të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Këshillit për Etikë në Medie prej të cilëve tre anëtarë janë përfaqësues mediesh, ndërsa dy nga SHGM. Si përfaqësues të medieeve u përzgjedhën Goran Gavrillov nga Kanal 77, Sonja Maxhoska nga gazeta Utrinski dhe Semi Memeti nga Almakos, ndërsa përfaqësues të gazetarëve të propozuar nga SHGM u zgjedhën Zoran Fidanovski nga TV Alfa dhe Aleksandar Dimkovski nga Nova Makedonija.

Delegatët i miratuan Statutin dhe Rregulloren e punës së Këshillit për Etikë në Medie.<sup>85</sup> Zyra ekzekutive përbëhet nga drejtori dhe zyra ekzekutive. Komisioni për ankesa numëron shtatë anëtarë. Dy janë përfaqësues të propozuar nga gazetarët (nga SHGM), dy nga pronarët e medieeve dhe tre përfaqësues të publikut.

Komisioni për ankesa numëron shtatë anëtarë. Dy janë gazetarë të propozuar nga gazetarët (SHGM), dy janë përfaqësues të pronarëve të medieeve dhe tre përfaqësues të publikut.

Në maj të vitit 2014 u zgjedhën anëtarët e Komisionit për ankesa. Promovimi i këtij komisioni u bë më 30 shtator, ndërsa ishte konfirmuar më 16 tetor të vitit 2014. Ky trup i cili vendos në bazë të ankesave të qytetarëve për parregullsitë që detektohen në produktet mediatike është i përbërë nga shtatë anëtarë.<sup>86</sup> Dy prej tyre janë përfaqësues të pronarëve të medieeve, Lidija Bogatinova dhe Meri Jordanovska, tre nga

---

85 SHGM, Është formuar Këshilli për Etikë në Media të Maqedonisë, 19 dhjetor, 2013, e disponueshme në <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/711>, qasur më 11.12.2016

86 24 Vesti, Filloi të funksionojë Komisioni për ankesa nga mediat, 30.09.2014, e disponueshme në <http://24vesti.mk/pochna-da-funkcionira-komisijata-za-zhalbi-od-mediumi>, qasur më 11.12.2016

sektori civil, Sefer Tahiri, Teofil Blazhevski dhe Filip Gjurginovski dhe dy gazetarë, Bekim Ajdini dhe Mirçe Adamçevski i cili më pas është zgjedhur kryetar i komisionit.

Komisioni vepron në bazë të një rregulloreje e cila është miratuar nga Bordi udhëheqës. Sipas këtij akti, Komisioni nuk do të shqyrtojë ankesa anonime. Secili qytetar, person juridik apo përfaqësues të tjerë të publikut mund të paraqesin ankesë lidhur me përmbajtjet e publikuara në medie. Ankesa kundër ndonjë mediumi të caktuar mund të parashtrohet në afat prej një muaji prej publikimit të tekstit gazetaresk apo kronikës, por gazetarët nuk mund të parashtrojnë ankesë individualisht.

Zyra ekzekutive e Këshillit për Etikë në Medie është e obliguar që të shqyrtojë ankesat në kuadër të kompetencave të Këshillit. Në rast se ankesa nuk është në kompetencë të Këshillit, zyra ekzekutive mund ta refuzojë ankesën dhe për këtë gjë t'i njoftojë parashtruesit duke u dhënë detaje për arsyet.<sup>87</sup> Varësisht prej kompleksitetit të lëndës, zyra ekzekutive mund të iniciojë një lloj ndërmjetësimi, respektivisht pajtim të të dy palëve në kontest, si dhe mund të kërkojë nga mediumi që ta shfrytëzojë të drejtën për përgjigje ndaj parashtruesit të ankesës, apo të arsyetojë motivet dhe argumentet se përse e ka publikuar një tekst apo kronikë të tillë.

Komisioni për ankesa është i detyruar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat duke kërkuar nga parashtruesi i ankesës si dhe nga mediumi kundër të cilit është bërë ankesa që t'i dorëzojnë të gjitha faktet dhe informatat e nevojshme. Nëse nuk ekzistojnë arsye që ky afat të shtyhet, Komisioni ka afat prej një muaji që të prononcohet lidhur me lëndën. Vendimi të cilin e ka marrë Komisioni për ankesa i dërgohet mediumit. Shkelësi duhet ta publikojë këtë vendim në vendin e caktuar nga Këshilli, ndërsa Këshilli kërkon nga anëtarët e saj që ta publikojnë vendimin. Publikimi është pa pagesë në të gjitha mediet që janë anëtare të Këshillit.

Është me rëndësi të theksohet se Komisioni shqyrton edhe ankesat kundër medie të cilat nuk janë anëtare të Këshillit. Procedurat për ankesa kundër këtyre medie bëhet në mënyrë të njëjtë dhe vlejnë rregullat e njëjta sikurse për mediet anëtare të Këshillit, me një dallim të vogël që në vend

---

<sup>87</sup> Adamçevski, Mirçe, konferencë për shtyp e Komisionit për ankesa pranë KEM, 30.09.2016, Shkup

se të sjellë vendim, Komisioni sjell vetëm mendim. Në qoftë se mediumi i caktuar nuk është anëtar i Këshillit për Etikë të Medie dhe nuk ka dëshirë që të bashkëpunojë me të njëjtin, atëherë Këshilli sjell mendim për ankesën në bazë të informatave të cilat ka qasje. Mendimet dhe vendimet e veta Komisioni i publikon në ueb-faqen e saj dhe njofton të gjitha mediet anëtare apo jo të Këshillit për Etikë. "Shumë është e rëndësishme që Komisioni të punojë në mënyrë të paanshme, gjë për të cilën ne të gjithë bashkërisht do të angazhohemi. Njëlloj i rëndësishëm është edhe fakti se Komisioni duhet të krijojë imazh në opinion si një trup të cilit do t'i besojë publiku" Adamçevski (2014).

Këshilli për Etikë është themeluar sipas standardeve botërore. Për herë të parë në Maqedoni në të janë kyçur pronarët, gazetarët dhe qytetarët. Ky trup është trepalësh me qëllim që të përfaqësohen interesat e të gjithë aktorëve. "Puna më e mirë e këtij trupi është që janë futur edhe mediet pro opozitare edhe ato pro qeveritare. Dhe ky është një prej kualiteteve më të mëdha të këtij trupi. Në kuvendin themelues ishin të pranishëm 60-70 medie të cilat paraqiten si themeluese të Këshillit për Etikë në Medie. Por, është mirë që me kalimin e kohës, të bashkangjiten edhe ata të cilët nuk janë themelues, në rast se shohin se po krijojnë besim te ky trup"<sup>88</sup> Maqedonia ishte një prej shteteve të fundit nga rajoni në të cilat është formuar një Këshill për Etikë në Medie. Ky është një tregues se profesioni ka marrë përgjegjësi në një kohë shumë të komplikuar dhe të rëndë që të vetërregullohet, duke e kundërshtuar kështu Qeverinë e cila tentoi ta rregullojë me ligj etikën në gazetari.

Për dy vjet, aq sa ekziston, Komisioni për ankesa në **Këshillin për Etikë** ka sjellë mbi 130 vendime dhe mendime. Parashtruesit më të shpeshtë janë qytetarët, vetë mediet dhe politikanët, ndërsa parashtresat më të shpeshta kanë të bëjnë me vërtetësinë dhe raportimin jo të drejtë, gjuhën e urrejtjes, shpifjet dhe ofendimet. Rëndësia e vetërregullimit tashmë dalëngadalë po njihet por ende ka nevojë për punë aktive në drejtim të informimit për rëndësinë dhe efektet e vetërregullimit, gjithë kjo në mbrojtje të lirisë së medie dhe të drejtës së opinionit për të

---

88 Selmani, Naser, 2014, Intervistë për nevojat e tezës së magjistraturës "Analizë krahasuese e modeleve të vetërregullimit të mediat", Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi", Instituti për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike", 25.12. 2014, Shkup

qenë i informuar në mënyrë etike dhe profesionale.<sup>89</sup> Numri i ankesave të parashtruara dhe interesi i qytetarëve, por edhe i organizatave të tjera, jep shpresë se vetërregullimi si proces mund të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e sistemit mediatik në vend.<sup>90</sup> Por ekzistojnë të paktën edhe dy përfitime nga ekzistenca e Këshillit për Etikë.

**E para është ndërmjetësimi, prej të cilit pritet që të japë kontribut në aspektin e zvogëlimit të numrit të lëndëve gjyqësore për ofendim dhe shpifje.** Shkaku i dytë serioz është se vendimet e Këshillit për Etikë, në fakt, mund të përdoren si mendim profesional në rast të mundshëm gjyqësor për ofendim dhe shpifje.<sup>91</sup> Një prej sfidave për ekzistencën e Këshillit për Etikë është edhe financimi. Tani për tani kjo çështje është rregulluar nëpërmjet projekteve të financuara nga Ambasada e Holandës në Shkup, nga UNESCO, Bashkimi Evropian dhe Agjencia për zhvillim ndërkombëtar e Zvicrës. Sipas rregullave, këshillat e tillë financohen nga anëtarët, por edhe nga vetë shteti, edhe atë pa asnjë kushtëzim.

Megjithatë, përgjegjësia më e madhe për punën e Këshillit të Etikës qëndron tek anëtarët e Komisionit të ankesave të cilët duhet të gjejnë forca që në mënyrë objektive dhe joselektive t'i shqyrtojnë ankesat e publikut dhe të vendosin për to. Diçka që nuk guxon t'u ndodhë atyre, është diskriminimi i medieve për shkak të politikës së tyre redaktuese.

Mediet janë të lira, ato zgjedhin se çfarë politike redaktuese do të zhvillojnë dhe askush nuk guxon t'i kundërshtojë për këtë gjë. Por, Komisioni duhet të niset nga ingerencat e tij, e kjo në fakt është që të vendosë se a ka dhe në cilin rast ka shkelje të praktikave të mira të gazetarisë profesionale.

89 Telegraf.mk, 2016, pres konferencë e Këshillit për Etikë, 29.06.2016, e disponueshme në <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-sovet-za-etika-vo-mediumite-najmnogu-zalbi-za-nefer-izvestuvane-govor-na-omraza-i-za-kleveta.nsp>, qasur më 10.12.2016

90 Tahiri, Sefer, pres konferencë e KEM, (29.06.2016)

91 Blazhevski, Teofil, Verifikimi i fakteve në media, E disponueshme në <http://mediumi.kauza.mk/2015/04/29/samoregulacijata-vo-mediumite-vo-makedonija-mission-possible/> qasur më 11.12.2016

## 2. ARRITJA E PËRGJEGJËSISË TE MEDIET E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PRAKTIKA

Mediet e lira dhe demokratike janë themeli i secilës shoqëri demokratike. Për këtë arsye, vendet e lira u shmangen rregullativave të rrepta ligjore për punën e medieeve. Madje Shtetet e Bashkuara të Amerikës që në amendamentin e parë të Kushtetutës së tyre<sup>92</sup> garantojnë se Kongresi nuk do të sjellë asnjë ligj me të cilin do të kufizohet liria e shprehjes.

Por liria e medieeve ngërthen në vete edhe përgjegjësi. Gazetarët dhe mediet doemos duhet t'i shërbejnë vetëm interesit qytetar dhe nuk guxojnë të lejojnë që të keqpërdoren për arritje të ndonjë interesi politik ose ekonomik që e ka ndonjë qendër e caktuar e fuqisë.

Në mënyrë që të arrihet funksioni i tillë i përgjegjshëm dhe në mënyrë që të pengohen keqpërdorimet eventuale, Shoqata Ndërkombëtare e Gazetarëve<sup>93</sup> në vitin 1953 ka miratuar një Deklaratë për parimet e sjelljes së gazetarëve me të cilën gazetarët obligohen të gjurmojnë pas së vërtetës për të realizuar të drejtën e qytetarëve që të informohen.

Në bazë të këtyre parimeve, në vitin 2001 gazetarët e Maqedonisë sollën një Kodeks për Etikë.<sup>94</sup>, në të cilin ata zotohen se do të punojnë në mënyrë të ndershme, objektive dhe të saktë. Duke e ndjekur rolin e tyre në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë civile, gazetarët do t'i mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do ta respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë për përfundimin e shtetit ligjor dhe kontrollit të pushtetit dhe të subjekteve të tjera të jetës publike.<sup>95</sup>

92 Kushtetuta e SA, amendamenti i parë, i disponueshëm në [https://www.law.cornell.edu/constitution/first\\_amendment](https://www.law.cornell.edu/constitution/first_amendment)

93 FNG, Kodeksi Etik i FNG-së, 1953/1986, e disponueshme në <http://www.ifj.org/about-ifj/ifj-code-of-principles/>

94 SHGM, 2001, e disponueshme në [http://znm.org.mk/?page\\_id=1412](http://znm.org.mk/?page_id=1412)

95 Ibid

Parimet themelore në bazë të të cilave është përpiluar Kodeksi i Gazetarëve të Maqedonisë janë ato të vërtetësisë dhe objektivitetit, parimet e balancimit dhe të dallimit të qartë mes lajmit dhe komentit, parimet e ndershmërisë dhe pavarësisë nga të tjerët.

## **2.1 ANALIZA E PUNËS SË KËSHILLIT TË NDERIT NË SHGM**

Për të zbatuar parimet themelore të gazetarisë profesionale, në Maqedoni janë themeluar trupa vetërregullatorë. Këshilli i Nderit në Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë kujdeset për zbatimin e parimeve të Kodeksit nga ana e gazetarëve, ndërkohë që Komisioni për ankesa i Këshillit të Etikës e ndjek zbatimin e standardeve profesionale nga ana e medie.

Këshilli për Etikë, si trup vetërregullues, është formuar për të përforcuar mekanizmin e vetërregullimit në medie dhe për t'i mbrojtur mediet nga të gjitha format e presionit.

Mediet janë më profesionale dhe më të përgjegjshme ndaj publikut në goftë se ekziston një zotim i përbashkët i gazetarëve dhe pronarëve të medie për zbatimin e tërësishëm të parimeve të Kodeksit.

Këshilli i Nderit i SHGM-së punon në bazë të parimit të shqyrtimit të parashtresave të qytetarëve të dëmtuar, por shqyrton edhe shumë raste me vetiniciativë, atëherë kur ekziston dyshim i bazuar për shkelje të Kodeksit. Me dallim nga trupi vetërregullues i SHGM-së, Komisioni për ankesa i Këshillit të Etikës punon ekskluzivisht në bazë të parashtresave të qytetarëve.

Këshilli i Nderit për 15 vjet ekzistencë ka zgjidhur afro 100 parashtresa të dorëzuara nga qytetarët apo të inicuar nga vetë Këshilli. Në pjesën më të madhe të parashtresave, Këshilli ka vërejtur ose konstatuar shkelje të Kodeksit për Etikë, ndërkohë që 20 për qind prej tyre i ka refuzuar si të pabaza ose është shpallur jokompetent.

Numri i ankesave të refuzuara është tregues se Këshilli i interpreton normat e Kodeksit në mënyrë liberale, duke i dhënë përparësi parimit të lirisë së shprehjes.



Në kushte kur trupi vetërregullues i SHGM-së ka vërejtur tendencë të shkeljeve të mëdha të Kodeksit të gazetarëve në më shumë medie, ai ka reaguar me kumtesa të përgjithshme, pa përmendur emra të medieve ose të gazetarëve. Në këto reagime, Këshilli në mënyrë parimore i dënon këto shkelje të rënda të Kodeksit dhe u bën thirrje gazetarëve për përgjegjësi. Këtë formë të reagimit Këshilli e zbaton sidomos pas vitit 2010, kur me statutin e ri i është mundësuar që të shqyrtojë ankesa për punën e gazetarëve të cilët nuk janë anëtarë të SHGM-së.

Duke analizuar punën e Këshillit të Nderit në këtë periudhë 15-vjetore mund të vihet në përfundim se niveli i shkeljes së standardeve profesionale nga ana e medieve është i lidhur me proceset politike në vend. Degradimi i gazetarisë së Maqedonisë shkon në një paralele me krizën politike të vitit 2008 dhe eskalon pas vitit 2012. Sikurse ashpërsohet lufta politike mes partive në pushtet dhe opozitës, mediet vazhdimisht u shmangen parimeve të gazetarisë profesionale dhe bëhen pjesë e konfrontimit politik për pushtet të pakompromis. Me këtë, mediet më me ndikim shndërrohen në makineri propaganduese të pushtetit. Në vend se t'i shërbejnë interesit publik, ato përkulen para interesave politike dhe ekonomike të partive dhe pronarëve të medieve.

## **2.2 SI NDIKON KLIMA POLITIKE NË CILËSINË E PËRMBAJTJEVE MEDIATIKE**

Paralelisht me paraqitjen dhe thellimin e krizës politike dhe përkeqësimin e gjendjes të mediet, Maqedonia po vazhdon të bie në mënyrë drastike në listat botërore për liri të medieve. Në vitin 2008, në indeksin e lirisë së medieve të Reporterëve pa kufij<sup>96</sup> Maqedonia u radhit në vendin e 42-të, prej gjithsej 174 shteteve të botës, ndërkohë që në vitin 2012<sup>97</sup>, pas katër vjetësh Maqedonia bie në vendin e 94-t, ose 52 vende më poshtë.

96 RBG, Indeks botëror për lirinë e mediave 2008, e disponueshme në <https://rsf.org/en/world-press-freedom-index-2008>

97 RBG, Indeks botëror për lirinë e mediave 2012, e disponueshme në <https://rsf.org/en/world-press-freedom-index-20112012>

Periudha prej vitit 2001 deri tani, kur në Maqedoni ekziston mekanizmi i vetërregullimit, duke u bazuar në nivelin e respektimit të parimeve të kodeskit, mund të ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë zgjat prej vitit 2008, kur mediet në përgjithësi u janë përmbajtur standardeve profesionale, me shembuj të shpeshtë të shkeljeve të Kodeksit. Është paradoks që pas luftës së vitit 2001, mediet në Maqedoni shfaqin më shumë gatishmëri për respektimin e standardeve profesionale, në krahasim me kohën që pason.

Këshilli i Nderit më aktiv ka qenë në periudhën mes vitit 2006 dhe vitit 2010, kur edhe janë zgjidhur pjesa më e madhe e ankesave. Fakti që para vitit 2008 mediet kanë raportuar në mënyrë më profesionale shihet jo vetëm prej vendimeve që i ka sjellë Këshilli, por edhe prej monitorimit njëmuji të mënyrës së raportimit të medievet në Maqedoni të cilin e kanë zbatuar anëtarët e Këshillit në qershor të vitit 2007. "Marrë me përqindje, në pjesën më të madhe të përmbajtjeve të publikuara te mediet që kanë qenë objekt i monitorimit vërehet respektimi i parimeve themelore të kodeksit gazetaresk. Megjithatë, përjashtimet nuk janë rastësi", thuhet në raport.

Nga raporti mund të shihet qartë se shkeljet më të shpeshta të gazetarëve kanë të bëjnë me mosrespektimin e privacisë së qytetarëve, zbulimin e identitetit të të miturve, shkeljen e prezumimit të pafajësisë, informimin tendencioz dhe në një rast është vërejtur shembull eklatant i gjuhës së urrejtjes edhe atë në servis publik, në Radio Televizionin e Maqedonisë. Por me të drejtë mund të konstatohet se në këtë periudhë paraqitja e gjuhës së urrejtjes në medie mund të trajtohet si një dukuri aksidentale, ndërsa më së shpeshti është i dukshëm fjalori diskriminues në baza të ndryshme.

## **2.3 MOSRESPEKTIMI I PREZUMIMIT TË PAFAJËSISË**

Në raport konstatohet se mosrespektimi i prezumimit të pafajësisë buron nga raportimi i pabalancuar i cili është bazuar vetëm në një burim. "Ky lloj i përjashtimit nga Kodeksi është masiv dhe është i

pranishëm në të gjitha mediet. Kjo para së gjithash i referohet faktit që burimi i vetëm i të dhënave është MPB-ja dhe akuzat e saj të cilat duhet të vërtetohen në procedurë gjyqësore. Por për mediet, akuzat policore në të shumtën e rasteve janë të mjaftueshme që personave të dyshuar me emër dhe mbiemër t'u mveshin kualifikime si "mbreti i nëntokës", "pedofil monstruoz", "Maniak lokal" e të ngjashme.

Ky fakt në raport ilustron me dy shembuj nga arrestimi i dy qytetarëve të akuzuar për tregti me drogë dhe për pedofili. Në rastin e parë, mediet e kanë përcjellë informatën se policia ka arrestuar "narko-dilerin kryesor të Manastirit" pa përmendur se ai është vetëm i dyshuar për këtë vepër. Kështu mediet e shpallën atë fajtor ende pa nisur procesi gjyqësor dhe pa dalë prononcimi i gjykatësit. Po ashtu, mediet kanë raportuar në mënyrë joprofesionale për arrestimin e një personi në Strumicë, i dyshuar për pedofili. Korrespondenti i Televizionit Kanal 5 nga ky qytet më 1 qershor ka njoftuar se policia e ka arrestuar "pedofilin e Monospito" me çka praktikisht e ka shpallur fajtor. Shembuj të tillë ka shumë. Në fakt asnjë medium nuk mendon se duhet ta ruajë identitetin e dikujt që dyshohet për krim, edhe pse krimi ende nuk është vërtetuar. Nuk ka as dilema etike kur bëhet fjalë për shfaqjen e incizimeve të policisë nga aksioni. Disa medie, madje, nuk konsiderojnë se është e nevojshme që të shënojnë se burimi i incizimit të tyre është MPB-ja. Me dallim nga kjo, ekziston një praktikë e pranuar në përgjithësi për të respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë derisa nuk mbaron procesi gjyqësor. Vetëm nëse rasti nuk ka të bëjë me person publik të profilit të lartë", thuhet më tej në raport.

Si raportim tendencioz në raport janë trajtuar raportimi i njëanshëm dhe i pabalancuar. Shkeljet e tilla ilustron me mënyrën e raportimit të medieve për zgjedhjet në Federatën e Futbollit të Maqedonisë. Kështu, për shembull, gazeta "Veçer" ka publikuar një sërë tekstesh me të cilat ka dashur ta diskreditojë kryetarin e atëhershëm të FFM-së, XH. Haxhiristevski, dhe selektorin S. Katanec. "Veçer" ka publikuar dokumente të ndryshme dhe nuk u ka dhënë mundësi palëve të prekura që të sqarohen lidhur me disa akuza për keqpërdorime.

Rasti i vetëm i gjuhës së urrejtejs që Këshilli i Etikës e ka regjistruar gjatë monitorimit ka qenë emisioni i emetuar në Radio Televizionin e Maqedonisë kushtuar librit "Dosja e përgjakshme" nga autori Petar Popovski, në të cilin gegët (shqiptarët) me një qasje kuazi-shkencore dhe pseudo-historike paraqiten si një komb kriminogjen. "Këshilli në mënyrë unanime erdhi në përfundim se në këtë rast, nën maskën e prezantimit të një hulumtimi shkencor, iu dha publicitet një teorie padyshim shoviniste e cila shpërndan urrejtje dhe mungesë të tolerancës etnike, gjë që duhet dënuar ashpër"<sup>98</sup>

Megjithatë, Këshilli ka vërejtur një fenomen shumë interesant që është aludim se çfarë do të ndodhë periudhën e ardhshme kur përkeqësohet mënyra e raportimit të medieeve me gjuhë të hapur të urrejtjes.

Para vitit 2008, gjuha e urrejtjes paraqitej në mënyrë të kamufluar në emisione kontaktuese në televizione, ku prezantuesit jo vetëm që nuk distancoheshin nga fjalori i pahijshëm, por në mënyrë të heshtur e toleronin. Ky diskurs i medieeve është kufiri mes gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit.

Kështu në emisionin "Zëri i popullit", i emeluar në Radio-Televizionin e Maqedonisë më 28 gusht të vitit 2008<sup>99</sup>, udhëheqësi Slobodan Tomiq, polemizon me qëndrimet e gazetarit Branko Gerovski pa e thirrur të jetë prezent atë në emision. Këshilli ka konstatuar se Tomiq i ka shkelë ashpër standardet profesionale pasi që në vend se të polemizojë me qëndrimet e Gerovskit, ai u ka lejuar shikuesve që të shprehin diskualifikime personale kundër tij dhe familjes së tij. "Shprehja e lirë e mendimit që vjen në pah sidomos në emisionet interaktive, nuk nënkupton liri në nënçmim dhe poshtërimin e personave të tjerë", theksohet në reagimin e Këshillit të Nderit. Duke u ballafaquar me trendin e konfrontimit brutal mediatik me ata që mendojnë ndryshe nëpërmjet të ashtuquajturave "reagime dhe jehonë popullore" dhe komente "autoriale" Këshilli iu bën thirrje gazetarëve që t'i respektojnë me përpikëri standardet etike të profesionit.

---

98 Ibid

99 SHGM, Reagim i Këshillit për Etikë 2008, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/54>

Këshilli i Nderit ka publikuar një reagim të ngjashëm në prill të vitit 2008<sup>100</sup> lidhur me sjelljen e kryeredaktorit të Televizionit Sitel, Dragan Pavloviq Llatas, i cili në lajmet e 27 shkurtit i akuzoi përfaqësuesit e opozitës dhe sektorin civil si tradhëtarë të cilët punojnë për Greqinë me qëllim që ta ndryshojnë emrin e Maqedonisë. Për Këshillin janë kontestuese vlerësimet e Llatasit se “secili maqedonas do të turpërohej nga ky akt” dhe se “kapacitetet e veta i vunë në dispozicion të ambasadores greke... se si të arrijë që t’ia imponojë Maqedonisë emrin”, pa dhënë asnjë argument dhe provë.

Këshilli po ashtu rikujton se gazetarët duhet të bëjnë dallim mes fakteve dhe mendimeve dhe të sigurojnë distancë profesionale nga partitë politike. Vlen të përmendet se në këtë reagim, Këshilli e definon edhe nocionin e gjuhës së urrejtjes i cili kuptohet si “secili fjalim i cili ka për qëllim që të ofendojë, nënçmojë, frikësojë ose të nxisë dhunë ose ndonjë veprim tjetër të dëmshëm kundër ndonjë personi të caktuar ose grup për shkak të përkatësisë së tyre të ndryshme politike, racore, gjinore apo seksuale”.

## 2.4 SHKELJE TË SHPESHTA TË KODIT ETIK

Periudha e dytë e rënies konstante të profesionalizmit në punën e medieeve të Maqedonisë fillon me paraqitjen e krizës politike në vitin 2008 e cila morri hov në katër vjetët e ardhshëm. Në këtë periudhë, shkeljet e kodeksit bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të rënda. Arsyeja për këtë është keqpërdorimi i medieeve për interesa politike, me çka gazetarët e humbin distancën profesionale nga proceset politike.

Dukurinë e tillë Këshilli e ka evidencuar në fund të vitit 2008<sup>101</sup>. Atëherë Këshilli pati publikuar reagim me të cilin e dënoi keqpërdorimin e medieeve për konfrontim mes pronarit të Televizionit Sitel, Lubislav Ivanov-Xingo, dhe pronarit të Televizioniz A1, Velija Ramkovski,

---

100 SHGM, Këshilli i Nderit, reagim, 2008, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/49>

101 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2008, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/60>

ku bënin pjesë edhe gazetat "Shpic", "Vreme" dhe "Veçer". Këshilli vlerësoi se mënyra me të cilën raportojnë këto medime rreth temave bujqësore është në kundërshtim serioz me të gjitha normat dhe standardet e gazetarisë objektive dhe të përgjegjshme. "Këshilli apelon dhe i rikujton gazetarët të cilët janë të detyruar që të jenë eksponentë të ndonjë qendre të caktuar të fuqisë politike apo biznesore se jo vetëm që kanë të drejtë të refuzojnë detyrat që nuk janë në pajtueshmëri me rregullat dhe standardet gazetareske, por edhe janë të detyruar ta bëjnë këtë, pasi që përgjegjësia për angazhimin joprofesional nuk mund të jetë kolektive, por gjithmonë ka emër dhe mbiemër", vlerëson Këshilli i Nderit dhe shton se konfrontimi mes pronarëve nuk qëndron vetëm mbi kurrizin e gazetarëve, por edhe në kurrizin e profesionit të gazetarisë.

Përveç kësaj, Këshilli u bën thirrje gazetarëve për padëgjueshmëri dhe për refuzim të detyrave që kanë për qëllim plotësimin e agjendave të caktuara nën maskën e "interesit publik".

Për shkak të interesave ekonomike, por edhe për shkak të ambicieve politike të pronarëve të caktuar të televizioneve kombëtare, mediet janë profilizuar politikisht dhe në mënyrë të hapur bëjnë tifo për favoritin e tyre politik. Këshilli i Nderit, së bashku me Bordin Drejtues të SHGM-së<sup>102</sup>, më 14 maj të vitit 2011 reagan ndaj Televizionit A1, i cili në kuadër të lajmeve u është drejtuar me thirrje qytetarëve që të marrin pjesë në tubimin e opozitës së bashkuar. Shoqata i rikujtoi redaktorët e Televizionit A1 se mediet mund të deklarohen për ndonjë opsion të caktuar politik, por duhet t'u përmbahen standardeve profesionale. "Me thirrjen e emetuar në lajmet e Televizionit A1, në mënyrë direkte shkelet neni 14 i Kodeksit të gazetarëve dhe nuk bëhet distanca e nevojshme nga aktivitetet e subjekteve politike në fushatën parazgjedhore", theksohet në reagim.

Raportime të ngjashme të njëanshme ka pasur edhe në mediet që e kanë përkrahur Qeverinë. Kjo mund të vërehet sidomos në mënyrën e raportimit për çështjen e emrit.

---

102 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2011, e disponueshme në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/96>

Në lajmet e Televizionit Sitel të emetuara më 17 mars të vitit 2008<sup>103</sup> përcillet dezinformata se Greqia në Vjenë ka vënë veto për pranimin e Maqedonisë në NATO. Këshilli ka vlerësuar se sjellja e tillë e Televizionit Sitel paraqet shkelje të Kodeksit Etik i cili kërkon nga gazetarët që të publikojnë “informata të sakta dhe të vërtetuara dhe të mos fshihen faktet thelbësore”. Duke u thirrur në informatën për tre propozimet e Nimit, Sitel erdhi në përfundim se Greqia ka vënë veto për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, edhe pse negociatat në Vjenë nuk janë vend ku Greqia mund të vendosë veto për kandidimin e Maqedonisë”, theksohet në reagim.

## 2.5 GJUHA E URREJTJES TE MEDIET E MAQEDONISË

Përvoja e Këshillit të Nderit të SHGM-së pas vitit 2008 flet për atë se mediet e Maqedonisë, më së shpeshti bëjnë shkelje të Kodeksit të gazetarëve që kanë të bëjnë me dukurinë e gjuhës së urrejtjes ose diskriminimin, si dhe nxitjen e paragjykimeve dhe stereotipeve në baza të ndryshme, etnike, politike apo orientimi seksual. Atëherë Këshilli është mëse aktiv kundër shkeljeve më të rënda të Kodeksit, duke vendosur në bazë të parashtresave të dorëzuara nga qytetarët apo duke ngritur procedurë me vetiniciativë.

Në reagimet e tilla publike, Këshilli i dënon publikisht dhe ashpër shkeljet e Kodeksit dhe njëkohësisht i rikujton mediet për obligimin që t’i respektojnë standardet dhe të ruajnë dinjitetin e profesionit të gazetarisë.

Reagimet më të ashpra të Këshillit vijnë për gjuhën e urrejtjes dhe thirrjen në dhunë kundër atyre që mendojnë ndryshe, gazetarëve dhe homoseksualëve. Këta të fundit janë një dëm kolateral për shkak se propagandistët e pushtetit i keqpërdorin paragjykimet dhe stereotipet e shoqërisë për homoseksualët si një grup i margjinalizuar, kjo me qëllim që t’i prezantojnë të gjithë kritikët e Qeverisë si “përbindësia”. Në gjithë këto raste, Këshilli ka konstatuar se forma e tillë e shprehjes nuk mund të trajtohet si e drejtë e lirisë së fjalës, por është mohim dhe keqpërdorim i saj.

---

103 SHGM, Këshilli i Nderit, 2008, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/47>

Rastet më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes Këshilli i ka regjistruar në gazetën ditore "Veçer" dhe në Televizionin kombëtar Sitel. Shembulli më eklatant i gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës kundër gazetarëve dhe atyre që mendojnë ndryshe nga pushteti është ai i publikimit të një liste me emra të personave publikë dhe gazetarëve më 18 dhjetor në gazetën "Veçer"<sup>104</sup> ku akuzohen kritikuesit e pushtetit se janë të paguar nga Greqia, se i shërbejnë propagandës greke për të nxitur ndryshimin e emrit të shtetit. Ndaj kësaj sjelljeje të "Veçerit" ka reaguar ashpër Këshilli i Nderit, i cili ka theksuar se shpalljet për tradhtar, emërimet dhe publikimet e listave janë akte që ngjasojnë me periudhën më të zezë totalitare.

"Këshilli i Nderit nuk mund dhe nuk do të mbikëqyrë se si gazetaria po shndërrohet në një mjet i lënë në duart e propaganduesve të paskrupullt të cilët nëpërmjet medieve konfrontohet me ata që nuk mendojnë si ta dhe me kritikët e garniturës aktuale qeverisëse", thekson Këshilli.

Shembull të njëjtë të gjuhës së urrejtjes, i cili është në shërbim të konfrontimit mediatic të pushtetit me ata që mendojnë ndryshe, ku ka edhe diskriminim për shkak të orientimit seksual, Këshilli ka vërejtur në po të njëjtën gazetë në vitin 2009, kur është publikuar teksti me titull "Për deklaratat pro-pederaste, Vllade Millçin do të shkojë në gjyq". Teksti është pajisur me fotografi pornografike ku autori i panjohur shkruan se Millçin i mbron pederastët, ndërsa i sulmon të tjerët.

Publikimi i këtij teksti, sipas Këshillit të Nderit, është një shkelje e rëndë e standardeve profesionale. "Teksti i theksuar në gazetën "Veçer" dhe fotografitë me të cilat është shoqëruar, është një shembull eklatant i nxitjes së urrejtjes ndaj ndonjë grupi të caktuar pakicë. Me këto elemente pornografike që janë shfrytëzuar dërgohet mesazh se të gjithë homoseksualët janë sikur ata në fotografi dhe kjo është thelbi që i përcakton. Kjo fotografi është përzgjedhur me qëllim që të nxisë urrejtje dhe neveritje; ajo e drejton gishtin te homoseksualët dhe të gjithë ata që janë kundër diskriminimit të tyre si "persona nga ana tjetër e moralit", theksohet në reagim.<sup>105</sup>

104 Veçer, 2009, e disponueshme në <http://vecer.mk/makedonija/grcija-gi-plakja-nivnite-a-vo-makedonija-svoite-novinari-za-da-pomine-grchkiot-predlog>

105 SHGM, Këshilli i Nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/84>



Antarët e Këshillit theksojnë se përveç që "Veçeri" ka publikuar tekst përplot me elemente të gjuhës së urrejtejs, në të njëjtën kohë shpërndan edhe diskriminim për shkak të orientimit seksual.

Në të njëjtin tekst, gazeta ka përcjellë deklaratën e kryeredaktorit, Dragan Pavloviq Llatas në të cilën homoseksualët janë përshkruar në një kënd ekstremisht negativ. "Nuk ekziston soj më intolerant se soji pederast... Vetëm pederastët janë pederast-pederast, kurse ne, për fat të mirë, jemi në anën tjetër dhe, ndryshe nga ata, ne bëjmë fëmijë dhe jetojmë në pajtueshmëri me natyrën", prezantohet citati problematik i Llatasit, si argument në bazë të të cilit është sjellë vendimi.

Përveç kësaj, Këshilli ka ardhur në përfundim se i njëjti tekst ka shkelë edhe parime të tjera të kodeksit siç janë përdorimi i gjuhës së pahijshme me çka janë cënuar imazhi dhe dinjiteti i profesionit të gazetarit.

## 2.6 STEREOTIPE GJATË RAPORTIMIT MEDIATIK PËR ROMËT

Raportim joprofesional në mediet e Maqedonisë ka edhe edhe kur raportohet për bashkësinë e romëve. Dukurinë e tillë, Këshilli e ka konstatuar në vendimin e saj<sup>106</sup> lidhur me parashtresën e një grupi studentësh romë pas publikimit të një teksti në gazetën "Dnevnik" më 2 janar të vitit 2009.

"Në përgjithësi, në mediet e Maqedonisë ekziston tendenca për transmetimin e stereotipeve të caktuara kur bëhet fjalë për raportin ose përpunimin e ndonjë teme që ka të bëjë me komunitetin rom. Mediet në mënyrë aktive ose pasive (vetëm si transmetues) marrin pjesë në shpërndarjen dhe forcimin e stereotipeve për romët si të varfër, si njerëz që jetojnë në lagje jourbane, në shtëpi prej kartoni dhe në rrugë ku rrjedhin fekale nga njëra anë, dhe nga ana tjetër prezantohen si persona të cilët janë vazhdimisht të hareshëm dhe këndojnë", konstatohet në vendim.

Sipas Këshillit, mediet duhet të jenë të vetëdijshme se efekti i transmetimit paralel të këtyre dy klisheve është shumë poshtërues për perceptimin e

---

106 SHGM, Këshilli i nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/62>

romëve në shoqëri dhe i forcon stereotipet negative për këtë komunitet.

Raportim diskriminues dhe me stereotipe është vërejtur në ankesën e inicuar nga trupi vetërregullator i SHGM-së kundër televizionit A1 i cili më 27 prill të vitit 2009<sup>107</sup> ka lëshuar informatë për një protestë para gjykatës në Koçan. Këshilli ka ardhur në përfundim se theksimi i nacionalitetit të protestuesve jo vetëm që nuk është i arsyeshëm, por është edhe i papërshtatshëm.

“Këshilli rikujton se standard i pranuar përgjithësisht në gazetari është ai se theksimi i nacionalitetit, gjinisë, racës, përkatësisë fetare apo orientimit seksual është i arsyetuar vetëm në qoftë se kjo ka të bëjë direkt me raportimin e rastit për të cilin informohet; në të kundërtën, kjo paraqet forcim të stereotipeve dhe paragjykimeve si hyrje në diskriminim”, përfundon Këshilli.

Shkelje të ngjashme, Këshilli i Nderit ka vërejtur edhe në gazetën “Vreme”, e cila më 10 prill të vitit 2009<sup>108</sup> ka informuar për një rrahje mes qytetarëve të etnitetit rom. Në vendim theksohet se gjeneralizimi i tillë i romëve prodhon paragjykime dhe stereotipe. “Duke marrë parasysh se informimi për grupet që janë pakica kërkon vëmendje të veçantë dhe përgjegjësi nga gazetarët, Këshilli rikujton se gjeneralizimet asnjëherë nuk janë të vërteta dhe se paragjykimet dhe stereotipet janë hyrje në diskriminim i cili nuk i ngjan një gazetarie të përgjegjshme dhe etike”, thuhet në vendim.

Mirëpo, jo të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me raportimin për romët janë pranuar si të bazuara. I tillë është teksti i publikuar më 20 shkurt të vitit 2009 në gazetën ditore “Dnevnik”<sup>109</sup> me titull “Maqedonia ka mëse tre mijë njerëz fantomë”. Në këtë tekst Këshilli nuk ka vërejtur asnjë shkelje të Kodeksit të gazetarëve në asnjë bazë. “Këshilli rikujton se interesi publik është kriteri kyç i angazhimit të gazetarit, prandaj vlerëson se bëhet fjalë për tekst i cili ka për qëllim përpunimin dhe informimin

---

107 SHGM, Këshilli i nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/75>

108 SHGM, Këshilli i Nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/74>

109 SHGM, Këshilli i Nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/68>

për një dukuri të caktuar me zgjidhjen e së cilës do të përfitonin gjithë qytetarët e Maqedonisë, e sidomos anëtarët e komunitetit rom dhe si i tillë është në pajtueshmëri me praktikën më të mirë të gazetarisë”, theksohet në vendim.

Vendim të njëjtë Këshilli ka marrë edhe për ankesën e parashtruar kundër tekstit me titull “Baci hodhi 20 mijë euro për nuse të virgjër”, të publikuar në gazetën “Veçer”<sup>110</sup> më 4 gusht të vitit 2009. Duke e kontestuar parashtresën, Këshilli theksoi se martesat e hershme të komunitetit rom janë fakt i pakontestueshëm i cili lehtësisht mund të konfirmohet në bazë të përvojës apo edhe duke konsultuar literatura. “Edhe sot lidhen martesat të rregulluara dhe për nusen paguhen disa mijëra euro”. Kjo nuk është gjeneralizim, pasi që autori nuk ka për qëllim të theksojë se të gjitha martesat e komunitetit rom janë të tilla” theksohet në vendim.

## **2.7 RËNIE DRASTIKE E CILËSISË SË RAPORTIMIT MEDIATIK**

Rënia drastike e cilësisë së raportimit mediatic në Maqedoni vjen në shprehje pas vitit 2012, kur kriza politike eskaloi me kontestimin e rezultateve zgjedhore nga opozita në vitin 2014 dhe kur u mbajtën protesta masive qytetare. Në këtë periudhë vjen në shprehje instrumentalizimi i medieve nga ana e pushtetit, i cili i përdor at si mjet propagandues për ta ruajtur pushtetin dhe për t’u konfrontuar me opozitën politike. Gjithë kjo bëhet me anë të diskreditimit personal, duke përdorur gjuhë të ashpër të urrejtjes në të gjitha bazat.

Një dukuri shqetësuese në këtë periudhë janë fushatat e koordinuara mediaticke nga mediet proqeveritare kundër opozitës, nga medie të tjera që e kritikojnë qeverinë, përfaqësues të sektorit civil ose të institucioneve që janë jashtë kontrollit të pushtetit.

Këta persona nga mediet proqeveritare ekspozohen me një gjuhë të ashpër të urrejtjes dhe diskriminimit dhe sulmojnë imazhin dhe dinjitetin e tyre duke i prezantuar si kriminelë dhe tradhtarë. Sulme të tilla të

---

110 SHGM, Këshilli i Nderit, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/81>

ashpra, Këshilli i Nderit ka vërejtur gjatë shqyrtimit të parashtresës së Gjykatës Kushtetuese<sup>111</sup> kundër Televizionit Sitel, javores "Republika", gazetës "Veçer" dhe portaleve të internetit "Kurir" dhe "Press 24". Gjykata ankohet për mënyrën e raportimit të këtyre medieve lidhur me vendimin negativ të kësaj gjykate kundër synimeve të qeverisë që emrat e personave të dënuar për pedofili të publikohen. Vetë fakti se Gjykata Kushtetuese ka parashtruar një ankesë për të gjitha mediet e përmendura, bën me dije se edhe Gjykata edhe Këshilli janë të vetëdijshëm se ekziston një tendencë e koordinuar e këtyre medieve për ta nxirë imazhin e gjykatësve të Kushtetueses para publikut, duke i prezantuar ata si mbrojtës të pedofilëve.

Këshilli ka vërtetuar në mënyrë të pahamendshme shkelje masive të standardeve profesionale nga ana e të gjitha medieve të theksuara në ankesë. Shkeljet më të rënda janë vënë re në mënyrën e raportimit të javores "Republika", e cila, duke tentuar t'i zbulojë motivet e gjykatësve kundër vendimit që t'i publikojë emrat e të dënuarve për pedofili, i paraqiti ata si të paaftë, njerëz johumanë, pa arsye dhe ndjenjë prindërore, të korruptuar dhe me ndjenja të degjeneruara pedofilie.

"Autori e keqpërdori prirjen e temës e cila zgjon reaksione intensive dhe emocion në mënyrë të natyrshme, duke e anuar ndjenjën negative që e shkakton kjo vepër penale nga personaliteti i gjykatësve dhe gjykata si institucion, duke tentuar që t'i nxijë ata edhe në konotacion politik", konstaton këshilli.

Me një ton tejet negativ dhe agresiv të raportimit për vendimin e Gjykatës Kushtetuese kanë raportuar edhe mediet e tjera të theksuara në ankesë. Në lidhje me Televizionin Sitel, Këshilli vlerëson se raportimi është tendencioz: në vend se të raportojë për vendimin e gjykatës, implikon njëanshmëri të gjykatësve, ndërkohë që portali "Kurir" në mënyrë paushale i ka akuzuar gjykatësit se në vend që të vihen në anën e viktimave, në mbrojtje të tyre, ata janë vënë në mbrojtje të autorëve të veprave të tilla të tmerrshme.

Mendim të ngjashëm Këshilli ka miratuar edhe për raportimin e portalit "Press 24" dhe gazetës "Veçer". Në rastin e parë është konstatuar interpretim joadekuat i vendimit të gjykatës, ndërsa në rastin tjetër gazeta merret me

---

111 SHGM, Këshilli i Nderit, 2013, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/662>

gjendjen personale, familjare të gjykatësve, me qëllim që t'u shkaktojë dëm në imazhin dhe nderin e tyre.

Në kohë kur Këshilli nuk ka të drejtë ta vlerësojë punën e gazetarëve të cilët nuk janë anëtarë të SHGM-së, ai gjen mënyrë që ta regjistrojë dukurinë e keqpërdorimit të pahijshëm të gazetarëve nga ana e qendrave të fuqisë për të promovuar interesat e tyre.<sup>112</sup>

## 2.8 TRENDI I PUBLIKIMIT TË INFORMATAVE TË PAKONFIMUARA

Në reagimin e përgjithshëm të marsit të vitit 2015, Këshilli iu bën thirrje të gjithë gazetarëve që të mbajnë llogari për atë se çfarë informatash publikojnë, se çfarë fjalori përdorin dhe me çfarë argumentesh i mbështesin tekstet e tyre. Në këtë fakt duhet pasur kujdes, sidomos kur mediet publikojnë përmbajtje që janë direkt të drejtuara ndaj dikujt.

„Paralajmërojmë se në një numër të madh tekstesh po publikohen informata të pakonfirmuara, ose vendosen tekste pa nënshkrime, me çka shkelen standardet dhe normat profesionale dhe etike. Shumë shpesh përhapet gjuhë e urrejtjes dhe krijohet ambient linçimi kundër atyre që mendojnë ndryshe apo, të paktën, krijohet intolerancë ndaj personave apo grupeve të caktuara”, përfundon Këshilli. Përveç kësaj, ai i rikujtoi portalet e internetit si të barabarta me mediet e tjera, që të japin kontribut në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të gazetarisë si profesion e jo të nxisin gjuhën e urrejtjes, intolerancën apo nxirjen e personaliteteve dhe grupeve të caktuara.

Fjalimet e tilla të pahijshme dhe diskriminimi në baza etnike janë regjistruar edhe në rastin e inicuar nga Këshilli në portalin Maktel, kur më 24 korrik të vitit 2016 u publikua një video-incizim me deputetin Amdi Bajram, me titull “Радуј се Циго, уште малце и пак ќе одиш у Шутка, извалкан си до гуша у криминал”<sup>113</sup>. Këshilli e dënoi ashpër sjelljen e këtitillë joprofesionale të redaktorit Ivanovski që është në kundërshtim me etikën gazetareske.

112 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2015, e disponueshme në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/884>

113 SHGM, Këshilli i Nderit, Mendim, 2016, e disponueshme në <http://znm.org.mk/?p=2612>

“Pronari i Maktel.mk në mënyrë publike manifeston gjuhë të urrejtjes dhe nxit diskriminim në bazë nacionale dhe dhe racore. Në të njëjtën kohë, ai e ka ofenduar komunitetin rom, gjë që është nuk përputhet me profesionin e gazetarit”, qëndron në mendimin e Këshillit duke shtuar se gazetarët duhet ta kenë prioritet ruajtjen e vlerave kulturore dhe etike pasi që janë në interes të publikut dhe të lirisë së shprehjes.

Një prej thirrjeve të rralla, të hapura, të Këshillit të Nderit<sup>114</sup> drejtuar gjithë gazetarëve, është nxitur nga mënyra senzacionaliste e raportimit të medieeve për vrasjen e dy të rinjve shqiptarë në Gostivar nga ana e një polici të etnitetit maqedonas , për shkak të një zënke banale për vendparkim.

“Përveç objektivitetit, paanshmërisë dhe profesionalitetit, janë të nevojshme tendenca qetësuese e jo senzacionalizëm dhe tekste të cilat kontribuojnë në nxitjen e emocioneve dhe tensioneve ndëretnike”, vlerëson Këshilli dhe u bën thirrje gazetarëve që të ngrihen në lartësinë e raportimit profesional.

Vendosja e interesave ekonomike të medias para së gjithash në llogari të profesionit të gazetarisë mund të vërehet në shembullin e incidentit të shkaktuar nga Televizioni Kanal 5<sup>115</sup>, i cili në qershor të vitit 2012 publikoi informatë për gjoja aksident ajror. Më vonë televizioni kërkoi falje duke pranuar se kanë bërë një reklamë të papërshtatme, por Këshilli i Nderit këtë sjellje e ka vlerësuar si keqpërdorim dhe dezinformim të ashpër me të cilin interesi ekonomik i televizionit është vënë para interesit qytetar. “Televizioni ka ngjallë frikë dhe habi te qytetarët, edhe atë qëllimisht, për ta reklamuar emisionin e tij. Njëkohësisht, janë prekur ndjenjat e qytetarëve duke u shkaktuar frikë dhe dyshime”, theksohet në reagim.

## **PARASHTRESA TË REFUZUARA NGA KËSHILLI I NDERIT**

Këshilli i Nderit gjatë punës së tij ka refuzuar shumë parashtresa kundër gazetarëve si të pabaza. Në mars të vitit 2015, Kabineti i presidentit Gjorge Ivanov<sup>116</sup> ka dorëzuar parashtresë kundër gazetës ditore “Vest”

114 SHGM, Këshilli i Nderit, Apel, 2012, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/337>

115 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2012, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/374>

116 SHGM, Këshilli i Nderit, Vendim, 2015, e disponueshme në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/taxonomy/term/145>

për shkak të raportimit joprofesional për aktivitetet ndërkombëtare të presidentit. Ankesa është refuzuar me shpjegim se autori i tekstit ka theksuar në mënyrë të qartë se objekt analize e punës së kryetarit janë takimet zyrtare ndërkombëtare shtetërore, e jo takimet e punës. Si argument i dytë me të cilin refuzohet parashtresa jipet fakti se informatat janë marrë nga faqja zyrtare e presidentit si një burim relevant.

Janë refuzuar edhe dy parashtresa kundër gazetës "Dnevnik" të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme<sup>117</sup> dhe Drejtoria e Doganave<sup>118</sup>. Është konstatuar se nuk ka pasur shkelje të Kodeksit pasi që informatat e përcjella kanë qenë të sakta dhe kanë ofruar paraqitjen e qëndrimit të palëve të prekura.

## 2.9 RISHIKIM I SHKURTËR I PUNËS SË KEM-IT

Nga ana tjetër, KEM-i, për më shumë se dy vjet funksionimi, ka shqyrtuar më shumë se 130 ankesa të qytetarëve. Në përqindjen më të madhe të ankesave të parashtruara, Komisioni për ankesa i Këshillit Etik ka konstatuar shkelje të Kodeksit të Gazetarëve. Vetëm në 28 lëndë, Komisioni nuk ka konstatuar shkelje pasi që në 16 raste nuk ka pasur bazë, ndërsa rastet e tjera janë mbyllur me pajtimin e palëve në kontest apo për shkaqe të ndryshme rastet janë mbyllur.

Rrallëherë ndonjë parashtresë e bazuar ka të bëjë me vetëm një nen të Kodeksit të gazetarëve, pasi në të shumtën e rasteve, Komisioni ka konstatuar shkelje të dy ose më shumë neneve të Kodeksit në një lëndë.

Nga ankesat e shqyrtuara, më së shpeshti, apo në 76 lëndë, Komisioni ka vërtetuar se mediet e kanë shkelur nenin 1 të Kodeksit me të cilin gazetari obligohet të publikojë informata të vërteta dhe të konfirmuara dhe nuk do të fshehë të dhëna thelbësore. Vërtetësia e informatës do të kontrollohet aq sa është e mundur, kurse kur bëhet fjalë për supozim apo për spekulim, kjo gjë duhet theksuar.

---

117 SHGM, Këshilli i Nderit, Vendim, 2009, e disponueshme në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/66>

118 SHGM, Këshilli i Nderit, Vendim, 2012, e disponueshme në <http://bit.ly/2h1DRD2>

Komisioni ka konstatuar edhe shkelje të shpeshta, gjithsej 64, të nenit 13 të Kodeksit i cili kërkon nga gazetarët që të bëjnë dallim mes fakteve dhe mendimeve, respektivisht mes lajmit dhe komentit. Neni 10, i cili i obligon gazetarët që të mos përpunojnë informata me të cilat do të kërcënonin jetën, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të mos flasin me gjuhën e urrejtjes, është në vendin e tretë për sa i përket shkeljeve të konstatuara nga ankesat. Shkelje të kësaj natyre Komisioni ka vërejtur në 53 lëndë që i ka shqyrtuar.

Në një numër më të vogël të lëndëve, Komisioni ka vërejtur shkelje të nenit 14 dhe 16 që kanë të bëjnë me raportim të paanshëm dhe të balancuar të gazetarëve, si dhe me sigurimin e distancës profesionale nga partitë politike. Këto nene, më saktësisht, kanë të bëjnë me obligimin e gazetarëve që të ruajnë imazhin dhe dinjitetin e profesionit dhe të nxisin solidaritet, pa i përdorur mediet për konfrontim me të tjerët. Në 22 lëndë, Komisioni ka konstatuar se gazetarët nuk kanë mbajtur distancë nga partitë dhe kështu e kanë prishur imazhin dhe dinjitetin e profesionit.

Një numër shumë më i vogël i vendimeve kanë të bëjnë me shkelje të nenit 7 dhe 11, të cilët obligojnë respektimin e privacisë së personit, respektivisht ruajtjen e standardeve shoqërore për dinjitet dhe respektim të dallimeve në Maqedoni.



# 3. ETIKA NË SERVISIN RADIODIFUZIV PUBLIK TË MAQEDONISË

## 3.1 VETËRREGULLIMI NË SERVISIN PUBLIK NË KUADËR TË RSFJ-SË

Politika evropiane mediatike bazohet në konceptin e interesit publik në sferën mediatike. Në teorinë e së drejtës mediatike dhe politikës mediatike, koncepti i interesit publik lidhet me “qeverisjen e mirë” dhe “participimin efektiv qytetar”<sup>119</sup>

Realizimi i interesit publik në radiodifuzion, më së shumti lidhet me rolin dhe detyrat e servisit radiodifuziv, duke mos i larguar edhe dy sektorët radiodifuzivë, atë komercial dhe joprofitabil.

Servisi radiodifuziv publik është determinanta e një shoqërie demokratike, respektivisht servis i qytetarëve. Në protokollin e Amsterdami për sistemin e radiodifuzionit publik në vendet anëtare të Bashkimit Evropian të vitit 1997 theksohet se radiodifuzioni publik është i lidhur direkt me plotësimin e nevojave demokratike, shoqërore dhe kulturore të secilës shoqëri dhe paraqet një faktor për kohezion në shoqëri. Me fjalë të tjera, servisi publik nuk duhet t’i shërbejë as Qeverisë e as Parlamentit, as presidentit, as partive politike dhe asnjë qendër tjetër të fuqisë. Ai duhet të jetë i pavarur nga të gjitha qendrat e fuqisë dhe t’i shërbejë vetëm interesit të qytetarëve. Roli dhe detyrat e servisit publik janë të definuara në mënyrë të përgjithshme në Rezolutën numër 1 për ardhmërinë radiodifuzionit publik të sjellë në vitin 1994 në konferencën e katërt për politikat e mas-medieve në Pragë<sup>120</sup>, ndërsa më vonë edhe në rekomandimin e R (96) 10 të Këshillit të Evropës për garantimin e pavarësisë së servisit publik.

119 Buckley, S., Duer, M. K., Mendel, T., & O’Siochru, S. (2008), *Broadcasting, Voice, and Accountability: A Public Interest Approach to Policy, Law, and Regulation*, Washington: University of Michigan Press.

120 4TH EUROPEAN MINISTERIAL CONFERENCE ON MASS MEDIA POLICY (PRAGUE, 7-8 DECEMBER 1994), në dispozicion në <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=411463&SelectionMode=1&DocId=517420&Usage=2>, qasur më 14.12.2016

Pas këtyre dy dokumenteve, Këshilli i Evropës dhe Kuvendi Parlamentar miratuan edhe një sërë rekomandimesh dhe rezolutash<sup>121</sup>, të cilat i afirmojnë dhe theksojnë vlerat dhe parimet e vendosura në dokumentet e para. Në këto dokumente janë konstatuar misioni dhe karakteristikat programore të servisit radiodifuziv publik, sidomos roli i tij në zbatimin e promovimit të standardeve profesionale dhe normave etike të medie.

Fillet e televizionit në Maqedoni janë të lidhura me zhvillimin e sistemit radioteleviziv në kuadër të RSFJ-së kur më 14 dhjetor të vitit 1964 janë emetuar lajmet e para televizive në kohëzgjatje prej 20 minutash. Në progarim e saj gjatë periudhës së vetëqeverisjes, në kuadër të radiotelevizionit të përbashkët shtetëror, Shkupi, në pajtim me nenin 19 të Ligjit për informim publik të vitit 1974, ka qenë i obliguar që, përveç respektimit të ligjeve "gjatë kryerjes së detyrës, t'u përmbahet edhe normave profesionale dhe shoqërore etike dhe kodeksit të gazetarëve, ta respektojë të vërtetën, nderin, imazhin dhe të drejtat e punëtorëve e të qytetarëve, t'i respektojë interesat e shoqërisë, të japë kontribut në realizimin e vetëqeverisjes, të lirive dhe të drejtave të njeriut... Gazetarët dhe personat e tjerë që merren me informimin e opinionit janë përgjegjës për vërtetësinë e përcjelljes së informatave".<sup>122</sup> Radio-televizioni i Serbisë, si organizatë radiodifuzive, atëherë, në pajtim me nenet 65-68 që kanë të bëjnë me "korrigjimin" si instrument i përgjegjësisë ndaj publikut, është obliguar që të vetërregullohet duke zbatuar normat etike nga ana e gazetarëve dhe redaktorëve.

---

121 <http://www.coe.int/en/web/freedom-expression>, 12.12.2016

122 <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/A13900384849485BA96D4F3F2B8FE59B.pdf>

## 3.2 VETËRREGULLIMI NË SERVISIN RADIODIFUZIV PUBLIK PAS PAVARËSIMIT

Në vitet e 90-ta, ngjashëm si edhe në vendet e tjera ish-jugosllave, Republika e Maqedonisë donte ta ndërpriste sistemin e vjetër të kontrollit shtetëror, radiodifuzionin e orientuar nga propaganda, dhe u orientua drejt servisit publik si alternativë e dëshiruar (Broughton-Micova:1)<sup>123</sup>. Në fazat fillestare të Maqedonisë demokratike, ky proces ishte jashtëzakonisht i vështirë. Vendi formalisht e braktisi sistemin e vjetër, megjithatë dështoi në zbatimin e vlerave të rregullimit demokratik edhe në sferën e radiodifuzionit publik.

Në kuadër të ndryshimeve më të gjera shoqërore, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, më 10 maj të vitit 1991, e miratoi vendimin e "Këshillit të Punëtorëve të RTS-së", me të cilin shtëpia riemërohet në Radio-Televizioni i Maqedonisë, ndërsa TV Shkupi riemërohet në Televizioni i Maqedonisë.<sup>124</sup> Pastaj, funksionimi i RTVM-së ishte rregulluar me Ligjin e vitit 1999 si Ndërmarrje Publike Radio-Televizioni Maqedonas (Gazeta zyrtare nr. 6/98 dhe ndryshimet e Gazetës zyrtare nr. 78/04).

Madje, në vitin 2005, me Ligjin për veprimtari radiodifuzive (neni 122), MRTV-ja obligohet që gjatë krijimit ose emetimit të programit t'i respektojë parimet profesionale, ndërsa me ligjin e njëjtë (neni 133), Këshilli i MRTV-së merr kompetenca të miratojë akte për standardet etike dhe profesionale në krijimin e programit të MRTV-së.<sup>125</sup> Por, obligimin e tillë MRTV-ja nuk e zbatoi as në periudhën vijuese.

Enti Shtetëror për Revizion në vitin 2008 ka konstatuar se: "Këshilli i Radio-Televizionit të Maqedonisë më 10 korrik të vitit 2006 ka kryer ndryshime të Statutit të ndërmarrjes me ç'rast është kryer ndryshimi i organeve të menaxhimit dhe udhëheqjes, ndërsa më 1 gusht të vitit 200

---

123 Broughton Micova Sally (2010), Finding a Niche: Small States Public Service Broadcasting in Slovenia and Macedonia. (RIPE)

124 RTVM servis publik i qytetarëve? 2013, në dispozicion në <http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/MRT-Javen-servis-na-gragjanite.pdf>, qasur më 10.12.2016

125 Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 100, 2005, në dispozicion në <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/74AEA2A6F3A1454E895BE81FB97AF16A.pdf>, qasur më 11.12.2016

janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Drejtues, të cilët kanë pasur obligim që deri më 10 tetor të vitit 2006 t'i sjellin aktet e përgjithshme të ndërmarrjes. Miratimi i akteve të përgjithshme deri në datën e caktuar nuk është respektuar plotësisht<sup>126</sup>. Mes akteve të përgjithshme të shkruara që nuk janë miratuar, është edhe Deklarata për standardet etike dhe profesionale në krijimin e programit.

Në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2008, gazetarët dhe redaktorët gjatë kryerjes së obligimeve të punës i kanë respektuar vullnetarisht parimet e Kodit të Gazetarëve të miratuar më 14 nëntor të vitit 2001 nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Kodi është përkthyer në gjuhët e të gjitha bashkësive etnike, në të cilat transmetohet programi i MRTV-së, është vendosur në vend të dukshëm në të gjitha redaksitë dhe serviset e programit në servis publik deri në vitin 2008. Prej atëherë, Kodi i Gazetarëve është larguar nga vendet e dukshme dhe gazetarët konsultohen me të vetëm përmes ueb-faqes së SHGM-së.<sup>127</sup> Kjo sidomos kontribuon për lëshime gjithnjë e më të mëdha në zbatimin e standardeve profesionale, sidomos nga redaktorët e servisit publik.

Në servis publik, gjendja me mosrespektimin e etikës gazetareske është përkeqësuar në periudhën pas miratimit të ndryshimeve të Ligjit për radiodifuzion në vitin 2011, kur në mënyrë urgjente është rritur numri i anëtarëve të radiodifuzionit, nga 9 në 15. SHMG-ja kishte reaguar se me ndryshimet e propozuara të përbërjes së Këshillit për Radiodifuzion, Qeveria dëshiron të vendosë kontroll të plotë ndaj këtij trupi.<sup>128</sup> Kjo, nga ana tjetër, nënkuptonte rritje të ndikimit të partive në pushtet ndaj politikës redaktuese të MRTV-së dhe braktisje të etikës në krijimin dhe transmetimin e programit, në kundërshtim me misionin e servisit publik, në kuptimin e përgjegjësisë shoqërore dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, me paratë e të cilëve financohet kryesisht. Në RTVM, përmes

126 Enti Shtetëror për Revizion, 2008, (faqe 22-25), në dispozicion në <http://www.dzr.mk/Uploads/2006%20-%20JP%20Makedonska%20radio-televizija.pdf>, qasur më 14.12.2016

127 Intervistë me gazetarë nga redaksitë e dy serviseve të programit të TVM-së, realizuar nga 01.12.2016 deri 6.12.2016

128 DW, SHGM: „Qeveria ka për qëllim kontrollimin e KRD-së“, 2011, në dispozicion në <http://www.dw.com/mk/зnm-владата-има-намера-да-го.../a-15249092>, qasur më 14.12.2016

kontrollit të Këshillit të Programit, në pozita udhëheqëse vendoseshin para së gjithash kuadro partikë të cilët nuk arritën të sigurojnë pavarësi nga forma të ndryshme të ndikimit. Lajmet dhe programet aktuale-informative vite me radhë ngelën nën ndikimin e strukturave partiake në pushtet, kështu që besimi i publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre thuhet ishte humbur tërësisht. "RTVM sot nuk është 'forum për debat publik' dhe as nuk siguron hapësirë të mjaftueshme për shprehjen e ideve, mendimeve apo kritikave".<sup>129</sup> Për Shoqatën e Gazetarëve, duke e vlerësuar rëndësinë e servisit publik në një shoqëri demokratike, RTVM-ja u shndërrua në një nga agjendat kryesore në bisedimet me Qeverinë. Kjo temë u bë aktuale edhe në Planin aksional të bashkësisë së gjerë mediatike.<sup>130</sup>

Në ligjin për veprimtari radiodifuzive të vitit 2005, i ndryshuar dhe plotësuar disa herë deri në vitin 2012, është theksuar qartë se programet e RTVM-së duhet të jenë të pavarura nga cilado qendër e pushtetit: "Për shkak të realizimit të interesit publik, RTVM është e obliguar që të sigurojë që programet të cilat prodhohen dhe transmetohen të jenë të mbrojtura nga çfarëdo ndikimi qoftë nga pushteti, organizatat politike ose qendrat e tjera të pushtetit" (neni 121, paragrafi 1, alinea 1). Në nenin 122 thuhet edhe se "RTVM-ja është e obliguar që gjatë krijimit dhe transmetimit të programit të respektojë parimet profesionale dhe t'u sigurojë qasje të barabartë interesave të ndryshme në shoqëri, të angazhohet për lirinë dhe pluralizmin e shprehjes së mendimit publik...".<sup>131</sup> Statuti i RTVM-së, në nenin 32, parashikon që Këshilli i RTVM-së të miratojë "akte me të cilat rregullohen standardet etike dhe profesionale në krijimin e programeve të RTVM-së". Kjo dispozitë është përshkruar nga neni 133 i Ligjit për veprimtari radiodifuzive, por

---

129 Tërpevska, Snezhana, Jakimovski, Lubomir, Shopar, Vesna, Petkovska, Biljana, Trajkovska, Zhaneta, Analiza e radiodifuzionit publik në Republikën e Maqedonisë në kontekst të politikës evropiane për mediat, 2010, Shkup, në dispozicion në [http://www.vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/1143\\_Analiza\\_na\\_javen\\_servis.pdf](http://www.vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/1143_Analiza_na_javen_servis.pdf), qasur më 13.12.2016

130 SHGM, "Plani aksional i SHGM-IMM, mars 2012", Shkup, në dispozicion në [http://znm.org.mk/drupal-7.7/sites/default/files/Akciski%20plan\\_ZNM\\_MIM\\_22\\_March\\_mk.pdf](http://znm.org.mk/drupal-7.7/sites/default/files/Akciski%20plan_ZNM_MIM_22_March_mk.pdf)

131 Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 100, 2005, në dispozicion në <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/74AEA2A6F3A1454E895BE81FB97AF16A.pdf>, qasur më 12.12.2016

Këshilli i RTVM-së as deri në vitin 2013 nuk e implementoi obligimin e tij, respektivisht nuk solli akte me të cilat rregullohen standardet etike dhe profesionale gjatë krijimit të programit.

Me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale të vitit 2013, në nenin 111, i cili ka të bëjë me standardet dhe parimet, është përcaktuar: "Gjatë prodhimit ose prezantimit të programeve, gazetarët dhe redaktorët e RTVM-së, si dhe personat të cilët drejtpërdrejt janë të përfshirë në prodhimin dhe produksionin e programeve në RTVM, mes tjerash, janë të obliguar t'u përmbahen parimeve të vërtetësisë, paanshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së informatave, t'u përmbahen parimit të balancimit dhe pluralizmit politik të këndvështrimeve, të sigurojnë informacione të paanshme, gjithëpërfshirëse dhe të rëndësishme dhe të njëjtat t'i prezantojnë qartë, pa mëdyshje dhe në mënyrë në të cilën qytetarët do të kenë mundësi që të formojnë lirshëm mendimin e tyre, të mos përfaqësojnë apo favorizojnë qëndrime ose interesa të ndonjë partie të caktuar politike, shoqate, interes personal, religjion ose ideologji dhe në programet e tyre t'i japin rëndësi të njëjtë mendimeve dhe bindjeve të të tjerëve, si dhe të respektojnë privacinë, dinjitetin, reputacionin dhe nderin e individëve."<sup>132</sup> Respektimi i kësaj dispozite është bazë e mirë për inicimin e vendosjes së trupit vetërregullativ në kuadër të RTVM-së. Parakushtet rrumbullakësohen me nenin 14 dhe sidomos me nenin 43 të Statutit të RTVM-së, ku Këshilli i Programit merr kompetencë që t'i miratojë rregullat e përgjithshme për standardet e programit dhe ato profesionale në RTVM.<sup>133</sup>

Përfundimisht, më 17 nëntor të vitit 2015, udhëheqja e RTVM-së e prezantoi tekstin e Kodit Etik. Në debatin publik, gazetarët dhe kameramanët, shoqatat e gazetarëve dhe Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale i potencuan vërejtjet ndaj tekstit të propozuar.<sup>134</sup>

132 Gazeta zyrtare e RM-së nr.184, 2013, Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale, (faqja 31) në dispozicion në <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b063254742a44129b8dfe1221762d-db4.pdf>, qasur më 12.12.2016

133 Gazeta zyrtare e RM-së nr.17, 2015, Statuti i Ndërmarrjes publike radiodifuzive RTVM, në dispozicion në <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/3972172cb0e147d5a200e237b5b7aad3.pdf>, qasur më 12.12.2016

134 Telegraf.mk, 2015, në dispozicion në <http://telegraph.mk/default.aspx?ItemId=-07674e30-62b6-41b4-a5ca-9bd40154d9bd&newsArticleId=81c28d34-3ac7-44d5-b837-47c5810c2d0a&>, qasur më 12.12.2016

**SHGM-ja i përkrahi angazhimet e RTVM-së për miratimit e Kodit Etik, por kërkoi që të prolongohet për shkak të vërejtjeve të numërta të cilat i kishte ndaj dokumentit. Vërejtja kryesore ishte se propozim kodi i përziën standardet etike të gazetarëve me disiplinën në punë. Me qëllim që të mos shkaktohet konfuzion, SHGM-ja dorëzoi vërejtje me shkrim për përmirësimin e tekstit. Mes tjerash, SHGM kërkoi:**

- Kodi të ndahet në dy pjesë. Në Kodin Etik të përpunohen vetëm parimet etike të profesionit gazetaresk, ndërsa në pjesën tjetër të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me disiplinën në punë. Kjo ndarje është e domosdoshme për shkak se nuk është e lejuar që në vend të njëjtë të rregullohet etika, e cila rrjedh nga standardet profesionale të profesionit gazetaresk dhe disiplina në punë, e cila rregullohet me ligj, akte nënligjore dhe marrëveshje kolektive. SHGM-ja paralajmëron se, nëse nuk ndahen këto dy çështje, do të shkaktohet konfuzion gjatë zbatimit, për shkak se udhëheqja do të mund të keqpërdorë kundërthëniet në Kod kundër gazetarëve;
- Kodi Etik t'u referohet vetëm gazetarëve dhe kuadrit kreativ në RTVM, dhe jo të gjithë të punësuarve në këtë shtëpi. Realisht, Kodi Etik nuk mund të shkelet nga ndonjë i punësuar në administratën juridike, për shembull;
- Në Kod në një vend duhet të përpunohen hollësisht parimet e raportimit gazetaresk, siç janë: parimi i vërtetësisë dhe objektivitetit, parimi i balancimit, parimi i ndarjes së qartë mes informatës dhe komentit, parimi i ndershmërisë dhe pavarësisë, parimi i solidaritetit profesional, parimi i pavarësisë redaktuese dhe integritetit profesional, parimi i respektit dhe tolerancës, parimi i lirisë dhe përgjegjshmërisë;
- Neni 11, i cili parashikon që të punësuarit në RTVM të mos mund të ngrisin procedura gjyqësore ose të kërkojnë ndihmë juridike nga shoqatat e esnafit kur u shkelen të drejtat në marrëdhënien e punës ose kur u janë ekspozuar censurës, është ligjërisht i pabazë, sepse ua shkurton të drejtat gazetarëve, të drejta të cilat i kanë në pajtim me ligjet e tjera, dhe mundëson që gazetari të ekspozohet në mobing në kuadër të RTVM-së;
- Skajshmërisht problematik dhe konfuz është neni 12, me të cilin gazetarët obligohen që në paraqitjet publike të respektojnë interesat afariste dhe programore të RTVM-së. Askund nuk është precizuar qartë dhe taksativisht

cilat janë ato interesa afariste dhe programore. Është e papranueshme, sipas SHGM-së, t'u ndalohe gazetarëve që të japin deklarata në publik për punën e RTVM-së. Parim bazë i profesionit gazetaresk është që gazetari nuk do të fshehë asgjë që është në interes publik, kështu që nuk do të heshtë as në ndonjë informatë eventuale që ka të bëjë me keqpërdorim të mundshëm në këtë shtëpi mediatike;

- Në paragrafin 1 të nenit 21, i cili parashikon se raportimi nga veprimtari kriminale, procedura gjyqësore, aksidente në komunikacion dhe fatkeqësi të tjera nuk duhet të jetë sensacionalist ose nuk duhet të shkaktojë shqetësim, frikë ose panik, është e nevojshme që të shtohet edhe një paragraf i ri. Në të duhet të shtohet se mund të ketë lëshime nëse janë në rrezik jetë njerëzish dhe interesi publik. Nëse nuk bëhet përjashtim nga raportimi sensacionalist, paragrafi i parë mund të paraqesë formë të butë të censurës. Përveç kësaj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ua pranon qartë të drejtën e gazetarëve për ta tepruar dhe për ta shokuar opinionin, nëse qëllimi është nxitja e debatit për çështje të interesit publik;

- Është e paqartë se prej nga janë nxjerrë sajestat për rëndësinë objektive të opinionit ose rëndësinë objektive të ngjarjeve. Sajestat e tilla jashtë standardeve mund ta relativizojnë interesin publik dhe të sjellin forma jostandarde për vlerësimin e asaj që është e arsyeshme, e çfarë jo;

- Neni 72 i përjashton redaktorët përgjegjës dhe redaktorët e programit nga përgjegjësia para Komisionit për vërtetimin e shkeljeve të Kodit. Redaktorët para se gjithash janë gazetarë dhe ata kanë përgjegjësi madje edhe më të madhe për respektimin e standardeve etike të profesionit gazetaresk, kështu që nuk ka asnjë arsye që ata të mos i nënshtrohen përgjegjësisë përpara Komisionit. Paragrafi i fundit i këtij neni zbulon se pse nën titullin Kod Etik rregullohen parimet etike të profesionit dhe disiplina në punë. Kjo lë dyshim se bëhet me qëllim që mbi bazën e parimeve të paqena etike të përjashtohen gazetarë nga puna, respektivisht manipulim me vetëdijë që të disiplinohen gazetarët e padëgjueshëm.

Edhe dhjetëra vërejtje të tjera janë nënvizuar nga SHGM-ja për përmirësimin e Kodit Etik të RTVM-së. Ai duhet të plotësohet dhe të korrigjohet. Pas disa tentativave që të shtyhet miratimi i Kodit, Këshilli i Programit të RTVM-së e prolongoi miratimin e tij.



Në mungesë të Kodit të Etikës dhe pas paralajmërimeve për zgjedhje të parakohshme parlamentare, më 26 janar të viti 2016 u promovua doracaku "Parimet profesionale dhe etike të RTVM-së për raportimin mediatik mbi procesin zgjedhor". Ky dokument duhej t'u shërbente gazetarëve të servisit publik për raportim të lirë dhe të papenguar, të paanshëm dhe të drejtë.<sup>135</sup>

Nga ana tjetër, dokumenti duhej t'i mundësonte publikut që të informohej për procesin zgjedhor nëpërmjet raportimit të drejtë dhe rikapitulimit analitik të kandidatëve dhe për fushatat dhe programet e partive politike. Ai ishte përpiluar si rezultat i bashkëpunimit mes ekipit të BI-BI-SI nga Londra , Ambasadës së Britanisë në Shkup dhe RTVM-së, Institutit Maqedonas për Media dhe Këshillit për Etikë në Medie. Doracaku është i thjeshtë dhe i ndarë në tre kapituj. Parimet e mbulimit të proceseve zgjedhore janë përgjegjësia shoqërore dhe integriteti personal i gazetarëve dhe kontributi i publikut dhe pjesëmarrësve në zgjedhje. Parimet e përfshira në dokument janë në pajtueshmëri me normat ligjore që kanë të bëjnë me RTVM-në, obligimet e RTVM-së të vërtetuara në Kodin zgjedhor dhe Kodeksin e gazetarëve të Maqedonisë.

Marrëveshja politike nga Përzihino parashikoi mundësi që opozita ta nimonojë kryeredaktorin e programit informativ të RTVM-së. Ai filloi me detyrë 100 ditë para zgjedhjeve. Agjencia për shërbime audio dhe audio vizuele në raportin për monitorimin e raportimit mediatik në 18 servise programore gjatë periudhës prej 11 deri 20 nëntor të vitit 2016 ka vlerësuar se RTVM gjatë kësaj periudhe ka raportuar në mënyrë të balancuar.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë në një sërë dokumentesh ka theksuar se servisit publik i duhen reforma rrënjësore. **Sipas SHGM-së, për të pasur një servis të suksesshëm publik nevojitet financim stabil dhe këshill i pavarur programor.**

---

135 Në dispozicion në <http://www.time.mk/c/408bc3f05c/mrt-so-pravilnik-za-izvestu-vanje-za-vreme-na-izborite-se-obvrza-na-nepristrasnost.html>, qasur më 13.12.2016

### 3.2.1 RTVM DHE ETIKA GAZETARESKE

Që nga pavarësimi i Maqedonisë në vitin 1991, Radio Televizioni i Maqedonisë është nën kontroll të fuqishëm politik të partive në pushtet. Gjatë këtyre 24 vjetëve të tranzicionit demokratik të Maqedonisë, qytetarët dhe opozita asnjëherë nuk e kanë konsideruar RTVM-në si servis publik. Rejtingu, besimi dhe ndikimi i RTVM-së gjithmonë ka qenë në nivelin më të ulët.<sup>136</sup>

Kontrolli politik dhe partiak ndaj RTVM-së është konstatuar edhe në raportin e Komisionit Evropian.<sup>137</sup> Në raportin e fundit të KE për përparimin e Maqedonisë në vitin 2014, është konstatuar se RTVM-ja nuk e plotëson rolin e servisit publik si një burim informimi mediatik i cili është i balancuar dhe i paanshëm. "Pavarësia financiare dhe politike e servisit publik ende nuk janë të definuara saktësisht"

Në raportin përfundimtar të misionit mbikëqyrës të OSBE/ODIHR për zgjedhjet presidenciale dhe ato të parakohshme parlamentare të vitit 2014<sup>138</sup> është konstatuar se raportimi i RTVM-së për fushatën zgjedhore ka qenë i njëanshëm dhe në favor të partive në Qeveri. "Servisi publik radiodifuziv nuk arriti që të sigurojë mbulim të balancuar dhe të barabartë të të gjithë kandidatëve", theksohet në raport.

### 3.3 RTVM-JA DHE KODI ETIK I GAZETARËVE

Vlerësimet e tilla për punën e Radio-Televizionit të Maqedonisë i vërteton edhe Këshilli i Nderit i SHGM-së. Deri tani Këshilli ka reaguar në gjashtë raste të shembujve për raportim joprofesional. Në një rast bëhet fjalë për gjuhë klasike të urrejtjes, e cila është elaboruar më lart, ndërsa rastet e tjera janë të lidhura me raportimin e njëanshëm në favor të partive në pushtet.

---

136 Ibid

137 EK, Raporti 2014, <http://bit.ly/2hXmKCm>

138 OSBE, Raporti 2014, në dispozicion në <http://www.osce.org/mk/odihr/elections/fyrom/121926?download=true>

Rasti i parë është nga korriku i vitit 2009,<sup>139</sup> kur RTVM-ja transmeton video incizim nga Youtube për Lube Boshkovskin, ku ai është paraqitur si tradhtar. Këshilli e dënon shndërrimin e RTVM-së në mjet për ballafaqim me kundërshtarët përmes zbatimit të fushatave brutale dhe linçimit publik. "Shpallja 'tradhtar' me retorikë të ashpër propagandiste jo vetëm që është joprofesionale, por është edhe jashtëzakonisht e rrezikshme, sepse krijohet atmosferë në të cilën dikujt i rrezikohet siguria me publikimin e akuzave të njëanshme, dëshmi dhe 'gjykime' – pa dëgjuar paraprakisht edhe argumentet e tij", qëndron në reagimin e Këshillit, në të cilin i bëhet thirrje rregullatorit mediatik që të ndërmarrë sanksione për sjelljen e pashembullt të servisit publik.

Në stil sensacionalit, RTVM-ja raporton edhe në tetor të vitit 2012,<sup>140</sup> kur në lajme transmetohet dezinformata se në Selanik, ekstremistët grekë kanë vrarë një shtetas me prejardhje maqedonase. Këshilli vlerëson se me publikimin e informatave të pakonfirmuara, bëhet çorientim i opinionit, para se gjithash shkaktohet trazirë mes njerëzve dhe lëndohen ndjenjat e tyre. Sipas Këshillit, shembujt e tillë kontribuojnë që gazetarët ta devalvojnë vetë profesionin e tyre dhe ta ulin nivelin deri në atë masë që opinionin të mos ketë më besim në të. "Ky profesion nuk duron sjellje joserioze, improvizim dhe joprofessionalizëm, siç është bërë me rastin e publikimit të lajmit për gjoja vrasjen e studentit maqedonas në Selanik", konstatohet në reagim.

Shkelje të ngjashme të Kodit të lidhura me tifozllëkun partiak ka pasur edhe në programet në gjuhën shqipe të RTVM-së. Incidenti i parë i rëndë i kësaj natyre ndodh më 7 prill të vitit 2008<sup>141</sup>, kur në lajmet qendrore në gjuhën shqipe raportohet në mënyrë jo të balancuar në favor të partisë shqiptare në pushtet. Gjatë transmetimit të kronikave, përveç llogos së televizionit në anën e djathtë, në anën e majtë të ekranit paraqitet edhe llogo e PDSH-së.

---

139 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/86>

140 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2012, në dispozicion në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/471>

141 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2008, në dispozicion <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/53>

Incident tjetër në të cilin është përfshirë programi në gjuhën shqipe i RTVM-së ndodh në mars të vitit 2009<sup>142</sup>. Atëherë, redaktori përgjegjës i programit, Migena Gorenca, e udhëheq mitingun partiak të BDI-së në Çair të Shkupit. Me këtë, Gorenca nuk ka mbajtur distancë profesionale nga proceset politike, sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve.

## 4. RAPORTIMI PËR TEMA SENSITIVE NGA PRAKTIKA E KËSHILLIT TË NDERIT TË SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË DHE KËSHILLIT PËR ETIKË NË MEDIET E MAQEDONISË

Kodi Etik i Maqedonisë ka përfshirje të gjerë të temave të raportimit gazetaresk të cilat i trajton si sensitive, për të cilat nuk guxon të raportohet në mënyrë sensacionale. Neni 8 i kodit këmbëngul që gazetarët të jenë veçanërisht të vëmendshëm kur informojnë për raste të fatkeqësive, katastrofave elementare, luftërave, tragjedive familjare, sëmundjeve dhe procedurave gjyqësore.

Përvoja e Këshillit të Nderit të SHGM-së dhe Këshillit për Etikë në Medie tregon se mediet në periudha të ndryshme kanë raportuar në mënyrë joprofesionale për më tepër tema të numëruara në nenin tetë të Kodit, siç është raportimi për vetëvrasje, për ngjarje ku janë të përfshirë fëmijë, për dhunë familjare dhe për respektimin e të drejtës së privacisë të personave të prekur nga fatkeqësitë. Këshilli i SHGM-së ka regjistruar rreth dhjetë shembuj të tillë, ndërsa Komisioni për Ankesa i KEMM-së rreth 20.

142 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/72>

## 4.1 RAPORTIMI PËR VETËVRASJE DHE PROCESË GJYQËSORE

Këshilli i SHGM-së që në vitin 2007<sup>143</sup> publikon komunikatë të përgjithshme përmes së cilës i paralajmëron gazetarët se mënyra e raportimit për vetëvrasje mund të nxisë vetëvrasje të re.

“Theksimi i arsyeve sociale, siç është papunësia, problemet me shkollën ose përfundimi i ndonjë lidhje romantike, mund të kuptohet si porosi deri te të gjithë ata që kanë probleme të ngjashme se vetëvrasja mund të jetë një nga zgjidhjet e mundshme. Frazat kolorite, qëndrimi pozitiv ndaj aktit ose qasje sensacionaliste, sidomos nëse bëhet fjalë për person të popullarizuar i cili është idol i të rinjve, mund të nxisin vetëvrasje të tjera”, thekson Këshilli dhe u bën thirrje gazetarëve që ta respektojnë privacinë e personit dhe të mos raportojnë me sensacionalizëm në raste të vetëvrasjes, sepse bëhet fjalë për tragjedi familjare. Përveç kësaj, ai u rekomandon medieve që të mos publikojnë fotografi ose incizime të të vdekurve dhe të shmangjet publikimi i letrave dhe porosive të lëna. “Raportet duhet të mbajnë llogari edhe për anëtarët e familjes së viktimës, të mos e rrisin dhembjen e tyre, por edhe të mos kontribuojnë për njolllosjen e tyre”, rekomandon Këshilli.

Shembull tipik se si mediet nuk duhet të raportojnë nga proceset gjyqësore është raportimi për gjykimin e të akuzuarit që gjykohet për vrasje serike, nga 22 dhe 23 dhjetori i vitit 2008, raportim i Televizionit Sitel dhe gazetave “Veçer”, “Vest”, “Utrinski vesnik” dhe “Vreme”.<sup>144</sup> Këshilli potencon se në ditën kritike, mediet e përmendura në raportimin e tyre për gjykimin në Ohër kanë përdorur formulime eksplicite për krimet e kryera ndaj trupave të pajetë të viktimave, me çka mund të nxitet dhembje plotësuese për familjarët, miqtë e viktimave, por edhe për shikuesit. “Këshilli vlerëson se transmetimi jokritik i pjesëve të ekspertizës për krimet e kryera, gjatë procedurës gjyqësore, nuk ka qenë aspak e patjetërsueshme dhe nuk mund të arsyetohet me të drejtën e opinionit që të jetë i informuar”, vlerëson

143 SHGM, Këshilli i Nderit, Komunikatë, 2007, në dispozicion në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/46>

144 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/61>

Këshilli dhe shton se për shkak të kësaj, gazetarët nuk e kanë respektuar dhembjen dhe zinë e familjeve dhe miqve të viktimave dhe e kanë shkelur të drejtën e tyre të privacisë.

## 4.2 RAPORTIMI PËR ADOLESHENTË DHE PËR FATKEQËSI

Shkelja e rëndë e të drejtave të fëmijëve është vërejtur më 19 shkurt të vitit 2009,<sup>145</sup> kur Televizioni Kanall 5 raporton për dhunë seksuale familjare në një fshat të Strugës, me ç'rast medieja nuk e ka mbrojtur mjaftueshëm viktimën adoleshente. Këshilli ka konstatuar se për dhunën seksuale ndaj një fëmije, Kanall 5 raporton me sensacion, sepse interviston nënën e viktimës, si dhe shfaq brendësinë dhe pjesën e jashtme të shtëpisë ku jeton viktimja. Përveç kësaj, Kanall 5 ka incizuar prej pas shpine edhe vetë viktimën, me çka praktikisht e ka zbuluar identitetin e saj.

“Këshilli përkujton se publikimi ose mbrojtja e pamjaftueshme e identitetit të viktimave të krimit, informimi për detaje nga krimi të cilat nuk mund të arsyetohen me interesin publik, sidomos nëse bëhet fjalë për raste të tilla delikate, siç është dhuna familjare dhe seksuale, gjithmonë e ekspozon viktimën në traumë edhe më të madhe dhe e zmadhon tragjedinë”, nënvizon Këshilli në reagimin e tij dhe kërkon nga institucionet që të mos shpërndajnë informata te mediet të cilat mund ta shkelin të drejtën e privacisë, identitetin dhe dinjitetin e viktimave.

Si skajshmërisht raportim joetik për një fatkeqësi komunikacioni është shembulli me lajmet e Televizionit A1 në gusht të vitit 2009<sup>146</sup>, kur kjo medie ka publikuar incizime të fatkeqësisë së komunikacionit ku humbën jetën nënë e bijë, shtetas të Republikës së Serbisë. “Publikimi i pamjeve ku shihen trupa njerëzish (të djegura deri në atë masë që është dashur të nxirren me lopata) nuk është shembullore, është joprofesionale dhe në kundërshtim me Kodin, i cili kërkon respektimin e privacisë dhe dhembjen dhe zinë personale. Në raste të tilla, raportimi duhet të jetë i liruar nga

145 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/63>

146 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/dru-pal-7.7/mk/node/80>

sensacionalizmi”, thuhet në dënimin e Këshillit. Sipas këtij trupi, pamjet e mjegulluara të aksidentit mund të publikohen vetëm nëse këtë e kërkon interesi publik.

Shembull i keq për raportim për vetëvrasje, Këshilli i Nderit ka regjistruar në maj të vitit 2013,<sup>147</sup> kur të gjitha mediet, duke raportuar për vetëvrasjen përballë ndërtesës së “Nova Makedonija”-s, kanë publikuar fotografi të trupit të pajetë të viktimës se si qëndron i varur. Përveç kësaj, disa medie kanë publikuar madje edhe identitetin e viktimës. Sjelljen e tillë të medieeve, Këshilli e ka vlerësuar si skajshmërisht joetike dhe joprofesionale. “Opinionit është i tmerruar, është shkaktuar shqetësim. Nuk janë respektuar dhembja personale dhe familjare, me qëllim që të arrihet sensacionalizmi”, thekson Këshilli, dhe u bën thirrje gazetarëve të mos i japin përparësi sensacionit përpara dhembjes njerëzore. Shembull të tillë të ngjashëm ka vërejtur edhe Komisioni i Ankesave i KEMM-së, duke vepruar ndaj ankesës së Daniella Kallajxhiskit,<sup>148</sup> lidhur me fotografitë e publikuara në portalin Plusinfo.mk, në të cilat shihet se si një vajzë ia vë zjarrin vetes në Parkun e qytetit në Shkup.

Në përgjigjen e redaktorit Branko Gerovski, dorëzuar në Komisionin e Ankesave thuhet se mediet nëpër botë publikojnë mijëra fotografi të njerëzve të vdekur dhe kjo nuk mund të konsiderohet si mosrespektim i dhembjes së më të afërmve të tyre. Në mënyrë plotësuese, Gerovski argumenton se opinionit duhet ta dijë se vënia e zjarrit vetes nga një grua është ngjarje e vetme e llojit të tillë në historinë e Maqedonisë. Përveç kësaj, ai thotë se në momentin kur është publikuar fotografia, identiteti i viktimës nuk ka qenë i njohur, ndërsa më vonë janë publikuar vetëm iniciale.

Edhe përkundër argumenteve të tilla, Komisioni ka konstatuar shkeljen e nenit 7, sipas të cilit gazetari duhet ta respektojë privacinë e personit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik dhe se gazetari është i obliguar ta respektojë dhembjen dhe zinë personale. “E drejta e opinionit që të jetë i informuar nuk mund të jetë arsyetim për nevojën për sensacion”, potencon Komisioni.

---

147 SHGM, Këshilli i Nderit, Reagim, 2009, në dispozicion në <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/608>

148 KEMM, Komisioni i Ankesave, viti 2015, në dispozicion në <http://bit.ly/2h2WSU1>





# PJESA 1

## LITERATURA

### LIBRA, KAPITUJ, ARTIKUJ

- Balanova, E. (2007) *Media, Wars and Politics – Comparing the Incomparable in Western and Eastern Europe*, Ashgate Publishing Company
- Bardoel, J., d'Haenens, L. (2004). *Media responsibility and accountability: New conceptualizations and practices*. *Communications*, 29(1), 5–25.
- Bertrand, C.J (2000) *Media Ethics and Accountability Systems*, Transaction Publishers
- Bon Krogh, T. (ed.) (2007) *Media Accountability Today... and Tomorrow Updating the Concept in Theory and Practice*, Nordicom, University of Gothenburg
- Christians, C.G. et al (1995) *Media Ethics: Cases and Moral Reasoning* (2nd ed.). New York: Longman.
- Couldry, Nick (2013) *Why Media Ethics Still Matters*. In: Ward, Stephen J. A., (ed.) *Global Media Ethics: Problems and Perspectives*. Wiley-Blackwell, Chichester, pp. 13-28
- Coyne, C.J., Leeson, P.T. (2009) *Media, Development and Institutional Change*, Edward Elgar
- De Haan, Y. M. (2012) *Between professional autonomy and public responsibility: accountability and responsiveness in Dutch media and journalism*, University of Amsterdam
- Eberwein, T., Fengler, S., et al (eds) (2011) *Mapping Media Accountability – in Europe and Beyond*, Köln: Herbert von Halem Verlag
- Frohardt M., Temin J. (2003) *Use and Abuse of Media in Vulnerable Societies*, Washington DC, United States Institute of Peace
- Gordon, A.D., Kittross, J.M., et al (2011) *Controversies in Media Ethics* (3rd ed.), Routledge.
- Hallin, D.C., Mancini. P. (2004) *Comparing Media Systems – Three Models of Media and Politics*, Cambridge University Press
- Howard R., (2003). *Conflict Sensitive Journalism*, IMPACS, 8-9, Denmark
- Jo Bardoel, Y.D.H (2012) *Accountability in the newsroom: Reaching out to the public or a form of window dressing?* *Studies in Communication Sciences* 12 (2012) 17–21
- Johannessen, R.L., Valde, K.S., Whedbee, K.E. (2008) *Ethics in Human Communication*, Waveland Press

- McQuail, D. (1997). Accountability of media to society: Principles and means. *European Journal of Communications* 12 (4), 511-529
- McQuail, D. (1997) *Audience Analysis*, Sage Publications
- McPhail, T. L. (2006) *Global communication: Theories, stakeholders, and trends*. Malden, MA: Blackwell Publishing
- Nasser, M. K. (1983) News values versus ideology: A third world perspective. In J. Martinand, & A. Chaudhary, *Comparative Media System* (pp. 32-48). Broadway, New York: Longman.
- Reese, S D. (2010) Journalism and Globalization. *Sociology Compass* 4/6: 344-353
- Reese, S. D (2001) Understanding the Global Journalist: a hierarchy-of-influences approach. *Journalism Studies*, Volume 2, Number 2, pp. 173-187
- Shah, A. (2005) War, Propaganda and the Media Global Issues.(online) <http://www.globalissues.org/article/157/war-propaganda-and-the-media>, пристапено на 1 ноември 2016.
- Tuneva, M. (2010) *Diversity Reporting Handbook*, School of Journalism and Public Relations, достапен на: [http://www.cestim.it/argomenti/08media/2011-Diversity-Reporting-Handbook\\_EN.pdf](http://www.cestim.it/argomenti/08media/2011-Diversity-Reporting-Handbook_EN.pdf), пристапено на 12 ноември 2016
- Von Krogh, T. (2008) Constructive criticism" vs public scrutiny: attitudes to media accountability in and outside Swedish news media Media accountability today... and tomorrow: updating the concept in theory and practice, Nordicom, Göteborgsuniversitet
- Ward, S.J.A (eds) (2013) *Global Media Ethics: Problems and Perspectives*. Chichester, UK: Wiley-Blackwell
- Ward, S. J. A. (2008) *Global Journalism Ethics: Widening the Conceptual Base*. *Global Media Journal - Canadian Edition*, Volume 1, Issue 1, pp. 137-149
- Wayatt, W. N (ed) (2014) *The Ethics of Journalism – Individual, Institutional and Cultural Influences*. I.B.Tauris & Co. LTD in association with the Reuters Institute for the Study of Journalism, University of Oxford
- Ward, S.J.A (2005) Philosophical foundations of global journalism ethics. *Journal of Mass Media Ethics* (20-1), 3-21
- Ward, S.J.A (2009) *Covering Tragedy: Do Journalists Exploit Suicide*, Center for Journalism Ethics
- Тунева, М., Камењарова – Петреска, Е. (2010) Медиумите, граѓаните и интеркултурните комуникации, Висока школа за новинарство и односи со јавноста

## DOKUMENTE DHE RAPORTET

- Council of Europe (1996) Recommendation No R (96) 10, Достапна на: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168050c770>, пристапено на 11 ноември 2016
- Council of Europe (2006), Recommendation Rec (2006)5 Достапна на: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=0900-0016805af657](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900-0016805af657), пристапено на 3 декември 2016
- Council of Europe (2012) Recommendation CM/Rec(2012)1 Достапна на: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805cb4b4](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cb4b4), пристапено на 21 ноември 2016
- EthicNet, Code of Ethics of Slovene Journalists, Достапен на: [http://ethicnet.uta.fi/slovenia/code\\_of\\_ethics\\_of\\_slovene\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/slovenia/code_of_ethics_of_slovene_journalists), пристапено на 1 ноември 2016
- EthicNet, Code of Ethics of Lithuanian Journalists and Publishers, Достапен на: [http://ethicnet.uta.fi/lithuania/code\\_of\\_ethics\\_of\\_lithuanian\\_journalists\\_and\\_publishers](http://ethicnet.uta.fi/lithuania/code_of_ethics_of_lithuanian_journalists_and_publishers), пристапено на 8 ноември 2016
- EthicNet, Charter of Duties of Journalists in Italy, Достапна на: [http://ethicnet.uta.fi/italy/charter\\_of\\_duties\\_of\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/italy/charter_of_duties_of_journalists), пристапено на 9 ноември 2016
- EthicNet, Honour Codex of Croatian Journalists, Достапен на: [http://ethicnet.uta.fi/croatia/honour\\_codex\\_of\\_croatian\\_journalists](http://ethicnet.uta.fi/croatia/honour_codex_of_croatian_journalists), пристапено на 17 ноември 2016
- European Institute for Gender Equality (2010), Gender Mainstreaming – A Strategy to Achieve Equality Between Women and Men, достапен на: <http://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-and-tools/croatia/croatian-radiotelevision-self-regulation-tools-action-plan-gender-equality-and-ethical-codex>, пристапено на 2 декември 2016
- European Commission (2010), Audiovisual Media Services Directive, Достапна на: <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/audiovisual-media-services-directive-avmsd>, пристапено на 1 декември 2016
- Hrvatska radiotelevizija (2013) Eticki kodeks za novinare i kreativno osoblje достапен на [http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Eticki\\_kodeks\\_za\\_novinare\\_i\\_kreativno\\_osoblje\\_HRT\\_a.pdf](http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Eticki_kodeks_za_novinare_i_kreativno_osoblje_HRT_a.pdf), пристапено на 11 ноември 2016
- Hrvatska radiotelevizija (2013) Опса pravila o radu i ponasanju, Достапен на: [http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Opса\\_pravila\\_o\\_radu\\_i\\_ponasanju\\_zaposlenika.pdf](http://www.hrt.hr/fileadmin/video/Opса_pravila_o_radu_i_ponasanju_zaposlenika.pdf), пристапено на 9 ноември 2016

- Millenium Project (2006) Millenium Development Goals, Достапни на: <http://www.unmillenniumproject.org/goals/>, пристапено на 12 ноември 2016
- Presserat, German Press Code, Достапен на: [https://www.presserat.de/fileadmin/user\\_upload/Downloads\\_Dateien/Pressekodex13english\\_web.pdf](https://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex13english_web.pdf), пристапено на 28 октомври 2016
- RTV Slovenia (2000) Professional Standards ,достапни на: <http://www.rtvlo.si/strani/professional-standards/17>, пристапено на 2 ноември 2016
- Slovenska Oglasevalska Zbornica (2009) Slovenski oglasevalski kodeks,д на: [http://www.soz.si/sites/default/files/soz\\_sok\\_slo.pdf](http://www.soz.si/sites/default/files/soz_sok_slo.pdf), пристапено на 13 ноември 2016
- World Health Organization (2008) Preventing Suicide – A Resource for Media Professionals, достапен на: [http://www.who.int/mental\\_health/prevention/suicide/resource\\_media.pdf](http://www.who.int/mental_health/prevention/suicide/resource_media.pdf), пристапено на 11 ноември 2016
- UNESCO (2010) Media Development Indicators: A Framework for Assessing Media Development, достапни на <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001631/163102e.pdf>, пристапено на 8 ноември 2016
- UNICEF, Principles and Guidelines for Ethical Reporting – Children and Young People Under 18 years old, достапни на [https://www.unicef.org/uganda/Guidelines\\_for\\_Reporting\\_on\\_Children1.pdf](https://www.unicef.org/uganda/Guidelines_for_Reporting_on_Children1.pdf), пристапено на 14 октомври 2016
- United Nations (2000) United Nations Millenium Declaration, достапна на <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.htm>, пристапено на 29 ноември 2016
- United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities and Optional Protocol, Достапна на: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>, пристапено на 14 ноември 2016

## PJESA 2

### LITERATURA

- Adamçevski, M., Çausidis, T., Petkovska, B., Tërpevska, S., dhe Trajkovska, Zh. (2010), Përmbledhje e çështjes së vetërregullimit të medieeve në Maqedoni, Instituti Maqedonas i Medieeve & Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Opininionin, Shkup, 2010
- Adamçevski, M., Konferencë për shtyp e Komisionit për Ankesa pranë KEMM-së, 30.09.2016, Ckonje
- Zibert, F.S., Peterson, T., dhe Shram, V., „Katër teoritë për shtypin“, PNID „Step“, Shkup, 1994. Titulli i origjinalit: “Four Theories of the Press”, Siebert, Fred S., Peterson, Theodore, and Schramm, Wilbur, University of Illinois Press, 1956
- Kanal 77, 2012, „SHGM-ja dhe Qeveria u morën vesh – shpifja u dekriminalizua “, 14. 06. 2012, Shkup
- Komiteti për mbrojtjen e gazetarëve, 2011, Committee to Protect Journalists, “Press freedom issues may keep Macedonia from EU”, 17 October 2011.
- Federata Ndërkombëtare dhe Evropiane e Gazetarëve (IFJ and EFJ), 2011, Support Campaign for Independent Journalism and Pluralism in Republic of Macedonia, 7 July 2011
- Ordanovski S., Ismail, Gj., Stankovski, D., Ajdini G., Jençevska-Delevska, A., Demokracia e robëruar, zhvillimi i strukturës së pronarëve të medieeve në Republikën e Maqedonisë, TM “Transparencë Maqedoni”, Shkup, 2012.
- Selmani, N., Intervistë: “Liria e shprehjes është përjashtim”, Dnevnik, (24.09.2011)
- Tahiri, S., Konferencë për shtyp e KEMM-së, (29.06.2016)
- Amnesty International, 2011, “Macedonian government must stop silencing critical media”, 5 July 2011.
- Bajdar, Yavuz. (2008). The media Self-Regulation Guidebook-all questions and answers: Setting up a journalistic code of ethics-the core of media self-regulation. Vienna: Office of the representative on freedom of the media: Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), стр.21-31

- Broughton Micova Sally (2010), Finding a Niche: Small States Public Service Broadcasng in Slovenia and Macedonia. (RIPE)
- Buckley, S., Duer, M. K., Mendel, T., & O'Siochru, S. (2008), Broadcasting, Voice, and Accountability: A Public Interest Approach to Policy, Law, and Regulation, Washington: University of Michigan Press.
- Haraszti, Miklos. (2008). Vodič za samoregulaciju medija. Insitut zamedije Crne Gore
- SouthEastEuropeMediaOrganization–SEEMO, Report on the SEEMO press freedom mission to the Republic of Macedonia, 4-6 October 2011

## BURIMET E SHFRYTËZUARA NGA INTERNETI

- Bllazhevski, Teofil, Verifikimi i fakteve në medie <http://mediumi.kauza.mk/2015/04/29/samoregulacijata-vo-mediumite-vo-makedonija-mission-possible/> Qasur më 11.12.2016
- Enti Shtetëror për Revizion, 2008, (faqe 22-25), <http://www.dzr.mk/Uploads/2006%20-%20JP%20Makedonska%20radio-televizija.pdf>, Qasur më 14.12.2016
- Shoqata e Gazetarëve të RM-së, [http://znm.org.mk/?page\\_id=742](http://znm.org.mk/?page_id=742) , Qasur më 09.12.2016)
- Shoqata e Gazetarëve, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/440>, Qasur më 10.12.2016
- Shoqata e Gazetarëve të RM-së, Statuti i SHGM-së nga viti 2015, [http://znm.org.mk/?page\\_id=1349](http://znm.org.mk/?page_id=1349), Qasur më 10.12.2016
- SHGM, Dokumente, 2012, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, Qasur më 10.12.2016
- SHGM, 2011, (<http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>), Qasur më 12.12.2016
- SHGM, Raporti për punën e SHGM-së 2013 KD (faqja 3), [http://znm.org.mk/?page\\_id=1362](http://znm.org.mk/?page_id=1362), Qasur më 10.12.2016
- SHGM, Raporti për punën e SHGM-së 2013 KD (faqja 3), [http://znm.org.mk/?page\\_id=1362](http://znm.org.mk/?page_id=1362), Qasur më 10.12.2016
- SHGM, Raporti për punën e SHGM-së 2013 KD (faqja 4), [http://znm.org.mk/?page\\_id=1362](http://znm.org.mk/?page_id=1362), Qasur më 10.12.2016

- SHGM, Analiza e Projektligjit për mediet, SHGM maj 2013, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, Qasur më 09.12.2016
- SHGM, Arsyetimi i amendamentit të Ligjit për mediet, 19.08.2013, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, Qasur më 09.12.2016
- SHGM, Arsyetimi i amendamentit të Ligjit për mediet, 19.08.2013, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>, Qasur më 10.12.2016
- SHGM, Formohet Këshilli për Etikë në mediet e Maqedonisë, 19 dhjetor 2013, <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/711>, Qasur më 11.12.2016
- SHGM, „Plani aksional SHGM-IMM mars 2012“, Shkup [http://znm.org.mk/drupal-7.7/sites/default/files/Akciski%20plan\\_ZNM\\_MIM\\_22\\_March\\_mk.pdf](http://znm.org.mk/drupal-7.7/sites/default/files/Akciski%20plan_ZNM_MIM_22_March_mk.pdf)
- Telegraf.mk, 2016, Konferencë për shtyp e KEMM, 29.06.2016, <http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-sovet-za-etika-vo-mediumite-najmnogu-zalbi-za-nefer-izvestuvane-govor-na-omraza-i-za-kleveta.nsp>, Qasur më 10.12.2016
- Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2012, faqja [http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Registar-na-dokumenti/PR2012\\_MK3\(2\).pdf](http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Registar-na-dokumenti/PR2012_MK3(2).pdf) Qasur më 10.12.2016
- RTVM, servisi publik i qytetarëve? 2013, <http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/MRT-Javen-servis-na-gragjanite.pdf>, Qasur më 10.12.2016
- 24 Vesti, Filloi të funksionojë Komisioni për Ankesa nga mediet, 30.09.2014, <http://24vesti.mk/pochna-da-funkcionira-komisijata-za-zhalbi-od-mediumi>, Qasur më 11.12.2016
- Këshilli i Evropës, <http://www.coe.int/en/web/freedom-expression>, Qasur më 12.12.2016
- Gazeta zyrtare e RSM-së nr.20, faqja 459, 29 prill të vitit 1974. ,<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/A13900384849485BA96D4F3F2B8FE59B.pdf>, Qasur më 12.12.2016
- Gazeta zyrtare e RM-së, nr.100, 2005, <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/74AEA2A6F3A1454E895BE81FB97AF16A.pdf>, Qasur më 11.12.2016
- Gazeta zyrtare e RM-së, nr.184, 2013, Ligji për shërbime audio dhe audio-vizuele, (faqja 31) <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf>, Qasur më 12.12.2016

- Gazeta zyrtare e RM-së, nr.17, 2015 , Statuti i ndërmarrjes publike radiodifuzive RTVM <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/3972172cb0e147d5a200e237b5b7aad3.pdf>, Qasur më 12.12.2016
- Tërpevska, Snezhana, Jakimovski, Lubomir, Shopar, Vesna, Petkovska, Biljana, Trajkovska Zhaneta, Analiza e radiodifuzionit publik në Republikën e Maqedonisë në kontekst të politikës evropiane për mediet, 2010, Shkup, [http://www.vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/1143\\_Analiza\\_na\\_javen\\_servis.pdf](http://www.vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/1143_Analiza_na_javen_servis.pdf) , Qasur më 13.12.2016
- DW, SHGM: "Qeveria ka për qëllim të kontrollojë KRD-në ", 2011, <http://www.dw.com/mk/зnm-владата-има-намера-да-го.../a-15249092>, Qasur më 14.12.2016
- 4TH EUROPEAN MINISTERIAL CONFERENCE ON MASS MEDIA POLICY (PRAGUE, 7-8 DECEMBER 1994), <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=411463&SecMode=1&DocId=517420&Usage=2> , Qasur më 14.12.2016
- FreedomHouse, <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2012/macedonia>, Qasur më 06.12.2016
- Telegraf.mk,2015,<http://telegraph.mk/default.aspx?ItemId=07674e30-62b6-41b4-a5ca-9bd40154d9bd&newsArticleId=81c28d34-3ac7-44d5-b837-47c5810c2d0a&>, Qasur më 12.12.2016
- <http://www.time.mk/c/408bc3f05c/mrt-so-pravilnik-za-izvestuvanje-za-vreme-na-izborite-se-obvrza-na-nepriistrasnost.html>, Qasur më 13.12.2016



## MATERIALET E SHFRYTËZUARA NGA ARKIVET

- Arkivi i Shoqatës së Gazetarëve, Statuti i SHGM-së i vitit 1986
- Arkivi i SHGM-së, Statuti i SHGM-së i vitit 2001
- Arkivi i SHGM-së, Statuti i SHGM-së i vitit 2010
- Arkivi i SHGM-së, Sondazhi për themelimin e trupit vetërregullativ, 29.11.2012
- Arkivi i Udruzenje novinara Srbije, Dokumenti SNJ.

## INTERVISTAT E SHFRYTËZUARA

- Intervista e Lubomir Jakimovskit, viti 2012 për nevojat e hulumtimit të Transparencë Maqedoni, Shkup
- Intervista e Naser Selmanit, 2014, për nevojat e tezës së magjistraturës "Analizë krahasuese e modeleve të vetërregullimit në medie", Universiteti "Sh. Qirili dhe Metodi", Instituti për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike, 25.12.2014, Shkup
- Intervista me gazetarë nga redaksitë e dy serviseve programore të MTV-së, për këtë analizë, të realizuara nga 01.12.2016 deri 6.12.2016



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.77:174.4(4+497.7)

TUNEVA, Marina

Raportimi etik i medieve në Evropë dhe Maqedoni / [autorë Marina Tuneva, Filjana Koka]. - Shkup : Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, 2017. - 105 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон главите

ISBN 978-9989-2225-5-9

1. Koka, Filjana [автор]

а) Етика во новинарството - Македонија б) Етика во новинарството - Европа в) Етика - Медиуми - Европа г) Етика - Медиуми - Македонија  
COBISS.MK-ID 102781450



Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë  
Gradski Zid, blok 13 1000, Skopje  
Tel: 00389 (02) 3298-139  
Fax: 00389 (02) 3116-447  
e-mail: [contact@znm.org.mk](mailto:contact@znm.org.mk)



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

Fondacioni "Konrad Adenauer"  
Risto Ravanovski 8, 1000 Shkup  
Tel: +389 2 3217 075  
Fax: +389 2 3217 076  
e-mail: [Skopje@kas.de](mailto:Skopje@kas.de)  
<http://www.kas.de/mazedonien/mk/>

